

VROJTIMI I PASURISË TË FAMILJEVE
SHQIPTARE (ALBANIAN
HOUSEHOLD WEALTH
SURVEY-AHWS): REZULTATET E
RAUNDIT TË PARË


Elona Dushku
Ola Çami

1 (82) 2022

INTERNATIONAL SYMPOSIUM



BANKA E SHQIPËRISË




**VROJTIMI I PASURISË TË
FAMILJEVE SHQIPTARE
(ALBANIAN HOUSEHOLD
WEALTH SURVEY-
AHWS): REZULTATET E
RAUNDIT TË PARË**

*Elona Dushku
Ola Çami*

1 (82) 2020

MATERIAL STUDIMOR

BANKA E SHQIPËRISË



Elona Dushku

Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë, e-mail: edushku@bankofalbania.org

Ola çami

Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë, e-mail: ocami@bankofalbania.org

SHËNIME

Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë material janë vetëm të autorëve dhe nuk reflektojnë këndvështrimin dhe opinionin e Bankës së Shqipërisë.

FALENDERIME

Autorët dëshirojnë të falënderojnë në mënyrë të veçantë: Andrea Neri, ekonomist i Bankës së Italisë, për komentet, udhëzimet dhe sugjerimet e vlefshme gjatë të gjithë procesit të këtij projekti, si dhe Juha Honkkila, ekonomist i BQE, për materialet mbështetëse. Nga ana tjetër, autorët falënderojnë të gjithë pjesëmarrësit e takimit të Household Finance and Consumption Network (HFCN) zhvilluar në Frankfurt, Gjermani, më 18-19 nëntor 2019, për komentet dhe diskutimet mbi prezantimin e bërë bazuar në rezultatet e marra nga ky vrojtim. Autorët falënderojnë gjithashtu Altin Tankun, Argita Frashërin, Kliti Cecan, Erjona Suljotin, Refika Fejzon, Aida Guxhon, Gerti Shijakun, punonjës të Bankës së Shqipërisë, për komentet dhe sugjerimet gjatë procesit të draftimit të pyetësorit, si dhe punonjësit e INSTAT-it, në veçanti, Liljana Boci dhe Mandi Hoxha për bashkëpunimin e frytshëm, përkatësisht në lidhje me zgjedhjen e kampionit dhe koordinimin e punës në terren.

P Ë R M B A J T J A

ABSTRAKT	9
PËRMBLEDHJE E RAPORTIT	9
I. HYRJE	11
II. AKTIVET	19
III. DETYRIMET E FAMILJEVE	40
IV. PASURIA NETO	50
V. TË ARDHURAT	53
VI. SHPENZIMET E FAMILJEVE DHE KURSIMI	60
SHTOJCA 1.	68
PYETJET E PËRFSHIRA NË PYETËSOR	69

FIGURAT

Figurë 1. Struktura e Anketës mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS)

14

TABELAT

Tabela 1. Shpërndarja e familjeve shqiptare në 2019 bazuar në karakteristikat e personit të referencës	18
Tabela 2. Struktura e familjeve sipas qarqeve kryesore të Shqipërisë	19
Tabela 3. Norma e zotërimit të aktiveve reale bazuar në karakteristikat kryesore të familjeve (në përqindje)	23
Tabela 4. Kufizimet e kërkesës për kredi sipas karakteristikave socio-ekonomike të familjeve	49
Tabela 5. Tregues të matjes së pabarazisë së pasurisë neto	52
Tabela 6. Pasuria neto sipas karakteristikave socio-ekonomike të familjeve	52
Tabela 7. Të ardhurat totale neto të familjes sipas karakteristikave të saj (në mijë lekë)	59
Tabela 8. Shpenzimet për ushqim (brenda dhe jashtë shtëpisë) bazuar në karakteristikat e familjeve	62
Tabela 9. Përqindja e familjeve që kursejnë dhe atyre që nuk kursejnë si përqindje nga totalit të familjeve	66

GRAFIKËT

Grafik 1. Madhësia e familjes sipas numrit të anëtarëve të familjeve	16
Grafik 2. Shpërndarja e familjeve sipas qarqeve	17
Grafik 3. Norma e zotërimit të secilit aktiv nga familjet	21
Grafik 4. Përqindja e zotërimit të aktiveve reale sipas statusit të punësimit të personit të referencës	22
Grafik 5. Përqindja e zotërimit të aktiveve reale sipas kuantileve të nivelit të ardhurave vjetore neto të familjeve	22
Grafik 6. Përqindja e zotërimit të aktiveve reale sipas moshës së personit të referencës	22
Grafik 7. Shpërndarja e pasurisë reale të familjeve (në mijë lekë)	24
Grafik 8. Mediana e vlerës së komponentëve të aktiveve reale (në mijë lekë)	25
Grafik 9. Mediana e vlerës së aktiveve reale sipas statusit të punësimit të personit të referencës	25
Grafik 10. Mediana e vlerës së aktiveve reale sipas kuantileve të nivelit të ardhurave vjetore neto të familjeve (mijë lekë)	25
Grafik 11. Mediana e vlerës së aktiveve reale sipas moshës së personit të referencës (mijë lekë)	26
Grafik 12. Mënyra e përfitimtimit të banesës kryesore, e të cilës familjet janë pronare	27
Grafik 13. Vlera e banesës kryesore sipas perceptimit të familjeve (në mijë lekë)	28
Grafik 14. Lloji i pasurisë tjetër të patundshme që zotërohet nga familjet në Shqipëri	29
Grafik 15. Qëllimi kryesor i përdorimit të pronës	29
Grafik 16. Sektorët kryesorë ku janë përqendruar bizneset familjare (në përqindje ndaj familjeve që kanë një biznes)	30
Grafik 17. Norma e zotërimit të secilit aktiv nga familjet	32

Grafik 18. Shpërndarja e pasurisë financiare të familjeve (në mijë lekë)	33
Grafik 19. Norma e zotërimit të llogarive rrjedhëse dhe depozitave sipas kuantileve të të ardhurave	34
Grafik 20. Norma e zotërimit të llogarive rrjedhëse dhe depozitave sipas statusit të punësimit të personit të referencës	34
Grafik 21. Norma e zotërimit të llogarive rrjedhëse dhe depozitave sipas nivelit të edukimit të personit të referencës	35
Grafik 22. Shpërndarja e pasurisë totale të familjeve (në mijë lekë)	36
Grafik 23. Pasuria totale sipas statusit të punësuarit të personit të referencës	36
Grafik 24. Pasuria totale sipas moshës së personit të referencës	37
Grafik 25. Shpërndarja e aktiveve totale sipas kuantileve të pasurisë (aktiveve totale)	37
Grafik 26. Kompozimi i aktiveve totale sipas percentiles së pasurisë totale	38
Grafik 27. Të dhënat për edukimin e personit të referencës	39
Grafik 28. Të dhënat mbi edukimin e të gjithë individëve mbi 16 vjeç	39
Grafik 29. Perceptimi i familjeve ndaj rrezikut financiar	40
Grafik 30. Përqindja e numrit të familjeve që kanë një kredi	41
Grafik 31. Shpërndarja e portofolit të kredisë marrë nga sistemi financiar	42
Grafik 32. Qëllimi i përdorimit të kredisë hipotekare	42
Grafik 33. Qëllimi i përdorimit të kredisë konsumatore	43
Grafik 34. Shpërndarja e portofolit të kredisë totale të familjeve sipas statusit të punësimit të personit të referencës	43
Grafik 35. Shpërndarja e portofolit të borxhit formal të familjeve sipas nivelit të të ardhurave të familjeve	44
Grafik 36. Ngarkesa e kredisë ndaj të ardhurave totale mujore sipas statusit të punësimit	45
Grafik 37. Ngarkesa e kredisë ndaj të ardhurave totale mujore sipas percentileve të të ardhurave të familjeve (në %)	46
Grafik 38. Rezistenca e familjeve ndaj një goditje në të ardhura	47
Grafik 39. Aplikime për kredi në tre vitet e fundit	48
Grafik 40. Kufizime të kredisë	48
Grafik 41. Shpërndarja e pasurisë neto sipas percentileve të pasurisë	51
Grafik 42. Përqindja e pasurisë neto zotëruar nga përqindja e familjeve (Kurba e Lorenzit për pasurinë neto)	51
Grafik 43. Shpërndarja e të ardhurave totale neto vjetore të familjeve (mijë lekë)	55
Grafik 44. Përqindja e të ardhurave zotëruar nga përqindja e familjeve (Kurba e Lorezos)	55
Grafik 45. Statusi i punësimit të popullsisë mbi 16 vjeç (në %)	56
Grafik 46. Shpërndarja e të punësuarve sipas sektorëve (në %)	56
Grafik 47. Shpërndarja e të vetëpunësuarve sipas sektorëve	57
Grafik 48. Burimi i të ardhurave si përqindje ndaj totalit të të ardhurave	58
Grafik 49. Mediana dhe mesatarja e shpenzimeve të familjeve (në lekë)	60
Grafik 50. Përqindja e akumuluar e shpenzimeve për ushqime dhe shpenzimeve totale zotëruar nga familjet	61
Grafik 51. Mediana e raportit të shpenzimeve ndaj të ardhurave sipas percentiles së të ardhurave (në përqindje)	63
Grafik 52. Mediana e raportit të shpenzimeve ndaj të ardhurave (në përqindje) sipas percentiles së pasurisë neto	64
Grafik 53. Mediana e shpenzimeve dhe të ardhurave totale (në të majtë) dhe pasuria totale (në të djathtë) në mijë lekë	64
Grafik 54. Përqindja e familjeve që kursejnë dhe atyre që nuk kursejnë	66
Grafik 55. Arsyt kryesore të kursimit	67

ABSTRAKT

Ky raport përmbledh rezultatet kryesore nga raundi i parë i Vrojtimit të Pasurisë së Familjeve Shqiptare, realizuar nga Banka e Shqipërisë, në fillim të vitit 2019. Qëllimi i këtij vrojtimi ishte mbledhja e të dhënave individuale mbi familjet shqiptare, fokusuar në pasurinë dhe përbërësit kryesorë të saj. Raporti paraqet rezultatet mbi aktivet (reale dhe financiare) dhe detyrimet e familjeve, treguesit e të ardhurave dhe konsumit për grupe të ndryshme të familjeve. Rezultatet e raundit të parë tregojnë se pasuria e familjeve shqiptare përbëhet kryesisht nga aktivet reale, ku banesa kryesore e familjeve është komponenti më i rëndësishëm i saj. Ndërsa aktivet financiare përbëjnë një pjesë të vogël të totalit të aktiveve të individëve. Për më tepër, të dhënat sugjerojnë një sjellje heterogjene të familjeve shqiptare bazuar në tregues të ndryshëm të bilancit të familjeve.

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Ky raport paraqet një përmbledhjeve të të dhënave të marra nga "Vrojtimi i Pasurisë i Familjeve Shqiptare" (AHWS), i zhvilluar nga Banka e Shqipërisë (BSH), në fillim të vitit 2019, i cili ka për qëllim mbledhjen e të dhënave mikro mbi pasurinë reale dhe financiare të familjeve shqiptare, bazuar në një metodologji të standardizuar të Bankës Qendrore Evropiane (BQE).

Analizimi në nivel mikro i familjeve është shumë i rëndësishëm dhe me vlerë të shtuar për kërkimin shkencor dhe analizat që bën banka qendrore në funksion të objektivit dhe politikave të saj në terma të politikës monetare, stabilitetit financiar, përfshirjes financiare dhe edukimit financiar. Familjet janë të ndryshme (heterogjene) jo vetëm për sa i përket financave personale, por edhe për sa i përket sjelljes së tyre ndaj goditjeve të ndryshme makroekonomike që mund të vijnë nga: ndryshimet në normat e interesit, ndaj çmimit të shtëpive, taksave, skemave të pensionit, politikave të punësimit, etj. Nga ana tjetër analizimi i të dhënave mikro bën të mundur identifikimin dhe eksplorimin më të mirë të sjelljes heterogjene të familjeve bazuar në nivele të ndryshme të edukimit, të moshës së kryefamiljarit, nivelit të të ardhurave, konsumit, nivelit të borxhit dhe pasurisë së familjeve shqiptare.

Të dhënat mbi **aktivet totale të familjeve** tregojnë që:

- aktivet totale të familjeve përbëhen nga aktivet reale dhe aktivet financiare të familjeve, ku aktivet reale përbëjnë 93% të totalit të portofolit të aktiveve totale, ndërsa aktivet financiare përbëjnë vetëm 7% të tyre;
- mediana dhe mesatarja e aktiveve totale është përkatësisht 5.7 milion lekë dhe 8.5 milion lekë, që tregon për nivel të konsiderueshëm të heterogjenitetit të familjeve në Shqipëri;
- 93% e familjeve shqiptare janë pronarë (të plotë ose të pjesshëm) të banesës së tyre kryesore, me një medianë dhe mesatare të vlerës së saj përkatësisht 5.04 dhe 5.92 milion lekë;
- automjetet/motomjetet zotërohen nga 40% e familjeve, ndjekur nga pasuritë e tjera të patundshme që zotërojnë 36% e familjeve. Aktivet që zotërohen më pak nga familjet janë bizneset (të zotëruar nga 13% e familjeve), si dhe sendet me vlerë (të zotëruara nga 12% e familjeve);
- të dhënat mbi normën e zotërimit të aktiveve financiare tregojnë për një përfshirje financiare të ulët të familjeve: 10% e familjeve kanë llogari rrjedhëse, 7% e familjeve kanë depozitë, 5% e familjeve kanë dhënë para borxh;
- llogaritë rrjedhëse dhe depozitat janë forma kryesore e investimeve financiare të familjeve shqiptare.

Të dhënat e **detyrimeve** të familjeve tregojnë që:

- vetëm 30% e numrit total familjeve në Shqipëri kanë të paktën një borxh. Nga familjet që kanë të paktën një borxh, 45% e familjeve i janë drejtuar sistemit financiar (bankave dhe institucioneve financiare jo-banka) dhe 55% i janë drejtuar burimeve të tjera jashtë sistemit financiar (kryesisht të afërmeve dhe familjarëve);
- në totalin e kredive të marra nga sistemi financiar 25% të rasteve janë kredi hipotekare, ndërsa 75% e huamarrjeve përfaqësojnë kredi të pakolaterizuara (kredi konsumatore, overdraft dhe kartë krediti);
- të dhënat tregojnë se vlera e portofolit të borxhi formal përbëhet nga: kredia hipotekare (56%), kredia konsumatore (33%) dhe overdraft-i dhe karta krediti (11%).

Të dhënat mbi të **ardhurat e familjeve** pasqyrojnë se:

- Mediana e të ardhurave vjetore neto të familjeve është 723,108 lekë (ose 60,259 lekë në muaj, ndërsa mesatarja është 961,379 lekë (ose 80,115 lekë në muaj).
- Niveli i pabarazisë së të ardhurave është i lartë. 10% e familjeve me të ardhurat më të larta, zotërojnë 32% të totalit të të ardhurave të gjithë popullsisë.

Të dhënat e konsumit tregojnë që:

- shpenzimet mesatare mujore të familjeve për ushqime dhe shërbime janë 35,388 lekë, ku shpenzimet mesatare mujore të familjeve për ushqime janë 28,293 lekë. Pjesa tjetër e shpenzimeve ka të bëjë me shpenzimet për energji elektrike, ujë, gaz, telefon e internet;
- shpenzimet për ushqime brenda shtëpisë dhe shpenzimet për energji elektrike përbëjnë përkatësisht 69% dhe 11% të totalit të shpenzimeve;
- prirja mesatare për konsum, përcaktuar si përqindja e të ardhurave totale të familjeve shpenzuar për të mira dhe shërbime, është 67%, ndërsa mediana është 56%.

I. HYRJJE

1.1 Vrojtimi dhe qëllimi i realizimit të tij

“Vrojtimi i Pasurisë së Familjeve shqiptare” (AHWS) i iniciuar nga BSH-ja ka për qëllim mbledhjen e të dhënave nga bilancet individuale të familjeve shqiptare, duke na mundësuar njohjen e aspekteve të ndryshme të sjelljes së tyre në lidhje me aktivitetet dhe detyrimet e familjes, kursimet, investimet dhe konsumin. Ky vërtetim bazohet në një metodologji të standardizuar të propozuar nga NHFCS¹ (Network of Household Finance and Consumption Survey), nën drejtimin e BQE-së, duke siguruar që të dhënat e mbledhura në nivel familjeje të jenë të unifikuara dhe të krahasueshme me vendet e zonës së euros, që aplikojnë këtë vërtetim.

¹ Ku bëjnë pjesë 20 vende të Eurozonës si: Belgjika, Gjermania, Estonia, Irlanda, Greqia, Spanja, Franca, Italia, Qipro, Luksemburgu, Letonia, Malta, Austria, Holanda, Portugalia, Sllovenia, Sllovakia dhe Finlanda. Për më shumë informacion në lidhje me të dhënat dhe punën kërkimore bazuar mbi këtë bazë të dhënash referojuni: https://www.ecb.europa.eu/pub/economic-research/research-networks/html/researcher_hfnc.en.html.

Analizimi në nivel granular i familjeve është shumë i rëndësishëm dhe me vlerë të shtuar për kërkimin shkencor dhe analizat që bën banka qendrore në funksion të objektivit dhe politikave të saj. Familjet karakterizohen nga një nivel i konsiderueshëm heterogjeniteti, jo vetëm për sa i përket financave të tyre, por edhe për sa i përket sjelljes që ato shfaqin ndaj tyre. Kështu, bazuar në nivelin e të ardhurave, pasurisë (reale dhe financiare), faktorëve demografikë e të tjerë, familjet marrin vendime të ndryshme në lidhje me: konsumin, kursimin, investimet, marrjen e borxhit etj., si dhe reagojnë ndryshe ndaj goditjeve makroekonomike me të cilat përballen. Kjo ka bërë që një vëmendje më e shtuar t'i kushtohet analizimit të të dhënave në nivel mikro për të ilustruar më së mirë diferencat që ekzistojnë në të dhënat e familjes, gjë që është e vështirë për t'u identifikuar dhe për t'u eksploruar nga të dhënat e agreguara. Nga njëra ana, të dhënat mikro të japin mundësinë për të parë se si tregues të ndryshëm financiarë luhaten sipas grupimeve të familjeve, ndarë në bazë të disa faktorëve socio-ekonomikë. Nga ana tjetër këto grupime shërbejnë për të evidentuar grupet që janë më të ekspozuara ndaj rreziqeve të ndryshme financiare dhe ekonomike.

Pyetësori i vrojtimit² është i strukturuar në 6 module, prezantuar si më poshtë:

- Moduli i parë, Karakteristikat Demografikë, ka për qëllim mbledhjen e informacionit mbi cilësitë e të gjithë anëtarëve të familjes, që kanë të bëjnë me: moshën, gjininë, vendlindjen, edukimin, informacionin mbi statusin civil etj.;
- Moduli i dytë, Aktivitet Reale dhe Kredia, ka për qëllim marrjen e informacionit mbi tërësinë e aktiveve reale që zotëron familja që nga pasuritë e patundshme e deri tek automjetet, aktive të tjera si bizhuteri, vepra arti etj. Gjithashtu merret informacion edhe mbi kreditë që ka marrë familja, termat dhe kushtet e marrjes së kredisë.
- Moduli i tretë, Aktivitet (investimet) Financiare dhe Kursimet, ka për qëllim mbledhjen e informacionit mbi përfshirjen financiare të familjeve në lidhje me produktet financiare si: llogaritë bankare, llogaritë e kursimit, fondet e përbashkëta, letrat me vlerë dhe pasuritë e tjera financiare;

² Në mënyrë më të detajuar, struktura e pyetësorit është prezantuar në figurën 1.


- Moduli i katërt, Punësimi, synon mbledhjen e informacionit mbi statusin aktual të punësimit të çdo anëtarit të familjes mbi 16 vjeç, sipas profesionit, kohëzgjatjes së punësimit, sektorit të aktivitetit, kohëzgjatjes së kontratës etj.
- Moduli i pestë, Të Ardhurat dhe Pasuri të tjera, mbledh informacion mbi burimet kryesore të të ardhurave të familjes. Përveç pyetjeve rreth të ardhurave, moduli përmban pyetje plotësuese në lidhje me pasuritë e tjera familjare si trashëgimitë dhe dhuratat e përfituara.
- Moduli i gjashtë, Konsumi dhe treguesit e tij, ka për qëllim marrjen e informacionit mbi shpenzimet totale të familjeve për të gjitha mallrat dhe shërbimet e domosdoshme të konsumit të familjeve.

Ky material ka për qëllim përshkrimin e rezultateve të marra nga Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS), duke analizuar të dy anët e bilancit të familjeve, si dhe duke dhënë një përshkrim mbi të ardhurat dhe konsumin e familjeve.

Vrojtimi iu drejtua gjithsej 2,496 familjeve, nga të cilat 2,261 e plotësuan pyetësin (91% e familjeve të targetuara), ndërsa pjesa tjetër, pra më pak se 10%, nuk u gjetën ose refuzuan të merrnin pjesë në vërtetim. Rezultatet e marra nga ky vërtetim janë të peshuara, gjë që tregon se ato shërbejnë për të përgjithësuar sjelljen e të gjithë popullatës të shpërndarë në territorin e Shqipërisë. Megjithatë, duke qenë se këto janë të dhënat e marra nga rrethi i parë i këtij vërtetimi, ato duhet të shërbejnë për të dhënë një fotografim të parë të situatës dhe duhen interpretuar me kujdes.

Materiali është i strukturuar si më poshtë: në pjesën e dytë dhe të tretë është dhënë një pasqyrim të zërave të aktiveve dhe të detyrimeve të familjeve, duke dhënë normën e zotërimit të tyre, medianën dhe kompozimin e secilës anë të bilancit; në pjesën e katërt është paraqitur analiza mbi pasurinë neto të familjeve; në pjesën e pestë dhe të gjashtë janë prezantuar të dhënat mbi të ardhurat dhe konsumin e familjeve shqiptare.

Figura 1. Struktura e Anketës mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS)



Burimi: ECB, 2016.

1.2 Mbledhja e të dhënave

Raundi i parë i Vrojtimit mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare, siç e përmendëm edhe më lart, u hartua nga BSH-ja, dhe mbledhja e informacionit në terren u bë nga INSTAT-i gjatë periudhës mars-prill 2019, nëpërmjet metodës së intervistës ballë për ballë.

Objekt të këtij vrojtimi kanë qenë familjet dhe mbledhja e informacionit të detajuar mbi aspekte të ndryshme të sjelljes së tyre. Këtu me familje kuptojmë një individ ose grup individësh që jetojnë së bashku dhe që ndajnë shpenzimet midis tyre. Nga ky grupim janë përjashtuar: individët që jetojnë në shtëpitë e të moshuarve, në konvikte, në burgje, në ushtri, të pastrehët, si dhe individët që jetojnë në banesa kolektive.

Zgjedhja e kampionit të familjeve u bë nga INSTAT, bazuar në procedurën me dy hapa. Njësitë e hapit të parë (PSU-primary sampling unit) janë zonat e Censurit të homogjenizuara me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censurit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë, zgjidhen sipas metodës sistematike me probabilitet të barabartë me një numër fiks familjesh. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastësishme, duke siguruar një përfaqësim edhe në nivel qarku. Madhësia e popullsisë në dymbëdhjetë qarqet e Shqipërisë u përdor si kriter shtresëzimi, në mënyrë që të ketë një përfaqësim të plotë të gjitha familjeve në territorin e Shqipërisë. Në mungesë të një regjistri mbi të ardhurat e familjes, nuk u bë i mundur një mbipeshim (*over-sampling*) i familjeve më të pasura për të dhënë një pasqyrim më të mirë të pasurisë, duke marrë në konsideratë shpërndarjen jo-uniforme të saj.


Në total kishim në dispozicion 312 PSU (Primary Sampling Unit) me nga 8 (plus 4) familje të zgjedhura për secilin prej tyre, për të marrë informacion mbi tërësinë e aktiveve, detyrimeve, të ardhurat dhe konsumin e familjeve. Në fund të procesit të mbledhjes së pyetësorëve, u mblodh informacioni për 2,261 familje, të cilët përbëjnë bazën kryesore të të dhënave të këtij raporti.

1.3 Statistika përshkruese të familjeve shqiptare


Duke qenë se baza kryesore e informacionit është familja, një faktor mjaft i rëndësishëm për marrjen e përgjigjeve sa më sakta është evidentimi i personit të referencës. Personi i referencës është ai person në familje që ka më shumë njohuri në lidhje me të ardhurat, shpenzimet, konsumin dhe çdo veprimtari tjetër të familjes, të lidhur

me ekonominë e saj. Duke qenë se familjet janë të ndryshme, jo vetëm sipas nivelit të ardhurave dhe pasurisë neto, por edhe sa i përket edukimit, moshës, statusit të punësimit etj. të personit të referencës, këto karakteristika janë përdorur si elemente për të parë diferencimet midis familjeve.

Të dhënat e vërtetimit tregojnë që madhësia mesatare e familjeve në Shqipëri është 3.4 anëtarë dhe me një medianë 4 anëtarë. Të shpërndarë sipas numrit të anëtarëve të familjes (grafiku 1), vërehet se 29% e familjeve në Shqipëri kanë 5 dhe më shumë anëtarë, 24% dhe 22% e familjeve kanë përkatësisht 4 dhe 2 anëtarë, ndërsa në përqindje më të ulët janë familjet me 3 dhe 1 anëtarë.



Shpërndarë sipas dymbëdhjetë qarqeve kryesore (grafiku 2), më pak se 1/3 e të gjitha familjeve janë të vendosura në qarkun e Tiranës. Elbasani, Durrësi dhe Fieri janë tre qarqet e tjera ku janë vendosur 31% e totalit të familjeve. Qarku i Kukësit, ai i Beratit dhe ai i Gjirokastrës, kanë përqindjen më të ulët të familjeve, me rreth vetëm 3% të tyre secili.



Në tabelën 1 janë pasqyruar të dhënat në lidhje me strukturën e familjeve shqiptare, duke marrë në konsideratë karakteristikat e personit të referencës si: moshë, edukimi apo statusi i punësimit. Vërehet se moshë mesatare e personit të referencës është 56 vjeç dhe afërsisht 50% e familjeve e kanë personin e referencës në grupmoshën 45-64 vjeç, 30% e familjeve e kanë personin e referencës mbi 64 vjeç dhe 20% e familjeve e kanë personin e referencës më të ri se 44 vjeç.

Parë sipas nivelit të edukimit, vërejmë se 52% e familjeve e kanë personin e referencës me nivel të ulët edukimi, pra që kanë mbaruar shkollën 8- ose 9-vjeçare. 36% e familjeve e kanë personin e referencës me shkollë të mesme ose nivel të dytë edukimi dhe vetëm 13% e familjeve e kanë personin e referencës me shkollë të lartë. Siç do ta shikojmë edhe më poshtë, niveli i edukimit të personit të referencës lidhet edhe me aspekte të tjera të familjes që kanë të bëjnë me nivelin e të ardhurave dhe të pasurisë së familjes.

Bazuar në statusin e punësimit të personit të referencës: 47% e familjeve e kanë personin e referencës të punësuar dhe të vetëpunësuar; 32% e familjeve e kanë personin e referencës pensionist; 15% e kanë të papunë; dhe 6% e kanë personin e referencës me paaftësi të përhershme, duke punuar pa pagesë etj.

Tabela 1. Shpërndarja e familjeve shqiptare në 2019 bazuar në karakteristikat e personit të referencës

Moshja e personit të referencës	16-34 vjeç	35-44 vjeç	45-54 vjeç	55-64 vjeç	65-74 vjeç	75+vjeç
	8%	14%	22%	26%	17%	13%
Edukimi i personit të referencës	Niveli i parë 52%	Niveli i dytë 36%	Niveli i tretë 13%			
Statusi i punësimit të personit të referencës	I punësuar 26%	I vetëpunësuar 21%	Pensionist 32%	I papunë 15%	Tjetër [†] 6%	
Statusi i pronësisë të banesës kryesore	Pronar ^{iv} 93%	Me qira 5%	Tjetër ^v 2%			

Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

[†] Niveli i parë i edukimit është niveli më i ulët i edukimit dhe përfshin ata persona që kanë mbaruar ose jo ndonjë klase filllore ose kanë mbaruar shkollën filllore apo shkollën 8-9 vjeçare. Niveli i dytë i edukimit përfshin mbarimin ose jo të shkollës së mesme ose mbarimin ose jo të shkollës profesionale. Niveli i tretë i edukimit përfshin mbarimin e shkollës së lartë, të masterit, doktoratës ose nivele edukimi të barasvlershme me to.

ⁱⁱ Këtu përfshihen të gjithë personat që kanë paftësi të përhershme, ata që janë duke punuar pa pagesë, studentët, si dhe çdo kategori tjetër.

ⁱⁱⁱ Banesa kryesore e shtëpisë përcaktohet si vendbanimi ku zakonisht jetojnë pjesëtarët e familjes, që mund të jetë një shtëpi, apartament ose vilë. Një familje mund të ketë vetëm një vendbanim kryesor në çdo kohë të caktuar, edhe pse ata mund të ndajnë banesën me njerëz që nuk i përkasin familjes.

^{iv} Pronar i të gjithë ose i një pjese të banesës kryesore.

^v Duke jetuar pa pagesë.

Ndërsa në tabelën 2 janë paraqitur të dhënat mbi strukturën e familjeve, shpërndarë sipas 12 qarqeve kryesore. Vërehet se Tirana është qarku me përqindjen më të lartë të personit të referencës me moshë të re, përkatësisht në grup-moshën 16-44 vjeç. Qarqet e Kukësit, Fierit dhe Dibrës kanë përqindjen më të lartë të personit të referencës në moshë mesatare që i përket grup-moshës 45-64 vjeç. Ndërsa, qarku i Vlorës dhe ai i Gjirokastrës, janë qarqet që e kanë personin e referencës me moshë më të madhe, ku 44% dhe 42% i përkasin grup-moshës mbi 65 vjeç.

Tabela 2. Struktura e familjeve sipas qarqeve kryesore të Shqipërisë

Qarqet kryesore	Struktura e familjeve bazuar në karakteristikat e personit të referencës								
	Mosha e PR-së			Niveli i edukimit i PR-së			Statusi i punësimit i PR		
	16-44	45-64	65-75+	Niveli i I-rë	Niveli i II-të	Niveli i III-të	Papunë	Pensionist	Punësuar
Berat	26%	40%	34%	62%	35%	3%	12%	40%	49%
Dibër	23%	54%	23%	73%	24%	4%	32%	30%	38%
Durrës	17%	51%	33%	48%	41%	11%	13%	33%	54%
Elbasan	28%	47%	24%	64%	29%	7%	24%	26%	50%
Fier	14%	54%	32%	56%	37%	7%	14%	34%	52%
Gjirokastrë	13%	45%	42%	51%	39%	10%	20%	43%	36%
Korçë	20%	47%	33%	57%	35%	8%	14%	31%	55%
Kukës	29%	54%	17%	60%	32%	8%	24%	22%	54%
Lezhë	19%	53%	28%	54%	38%	8%	21%	32%	47%
Shkodër	18%	53%	30%	52%	39%	9%	20%	32%	47%
Tiranë	29%	45%	27%	39%	37%	24%	27%	29%	44%
Vlorë	18%	38%	44%	53%	38%	10%	20%	46%	34%

Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

II. AKTIVET

Aktivet e familjeve përbëhen nga dy komponentë kryesorë, aktivet reale dhe aktivet financiare. Në këtë pjesë do të trajtohen tre elemente kryesore të bilancit të aktiveve të familjeve që kanë të bëjnë me: përqindjen e familjeve që zotërojnë një aktiv të caktuar (normën e zotërimit), vlerën e aktiveve, si dhe dekompozimin e aktiveve, sipas përqindjes së zotërimit të secilit aktiv nga familjet, por edhe vlerës së tyre. Rëndësi i është kushtuar edhe diferencave që ekzistojnë midis familjeve, duke marrë në konsideratë karakteristikat dhe veçoritë e tyre.

II.1 Aktivet reale

Aktivitet reale të familjeve përbëhen nga këta komponentë: banesa³ kryesore e familjeve, pasuritë e tjera të patundshme⁴, mjetet e transportit⁵, sendet me vlerë⁶ dhe vlera e bizneseve familjare⁷ të zotëruara nga familja.

Të dhënat e normës së zotërimit⁸ të aktiveve reale paraqitur në grafikun 3 tregojnë se banesa kryesore është aktivi real që zotërohet më së shumti nga familjet shqiptare, konfirmuar nga 93% e tyre, ndërsa aktivitet e tjera të rëndësishme janë automjetet, të cilat zotërohen nga 40% e familjeve, ndjekur nga pasuritë e tjera të patundshme, të cilat zotërohen nga 36% e familjeve. Aktivitet që zotërohen më pak nga familjet janë bizneset familjare (që zotërohet nga 13% e familjeve), si dhe sendet me vlerë (që zotërohen nga 12% e familjeve).

Grafikët 4 dhe 5 paraqesin përqindjen e zotërimit të secilit aktiv, duke marrë në konsideratë statusin e punësimit të personit të referencës⁹, si dhe shpërndarjen e të ardhurave neto vjetore të familjeve, sipas kuantileve.

³ *Banesa kryesore e familjes përkufizohet si vendbanimi ku jetojnë pjesën më të madhe të kohës pjesëtarët e familjes, zakonisht është një shtëpi ose apartament. Një familje mund të ketë vetëm një vendbanim kryesor në çdo kohë të caktuar, edhe pse banesën mund ta ndajnë edhe me njerëz që nuk i përkasin familjes. Për udhëtarët e shpeshtë ose njerëzit që jetojnë në shtëpi të shumëfishta, vendbanimi kryesor përcaktohet rast-pas-rasti, sipas faktorëve të mundshëm që ndikojnë, si për shembull: koha e kaluar në vendbanim gjatë një viti, adresa postare, statusi i taksave, lista telefonike, vendi i kryerjes së votimit, si dhe vendndodhja në policat e sigurimit të objekteve.*

⁴ *Pasuritë e tjera të patundshme të familjes përfshijnë apartamente, shtëpi, toka, përveç banesës kryesore.*


⁵ *Në vërtetimin e AHVVS, është marrë informacion në lidhje me automjetet dhe mjetet e tjera që zotëron familja, si për shembull mjete të tjera transporti, si motoçikletë, kamion, furgon, avion, varkë, jaht etj.. Automjetet dhe mjetet e tjera mund të shiten në tregun sekondar si të tilla, ato përbëjnë një aktiv të rëndësishëm real. Përfshirja e mjeteve dhe automjeteve, si dhe e pasurisë së familjeve është bërë në përputhje me HFCS, që bazohet tek manuali i statistikave mikro mbi pasurinë e familjeve (Manual on Micro Statistics on Household Wealth), ndryshe nga llogaritë kombëtare që zakonisht i konsiderojnë këto si të mira të qëndrueshme (durables) dhe që i përjashtojnë nga aktivitet reale të familjeve.*

⁶ *Sendet apo objekte me vlerë i referohemi veprave të artit, objekteve antike, bizhuterive etj.*

⁷ *Biznese familjare, ku të paktën një anëtar i familjes është i vetëpunësuar ose ka një rol aktiv në drejtimin e biznesit.*

⁸ *Norma e zotërimit ka të bëjë me përqindjen e familjeve ndaj totalit të tyre që zotërojnë një aktiv të caktuar. Përqindjet e zotërimit llogariten vetëm për familje që përgjigjen, ndërsa nuk kemi përdorur një metodë inputimi për mospërgjigjet.*

⁹ *Personi i referencës (RP) është një anëtar i familjes (ose jo), i cili ka më shumë njohuri mbi nivelin e të ardhurave, shpenzimeve dhe aktiveve të familjes.*




Grafikët 4 dhe 5 tregojnë që banesa kryesore ku jetojnë familjet është aktivi real që zotërohet nga pothuajse pjesa më e madhe e familjeve, pavarësisht karakteristikave të tyre.

Parë sipas statusit të punësimit të personit të referencës vërehet se: pasuritë e tjera të patundshme zotërohen më së shumti nga familjet që kanë personin e referencës të vetëpunësuar; mjetet e transportit zotërohen pothuajse nga të gjitha familjet, më së shumti nga të punësuarit dhe të vetë-punësuarit; ndërsa bizneset familjare zotërohen kryesisht nga të vetë-punësuarit.

Bazuar në nivelin e të ardhurave, vërehet se me rritjen e të ardhurave, ulet pak përqindja e zotërimit të banesës kryesore, por rritet përqindja e zotërimit të aktiveve të tjera, kryesisht mjete transporti.


Parë sipas moshës së personit të referencës (grafiku 6), vërehet se personat e referencës me moshë më të re kanë një normë më të ulët të zotërimit të aktiveve reale përkundrejt atyre me moshë më të madhe, si dhe një normë më të lartë të zotërimit të mjeteve të transportit. Një përmbledhje më e detajuar e përqindjes së zotërimit të secilit aktiv nga familjet bazuar në faktorë të ndryshëm socio-ekonomike është dhënë në tabelën 3, ku mund të vërehen edhe diferencat midis familjeve të ndryshme.

Grafik 4. Përqindja e zotërimit të aktiveve reale sipas statusit të punësimit të personit të referencës




Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 5. Përqindja e zotërimit të aktiveve reale sipas kuantileve të nivelit të ardhurave vjetore neto të familjeve



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 6. Përqindja e zotërimit të aktiveve reale sipas moshës së personit të referencës



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Tabela 3. Norma e zotërimit¹⁰ të aktiveve reale bazuar në karakteristikat kryesore të familjeve (në përqindje)


Karakteristikat e familjeve	Banesa kryesore e familjes	Pasuri të tjera të patundshme	Mjete transporti	Sende me vlerë	Biznes familjar
Totali i familjeve	92.7	35.9	37.1	11.7	12.7
Numri i anëtarëve të familjes					
1	87.4	19.5	37.7	22.0	2.8
2	91.7	35.2	35.9	25.0	9.4
3	91.8	37.4	17.9	30.0	14.5
4	91.0	36.8	0.0	38.0	16.5
5 e më shumë	96.8	39.4	0.0	38.0	13.6
Statusi i pronësisë					
Pronar i të gjithës	100.0	37.1	37.7	11.9	12.7
Me qira	0.0	19.3	35.9	8.1	10.6
Tjetër (Jeton pa pagesë)	0.0	26.5	17.9	12.2	15.8
Percentilja e të ardhurave					
Poshtë 20	92.7	32.9	31.4	12.3	4.5
20-39.9	93.7	44.3	31.2	10.4	15.0
40-59.9	94.8	40.0	42.8	12.1	22.4
60-79.9	95.9	41.0	39.8	10.7	18.9
80-100	90.3	30.7	41.6	12.1	11.9
Percentilja e pasurisë neto					
Poshtë 20	80.4	27.4	44.4	7.9	6.8
20-39.9	98.5	32.3	44.4	8.8	7.6
40-59.9	99.8	37.1	43.2	14.2	10.9
60-79.9	98.7	39.1	40.9	18.3	12.5
80-100	87.5	41.7	26.3	9.6	22.7
Mosha e personit të referencës					
16-34	60.8	26.4	44.4	9.4	13.8
35-44	90.3	35.9	44.4	13.6	14.3
45-54	93.6	35.5	43.2	12.3	13.0
55-64	97.8	41.5	40.9	9.6	17.9
65-74	98.9	31.7	26.3	11.7	7.7
75+	97.3	37.4	20.5	14.4	5.8
Statusi i punësimit të personit të referencës					
I punësuar	86.3	22.0	52.4	13.9	6.9
I vetëpunësuar	95.3	65.9	43.2	10.3	36.0
Pensionist	97.0	32.1	24.3	12.9	6.1
Papunë	94.7	27.3	34.8	8.4	7.7
Tjetër	82.7	33.3	24.3	9.3	4.6
Edukimi i personit të referencës					
Niveli i parë	95.7	42.8	25.3	10.7	11.2
Niveli i dytë	91.0	32.0	45.5	12.7	14.9
Niveli i tretë	85.3	18.9	61.7	13.0	12.6

Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).


¹⁰ Norma e zotërimit të secilit aktiv llogaritet si përqindje e familjeve që zotëron një aktiv ndaj totalit të familjeve.

Mediana e vlerës totale të pasurisë reale, bazuar në vetë-deklarimin e bërë nga familja është 5.9 milion lekë, ndërsa mesatarja është 6.8 milion lekë (grafiku 7). Shpërndarja e vlerës së aktiveve (pasurisë) reale të familjeve tregon se ajo luhetet nga niveli më i ulët 2.2 milion lekë (percentilja e 5-të) në 14.6 milion lekë, niveli më i lartë i të ardhurave (percentilja e 95-të).

Në grafikun 8 kemi paraqitur medianën e vlerës së aktiveve reale në mijë lekë. Të dhënat tregojnë që mediana e vlerës së banesës kryesore të familjes është 4.9 milion lekë dhe përbën komponentin kryesor të aktiveve reale. Më pas vijjnë pasuritë e tjera të patundshme, me një vlerë afërsisht 1.3 milion lek, ndjekur nga vlera e biznesit familjar, rreth 0.5 milion lekë. Ndërsa në grafikët në vijim është paraqitur mediana e vlerës së aktiveve grupuar sipas nivelit të punësimit të personit të referencës, nivelit të ardhurave neto të familjeve dhe moshës së personit të referencës (grafikët 9, 10 dhe 11). Të dhënat tregojnë se banesa kryesore e familjes përbën aktivin real më të rëndësishëm të familjeve shqiptare, si në bazë të nivelit të punësimit, ashtu edhe në bazë të nivelit të të ardhurave.




Grafik 8. Mediana e vlerës së komponentëve të aktiveve reale (në mijë lekë)




Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 9. Mediana e vlerës së aktiveve reale sipas statusit të punësimit të personit të referencës




Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 10. Mediana e vlerës së aktiveve reale sipas kuantileve të nivelit të ardhurave vjetore neto të familjeve (mijë lekë)



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).



II.2 Pasuritë e patundshme të familjeve


a) Banesa kryesore e familjes

Banesa kryesore e familjes përkufizohet si vendbanimi ku zakonisht jetojnë pjesëtarët e familjes, për shembull një shtëpi ose apartament. Një familje mund të ketë vetëm një vendbanim kryesor, edhe pse mund ta ndajë banesën me njerëz që nuk i përkasin asaj. Ashtu siç e përmendëm edhe më lart, vërehet se kemi një përqindje të lartë të zotërimit të shtëpive. Gjithashtu, banesa kryesore e familjes përbën komponentin më të rëndësishëm të portofolit të aktiveve reale të familjeve, duke përbërë mesatarisht 70% të vlerës së tij. Bazuar mbi përgjigjet e vërtetimit, 32% e familjeve e kanë përfitur banesën e tyre kryesore deri në vitin 1991, 18% e kanë përfitur banesën gjatë viteve 1991-1996, dhe 50% e familjeve mbas vitit 1996. Familjet mesatarisht kanë 27 vjet që jetojnë në banesën kryesore, një periudhë kjo që mund të dëshmojë se familjet preferojnë qëndrueshmërinë, duke jetuar në të njëjtën banesë për periudha afatgjata.

Bazuar mbi mënyrën e përfitimit të banesës kryesore, për familjet që janë plotësisht apo pjesërisht pronare të banesës, 49% familjeve

janë shprehur se e kanë ndërtuar vetë, 34% e familjeve e kanë blerë, 16% e kanë trashëguar dhe vetëm 1% e kanë marrë dhuratë (grafiku 12).


Grafik 12. Mënyra e përfitimt të banesës kryesore, e të cilës familjet janë pronare



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Për sa i përket vlerës së banesës kryesore, ajo luhet nga 1.9 milion lekë, percentilja e 5-të (niveli më i ulët) në 12.1 milionë lekë, percentilja e 95-të (niveli më i lartë) (grafiku 13). Vlera e medianës dhe e mesatares të banesës kryesore janë përkatësisht 5.0 milionë dhe 5.9 milionë lekë. Metoda e matjes së vlerës së banesës kryesore nuk bazohet mbi çmimin e tregut, por mbi pritshmërinë e familjeve mbi vlerën me të cilën ato do të mund ta shisnin atë sot. Pavarësisht faktit se kjo metodë mbart gabim në matje si pasojë e elementit të perceptimit, familjet marrin vendime bazuar mbi pritshmërinë e tyre për të ardhmen dhe mbi pasurinë e akumuluar, e për rrjedhojë është e domosdoshme që kjo të merret në konsideratë për të analizuar sjelljen e familjes. Vërejmë se vlera e banesës kryesore të familjes është proporcionale me nivelin e pasurisë neto të familjeve ku në kuantilen e 5-të të pasurisë, vlera mesatare e banesës kryesore është e barabartë me afërsisht 10 milionë lekë (grafiku 13).

Grafik 13. Vlera e banesës kryesore sipas perceptimit të familjeve (në mijë lekë)




Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

b) Pasuri të tjera të patundshme

Pasuritë e tjera të patundshme¹¹ janë aktivi i dytë më i rëndësishëm për nga vlera në portofolin e familjeve shqiptare, duke përbërë mesatarisht 19% të totalit të pasurisë reale. Mediana dhe mesatarja e vlerës së pasurisë së patundshme është përkatësisht 1.3 milion dhe 5.9 milion lekë. Ashtu si e përmendëm edhe më lart, 36% e familjeve shqiptare zotërojnë të paktën një pasuri tjetër të patundshme përveç banesës kryesore. Ndër to, 71% e familjeve zotërojnë një tokë, 12% e familjeve një fermë bujqësore, ndërsa pjesa tjetër e familjeve (17% e tyre) zotërojnë një formë tjetër pasurie të patundshme (grafiku 14).

¹¹ Këtu përfshihet çdo pasuri e patundshme që zotëron familja si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë vendit. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe pasuritë që ka biznesi, nëse ai zotërohet plotësisht ose pjesërisht nga një ose disa prej anëtarëve të familjes. Nëse pasuria zotërohet vetëm nga biznesi, atëherë ajo nuk llogaritet si pasuri e familjes.


Grafik 14. Lloji i pasurisë tjetër të patundshme që zotërohet nga familjet në Shqipëri



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Për sa i përket qëllimit të përdorimit të pronës, 43% e familjeve e përdorin atë për qëllime të biznesit të familjeve, 32% për shtëpi pushimi ose konsum vetjak, ndërsa pjesa tjetër e familjeve (25% e tyre) e kanë dhënë me qira apo ia kanë lënë atë palëve të treta pa pagesë, ose prona është vakante për pjesën më të madhe të vitit (grafiku 15).

Grafik 15. Qëllimi kryesor i përdorimit të pronës




Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

II.3 Biznesi i familjes dhe aktive të tjera reale

c) Biznesi i familjes

Vlera e biznesit familjar përbën aktivin e tretë më të rëndësishëm në totalin e aktiveve reale. Të dhënat e tabelës 3 më lart, tregojnë se 13% e familjeve zotërojnë një biznes familjar, raport që ndryshon në varësi të nivelit të ardhurave dhe statusit të punësimit. Kështu, normën më të lartë të zotërimit të biznesit familjar e kanë familjet me nivel të ardhurash në kuantilen e 3-të, ndërsa bazuar në statusin e punësimit të personit të referencës, janë ato familje që e kanë personin e referencës të vetëpunësuar. Bizneset familjare janë të krijuara kryesisht në formën e një person fizik (raportuar nga 96.3% e familjeve që kanë një biznes), si dhe janë të orientuara kryesisht ndaj aktiviteteve në fushën e bujqësisë, tregtisë me pakicë, si dhe shërbimeve të ushqimit dhe akomodimit (grafiku 16). Të dhënat tregojnë se mesatarisht 1.8 persona të familjes janë të punësuar në biznesin e familjes.

Grafik 16. Sektorët kryesorë ku janë përqendruar bizneset familjare (në përqindje ndaj familjeve që kanë një biznes)



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Vërehet një lidhje pozitive midis vlerës së biznesit të familjeve me të ardhurat dhe me pasurinë neto të tyre, për më tepër shpërndarja është më së shumti e anuar drejt familjeve më të pasura. Gjithashtu, shpërndarja e biznesit të familjeve duket sikur ka formën e U-së së

përmbysur, bazuar në ndarjen e familjeve sipas moshës së personit të referencës.

d) Aktivitet e tjera reale

Aktivitet e tjera reale përfshijnë automjetet¹² dhe sendet me vlerë që zotëron familja. Automjetet (makinat) zotërohen përkatësisht nga 34% e familjeve në Shqipëri, ndërsa mjetet e tjera zotëron nga 6% e tyre (tabela 3). Megjithatë zotërohen nga pothuajse 40% e familjeve, ato përbëjnë vetëm 5% të totalit të vlerës së portofolit të aktive reale të familjeve. Vërehet që sa i përket normës së zotërimit të mjeteve nuk ka diferencë të mëdha ndërmjet grupeve të ndryshme. Më së shumti, mjetet zotërohen nga familjet që e kanë personin e referencës të vetëpunësuar, si dhe nga familjet ku personi i referencës është në grup-moshën 55- 64 vjeç. Mediana e vlerës së automjeteve është 0.3 milionë lekë, ndërsa mesatarja është 0.6 milionë lekë dhe rritet pozitivisht me rritjen e të ardhurave dhe pasurisë neto. Shifrat e ulëta të raportimit të vlerës së automjeteve në Shqipëri mund të lidhen me faktin që makinat blihen kryesisht në tregjet sekondarë dhe jo nëpërmjet koncesionarëve¹³.

12% e familjeve deklarojnë se zotërojnë sende me vlerë si: vepra arti, vepra antike, bizhuteri etj., të cilat përbëjnë vetëm 1% të totalit të portofolit të aktive reale të familjeve. Norma e zotërimit të tyre është e ngjashme në grupet e ndryshme të familjeve. Mediana e vlerës së sendeve me vlerë është 0.03 milionë lekë dhe shpërndarja e saj nëpër grupe është më e anuar (*skewed*) me rritjen e të ardhurave dhe të pasurisë neto.


¹² Tek kategoria automjete përfshihen mjetet me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove, si dhe motomjetet ose mjetet e tjera të transportit përfshihen motoçikletat, kamionët, furgonët, avionët, varka, mjete të transportit të veçantë etj. Në anketë, pyetet edhe për të gjitha automjetet dhe motomjetet që përdoren për biznes/biznese. Nëse automjetet/motomjetet janë në emër të një anëtari të familjes, por përdoren në biznesin e zotëruar nga familja, atëherë automjetet konsiderohen që zotërohen nga familja. Nëse automjetet/motomjetet zotërohen nga biznesi, pra ato nuk janë në emër të një anëtari të familjes, atëherë automjetet/motomjetet nuk llogariten në pronësi të familjes. Nuk llogariten këtu edhe automjetet që janë me kontratë leasing (qira financiare).

¹³ Të pyetura mbi kontratat leasing, vetëm 0.5% e familjeve raportojnë që kanë një kontratë të tillë.

II.4 Aktivet financiare


Aktivitet financiare të familjeve në vërtetim janë ndarë në këto kategori kryesore¹⁴: llogari rrjedhëse, depozita, bono thesari dhe obligacione, fonde pensioni, si dhe para që iu janë dhënë borxh të tjerëve. Mënyra e shpërndarjes të aktiveve financiare tregojnë jo vetëm për profilet e ndryshme të rrezikut që mbart secila familje, pasi çdo aktiv financiar ka një rrezik të caktuar, por edhe mbi zhvillimin e tregut financiar në Shqipëri.

Të dhënat mbi normën e zotërimit të aktiveve financiare (grafiku 17) tregojnë që 16% e familjeve kanë të paktën një aktiv financiar, duke dëshmuar për një përfshirje të ulët financiare të familjeve. Parë sipas kategorive të ndryshme, vërehet se 10% e familjeve kanë llogari rrjedhëse, 7% e familjeve kanë depozitë, 5% e familjeve u kanë dhënë para borxh të tjerëve, dhe një pjesë shumë e vogël e familjeve kanë fonde pensioni dhe letra me vlerë të qeverisë. Vërehet se llogaritë rrjedhëse dhe depozitat janë ndër treguesit financiarë që zotërohen më së shumti nga familjet shqiptare dhe norma e zotërimit të tyre shkon në linjë me të ardhurat dhe me pasurinë e familjeve.



¹⁴ Në këtë pyetësor, planët shtetërore të pensionit nuk janë konsideruar si aktive financiare, pavarësisht se ato janë premtim për një pagesë në të ardhmen. Këto aktive nuk janë likuide dhe të transferueshme, e për rrjedhojë nuk kanë karakteristikat e aktiveve financiare të përfshira në këtë vërtetim.



Mediana e vlerës së aktiveve totale financiare është 0.3 milionë lekë, ndërsa mesatarja e tyre është 0.53 milionë lekë, pothuajse sa dyfishi i vlerës së medianës (grafiku 18). Shpërndarja e vlerës së aktiveve totale financiare tregon që niveli i pasurisë financiare luhetet nga 0.01 milion lekë (percentilja e 5-të) në 3 milionë lekë (percentilja e 95-të).



II.5 Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat

Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat janë aktivet financiare që zotërohen më së shumti nga familjet shqiptare, përkatësisht nga 10 % dhe 7% e tyre. Vërehet se zotërimi i tyre është i lidhur pozitivisht me rritjen e të ardhurave. Kështu, nga më pak se 1% llogari rrjedhëse që zotërojnë familjet në kuantilen e parë të të ardhurave (familjet me të ardhurat më të ulëta), norma e zotërimit të llogarive rrjedhëse për familjet që i kanë të ardhurat në kuantilen e pestë (familjet me të ardhurat me të larta), rritet në 20% (grafiku 19). Edhe zotërimi i depozitave 6-fishohet për familjet me nivelin më të lartë të të ardhurave përkundrejt familjeve me nivelin më të ulët të të ardhurave. Familjet që kanë personin e referencës të punësuar dhe të vetëpunësuar kanë përqindjen më të lartë të zotërimit të llogarive rrjedhëse dhe depozitave përkundrejt të tjerëve (grafiku

20). Të dhënat e vërtetimit tregojnë se sa më i lartë niveli i edukimit të personit të referencës, aq më e lartë është edhe norma e zotërimit të llogarive rrjedhëse dhe depozitave (grafiku 21).



f) Para të dhëna borxh të tjerëve, si dhe aktivet e tjera

Paratë e dhëna borxh të tjerëve përbëjnë komponentin e tretë të aktiveve financiare që zotërohet nga 5% e familjeve shqiptare (grafiku 17). Vërehet se ky instrument zotërohet më shumë nga familjet me të ardhura më të larta, si dhe nga familjet që e kanë personin e referencës të vetëpunësuar dhe të punësuar.

Ndërsa për sa i përket investimeve në letra 15 me vlerë të qeverisë si bono thesari apo obligacione, ato zotërohen nga një përqindje e vogël e familjeve, përkatësisht nga 1.1% dhe 0.6% e tyre.


II.6 Aktivet totale

Aktivitet totale të familjeve përbëhen nga aktivet reale dhe aktivet financiare të familjeve, ku pesha kryesore e totalit të portofolit përbëhet nga aktivet reale. Mediana dhe mesatarja e aktiveve totale janë përkatësisht 5.7 milionë lekë dhe 8.5 milionë lekë (grafiku 22). Bazuar në shpërndarjen e vlerës së aktiveve totale, vërehet se ajo luhet nga 3 milionë lekë, percentilja më e ulët (percentilja e 5-të), në 16 milionë lekë, percentilja më e lartë (percentilja e 95-të). Vërejmë se vlera e aktiveve totale të familjeve në percentilen e 50-të është 4 herë më e madhe se ajo e percentiles së 5-të. Ndërsa vlera e aktiveve totale të familjeve në percentilen e 95-të është 3 herë më e madhe se ajo e percentiles së 50-të.

Ekzistojnë diferenca në vlerën e aktiveve midis kuantileve të pasurisë totale dhe të të ardhurave, por ajo çka është e dukshme është që vlera e pasurisë reale përbën 93% të totalit të pasurisë së familjeve, ndërsa aktivet financiare përbëjnë vetëm 7% të totalit të portofolit të pasurisë (grafiku 23). Për më tepër vërehet se portofolet e aktiveve të familjeve nuk janë të diversifikuara, por janë të dominuar nga një ose dy lloje aktivesh.

¹⁵ Duke qenë se norma e zotërimit të tyre është e vogël, kemi vendosur që të mos japim shumë informacion të disagreguar sipas vlerës së tyre, pasi përgjithësimi do të mbarte gabime.


Grafik 22. Shpërndarja e pasurisë totale të familjeve (në mijë lekë)



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).


Të dhënat tregojnë që niveli i pasurisë totale është i lidhur edhe me statusin e punësimit të personit të referencës dhe moshën e tij (grafikët 23 dhe 24). Familjet që e kanë personin e referencës të vetëpunësuar dhe të punësuar kanë një nivel më të lartë të pasurisë totale, ndërsa familjet me personin e referencës të papunë dhe tjetër kanë nivel më të ulët të pasurisë totale.

Grafik 23. Pasuria totale sipas statusit të punësuarit të personit të referencës




Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 24. Pasuria totale sipas moshës së personit të referencës



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 25. Shpërndarja e aktiveve totale sipas kuantileve të pasurisë (aktiveve totale)




Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Më i detajuar, kompozimi i pasurisë totale të familjeve është paraqitur në grafikun 26, ku pasuritë e patundshme në përgjithësi dhe banesa kryesore e familjes në veçanti, përbëjnë 80% të totalit të portofolit të pasurisë totale të familjes. Vlera e biznesit përbën vetëm 9% të totalit të pasurisë totale, automjetet dhe sendet me vlerë 5% të totalit të aktiveve totale dhe pjesa tjetër aktivitet financiar.



Vërehet që me rritjen e të ardhurave dhe të pasurisë rritet edhe

pesha që zënë pasuritë e tjera të patundshme dhe vlera e biznesit të familjes (grafiku 26).




Të dhënat e paraqitura më lart mbi normën e zotërimit të aktiveve financiare, tregojnë që kemi një nivel të ulët të përfshirjes financiare të familjeve (grafiku 17). Të dhënat nga ana tjetër tregojnë që ky nivel i ulët i përfshirjes financiare është i lidhur me nivelin e edukimit të personit të referencës dhe të gjithë personave mbi 16 vjeç. Kështu, të dhënat mbi nivelin e edukimit të personave të referencës¹⁶ tregojnë se: 52% e tyre kanë nivel të parë të edukimit, pra janë me shkollë fillore dhe nëntëvjeçare (grafiku 27); 36% janë me shkollë të mesme ose me shkollë profesionale (nivel i dytë i edukimit); dhe vetëm 13% e personave të referencës janë me nivel të tretë edukimi (shkollë të lartë, master etj.) Ndërkohë që sipas të dhënave mbi nivelin e edukimit të të gjithë popullsisë mbi 16 vjeç: 39% e popullsisë ka mbaruar shkollë fillore dhe nëntëvjeçare; 46% janë me shkollë të mesme ose/dhe shkollë profesionale; dhe 15% kanë mbaruar shkollë të lartë apo më shumë (grafiku 28).

¹⁶ Personat që kanë më shumë njohuri mbi shpenzimet dhe investimet e familjes, që janë njëkohësisht edhe personat që marrin vendimet për të.



Gjithashtu, përfshirja e ulët financiare duket se është e lidhur edhe me qëndrimin që kanë familjet ndaj rrezikut financiar (grafiku 29). Familjet pyetën në lidhje me qëndrimin apo sjelljen e tyre ndaj rrezikut financiar, pra nëse ato janë të gatshme apo jo të ndërmarrin rrezik financiar. Alternativat, mes të cilave ato duhet të zgjedhin janë: (i) nuk jam i gatshëm të ndërmarr asnjë rrezik financiar; (ii) ndërmarr rrezik mesatar duke pritur të fitoj kthim mesatar; (iii) jam i

gatshëm të ndërmarr rrezik mbi mesataren, duke pritur të fitoj kthim mbi mesataren; (iv) ndërmarr rrezik të konsiderueshëm financiar, duke pritur të fitoj kthim të konsiderueshëm. Të dhënat tregojnë që 75% e familjeve nuk janë të gatshme të marrin asnjë rrezik financiar, 14% janë të gatshme të ndërmarrin rrezik mesatar, 9% të ndërmarrin rrezik mbi mesatar dhe 3% të ndërmarrin rrezik të konsiderueshëm.




III. DETYRIMET E FAMILJEVE

Në këtë pjesë analizohet pjesa e detyrimeve të familjeve shqiptare fokusuar në kompozimin dhe vlerën e tij. Vlera e stokut të detyrimeve është llogaritur vetëm për familjet që kanë deklaruar që kanë një detyrim të caktuar. Për të parë sa shqetësues është ky detyrim për kategori të ndryshme të familjeve kemi llogaritur edhe disa tregues të tjerë, të cilat diskutohen në fund të kësaj pjesë.


III.1 Kredia

Të dhënat tregojnë se vetëm 30% e numrit total të familjeve në Shqipëri kanë të paktën një detyrim financiar, nga të cilat, 45% e familjeve i janë drejtuar sistemit financiar (bankave dhe institucioneve financiare jo-banka) dhe 55% i janë drejtuar burimeve të tjera jashtë sistemit financiar. Në totalin e kredive të marra nga sistemi financiar, 25% të rasteve janë kredi hipotekare, ndërsa 75% e huamarrjeve përfaqësojnë kredi të pakolaterizuar (kredi konsumatore, overdraft dhe kartë krediti). Vërehet se shpërndarja e numrit të familjeve sipas përdorimit të kredisë është e tillë: 37% e familjeve kanë kredi konsumatore, 25% kanë kredi hipotekare, 21% kanë llogari overdraft-i dhe 17% kanë karta krediti (grafiku 30).



Vlera e portofolit të kredisë përbëhet nga: kredia hipotekare (56%), kredia konsumatore (33%) dhe overdraft-i dhe kartat e kreditit (11%), (grafiku 31).


Grafik 31. Shpërndarja e portofolit të kredisë marrë nga sistemi financiar



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Përsa i përket qëllimit të përdorimit të kredisë hipotekare (grafiku 32), 31% e familjeve e kanë marrë këtë kredi hipotekare për të mobiluar/rinovuar banesën kryesore dhe 21% e tyre për të blerë banesën kryesore të familjes. Gjithashtu, mbi 20% e familjeve e kanë marrë kredinë hipotekare për të financuar një biznes familjar dhe për qëllime edukimi.


Grafik 32. Qëllimi i përdorimit të kredisë hipotekare



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Të dhënat tregojnë se kredia konsumatorë (grafiku 33) është marrë për: mobilimin e shtëpisë dhe blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake (31%), mbulimin e kostove të jetesës (22%), ku kryesisht familjet marrin borxh për shpenzime të mëdha ose të papritura si p.sh. ato shëndetësore, si dhe blerja e një makine (18%).


Grafik 33. Qëllimi i përdorimit të kredisë konsumatore



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Mediana dhe mesatarja e kredisë për familje vlerësohet përkatësisht 0.2 milionë lekë dhe 0.5 milionë lekë.

Grafik 34. Shpërndarja e portofolit të kredisë totale të familjeve sipas statusit të punësimit të personit të referencës




Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Bazuar në statusin e punësimit të personit të referencës dhe nivelin e të ardhurave, të dhënat tregojnë se familjet që e kanë personin e referencës të punësuar dhe të vetëpunësuar zotërojnë 74% të vlerës së portofolit të kredisë, si dhe janë më të ekspozuara kryesisht ndaj kredisë hipotekare (80% zotërohet prej tyre), kartave të kredit (100%) dhe kredisë konsumatore (58%) (grafiku 34).

Bazuar në nivelin e të ardhurave vjetore neto (grafiku 35), vërehet se grupet e familjeve me të ardhura nën nivelin e 60-të të percentiles së të ardhurave, zotërojnë 28% të totalit të kredisë. Ndërsa 72% e kredisë totale zotërohet nga familjet me të ardhura mbi nivelin e 60-të të percentiles së të ardhurave. Familjet me të ardhura nën percentilen e 60-të të të ardhurave janë të ekspozuara kryesisht ndaj overdraft-it dhe kredisë konsumatore, duke zotëruar përkatësisht 55% dhe 31% të tij. Kurse familjet me nivel të ardhurash mbi nivelin e 60-të të percentiles së të ardhurave janë të ekspozuara kryesisht ndaj kredisë hipotekare dhe kartave të kredit, duke zotëruar përkatësisht 79% dhe 72% të tyre (grafiku 35).


Grafik 35. Shpërndarja e portofolit të borxhit formal të familjeve sipas nivelit të të ardhurave të familjeve




Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS)

III.2 Tregues të vulnerabilitetit të kredisë

Për të vlerësuar se sa të ndjeshëm janë familjet ndaj kredisë kemi llogaritur medianën e ngarkesës së kredisë (shuma e detyrimeve mujore të familjeve ndaj totalit të të ardhurave mujore të familjes) për secilin grup të familjeve. Të dhënat e paraqitura në grafikun 36 tregojnë që familjet me personin e referencës të papunë dhe tjetër janë grupet më vulnerabël, pasi kanë një ngarkesë borxhi 55% dhe 62% që është më e lartë se 43% që konsiderohet si niveli tavan përtej të cilit probabiliteti i klasifikimit si kredi e keqe rritet ndjeshëm. Natyrisht, grupi më i ndjeshëm ndaj rreziqeve financiare dhe ekonomike, janë familjet me të ardhura poshtë nivelit të 40-të të percentiles së të ardhurave, ku ngarkesa e borxhit ndaj të ardhurave arrin në nivelin 46 dhe 64% të të ardhurave totale mujore të familjes (grafiku 36). Kështu, një goditje që mund të ndryshojë nivelin e të ardhurave të familjes, ose detyrimet mujore të familjes apo të dyja bashkë, ndikon në ngarkesën e kredisë të familjeve. Vlerësimet tona bazuar në të dhënat e vrojtimit, tregojnë se 15%-18% e familjeve kanë një ngarkesë të kredisë ndaj të ardhurave mujore që është mbi nivelin 43%, që i bën këto familje më të ndjeshme ndaj goditjeve në të ardhura.




Grafik 37. Ngarkesa e kredisë ndaj të ardhurave totale mujore sipas percentileve të të ardhurave të familjeve (në %)



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Gjithashtu, ne kemi parë sa rezistente janë familjet ndaj një goditjeje që mund të pësojnë të ardhurat e tyre. Rezistenca e familjeve përcaktohet si numri i periudhave (muajve) gjatë të cilave një familje mund të mbulojë konsumin jetik dhe ngarkesën e kredisë me aktivet likuide, në rast të humbjes së të ardhurave (ECB, 2016). Konsumi jetik në bazë të përkufizimit të OECD-së përcaktohet sa 50% e medianës së të ardhurave të familjeve. Të dhënat tregojnë se mediana dhe mesatarja e rezistencës për familje në Shqipëri është 4 dhe 7 muaj, që tregon se një familje mund t'i rezistojë një goditjeje në të ardhura nga 4 deri në 7 muaj (grafiku 38). Megjithatë, parë në nivel më të detajuar, të dhënat tregojnë se 47% e familjeve mund të rezistojnë nga 0-3 muaj, ndërsa 13% e familjeve nuk mund të përballojnë asnjë goditje në nivelin e të ardhurave. Vetëm 19% e familjeve kanë një rezistencë më shumë se 1 vit (grafiku 38).

Grafik 38. Rezistenca e familjeve ndaj një goditje në të ardhura



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).


III.3 Kufizimi i kredisë

Familjet gjithashtu pyeten nëse ato kanë aplikuar për një kredi në tre vitet e fundit pranë një institucioni financiar, mbi arsyet për të cilat ato nuk kanë aplikuar, si dhe mbi rezultatin e aplikimit. Këta tregues janë mjaft me vlerë për t'u analizuar në terma të politikëbërjes, për të analizuar dhe kuantifikuar nivelin e përfshirjes financiare të familjeve.

Rezultatet sugjerojnë se një numër i ulët i familjeve ose 4.4% e tyre kanë aplikuar për një kredi pranë një institucioni financiar gjatë tre viteve të fundit (2016-2018) dhe 95.6% e familjeve nuk kanë aplikuar për kredi (grafiku 39). Ndër familjet që nuk kanë aplikuar për një kredi, vetëm 4% shprehen se arsyeja e mos-aplikimit ka qenë se aplikimi për kredi do të refuzohet. Ndërsa 96% shprehen se aplikimi nuk do të refuzohet, por nuk kanë aplikuar pasi mund të mos kenë pasur nevojë ose dëshirë për të marrë një kredi pranë një institucioni financiar.


Familjet të cilat kanë aplikuar për një kredi gjatë tre viteve të fundit janë pyetur dhe për rezultatin e aplikimit. 55% e tyre raportojnë se kredia nuk është refuzuar, ndërsa 45% raportojnë se kredia është refuzuar (grafiku 40). Ndër familjet të cilave u është refuzuar kredia, 79% raportojnë që nuk mund ta përfitonin kredinë më vonë pranë të njëjtit institucion financiar ose pranë një institucioni tjetër financiar, ndërsa vetëm 21% e tyre mund ta përfitonin.

Grafik 39. Aplikime për kredi në tre vitet e fundit



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 40. Kufizime të kredisë



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Të pyetur sipas karakteristikave socio-ekonomike të familjeve, të dhënat tregojnë që refuzimi i kërkesës për kredi është në përpjesëtim të zhdrejtë me nivelin e të ardhurave dhe pasurinë neto të familjeve (tabela 4). Kështu me rritjen e të ardhurave ulet refuzimi nga ana e institucioneve financiare. Familjet që ndodhen në percentilen më të ulët të të ardhurave dhe të pasurisë karakterizohen nga një përqindje më e lartë e refuzimit të kërkesës për kredi.

Dhënia e kredisë është e lidhur njëkohësisht si me statusin e punësimit të personit të referencës, ashtu edhe me të pasurit e një pasurie të patundshme, e cila lihet si garanci për shlyerjen e kredisë. Të dhënat tregojnë se më së shumti kërkesa e kredisë u është refuzuar familjeve ku personi i referencës ka paaftësi të përkohshme apo të përhershme, përkundrejt të tjerëve. Të dytat renditen familjet që e kanë personin e referencës të vetëpunësuar, që mund të lidhen me faktin që burimi i të ardhurave të tyre mund të jetë më i luhatshëm përkundrejt grupeve të tjera. Ndërsa familjet që e kanë personin e referencës të punësuar kanë një normë më të lartë mos-refuzimi. Parë sipas moshës së personit të referencës, duket që refuzimin më të lartë e kanë familjet që e kanë personin e referencës në grup-moshën 45-54 vjeç.

Tabela 4. Kufizimet e kërkesës për kredi sipas karakteristikave socio-ekonomike të familjeve

Karakteristikat e familjeve	Familjet që u është refuzuar kërkesa për kredi	Familjet që nuk u është refuzuar kërkesa për kredi
Totali i familjeve	45%	55%
Madhësia e familjes		
1	37%	63%
2	31%	69%
3	48%	52%
4	66%	34%
5 e më shumë	31%	69%
Statusi i pronësisë		
Pronar i të gjithës	42%	58%
Me qira	78%	22%
Tjetër (Jeton pa pagesë)	61%	39%
Percentilja e të ardhurave		
Poshtë 20	74%	26%
20-39.9	41%	59%
40-59.9	39%	61%
60-79.9	40%	60%
80-100	34%	66%
Percentilja e pasurisë neto		
Poshtë 20	44%	56%
20-39.9	65%	35%
40-59.9	36%	64%
60-79.9	37%	63%
80-100	38%	62%
Mosha e personit të referencës		
16-34	31%	69%
35-44	49%	51%
45-54	63%	37%
55-64	31%	69%
65-74	33%	67%
75+	21%	79%
Statusi i punësimit të personit të referencës		
I punësuar	36%	64%
I vetëpunësuar	56%	44%
Pensionist	38%	62%
Papunë	42%	58%
Tjetër	61%	39%

Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

IV. PASURIA NETO


Kjo pjesë përmbledh informacion mbi pasurinë neto, diferencën mes aktiveve dhe detyrimeve të familjeve. Koncepti i pasurisë neto është një përcaktues i rëndësishëm i sjelljes së konsumatorit dhe mbart informacion relevant në lidhje me nivelin e stabilitetit financiar të një vendi. Pasi sa më i ulët niveli i pasurisë neto, për më tepër sa më negative të jetë ajo, aq më shumë janë të cënueshme familjet në terma financiarë.

Grafiku 41 më poshtë paraqet shpërndarjen e pasurisë neto në rang familjesh sipas percentileve të saj, e cila ashtu siç pritej është e zhvendosur më fort në të djathtë. Të dhënat tregojnë për një vlerë të medianës dhe të mesatares të pasurisë neto përkatësisht në nivelin e 5.2 milion lekë dhe 6.2 milion lekë që tregon për diferenca midis grupeve të ndryshme të familjeve. Për më tepër vërehet se familjet në percentilen e 90-të, zotërojnë një pasuri neto në nivelin e afërsisht 11 milionë lekëve, ndërsa ato në percentilen e 10-të kanë një pasuri neto rreth 4 herë më të ulët. Të dhënat tregojnë që më pak se 0.5% e familjeve kanë një pasuri negative, që dëshmon se për këto familje niveli i detyrimeve tejkalon nivelin e aktiveve totale. Vetëm 0.1% e familjeve kanë një pasuri neto zero, që tregon që niveli i aktiveve të familjeve është i barabartë me nivelin e detyrimeve.

Heterogjeniteti i zotërimit të pasurisë neto konfirmohet si nga paraqitja grafike e kurbës së Lorenzit, ashtu edhe në treguesin e Ginit apo të treguesve të tjerë të paraqitur më poshtë (grafiku 42 dhe tabela 5). Të dhënat tregojnë që 25% e familjeve në Shqipëri, që ndodhen në percentilen e 20-të të pasurisë neto, zotërojnë vetëm 6% të totalit të saj. Ndërsa familjet që ndodhen në percentilen e sipërme të pasurisë neto (percentilja e 90-të) zotërojnë afërsisht 30% të pasurisë neto. Vërehet se diferenca të konsiderueshme të pasurisë neto ka jo vetëm midis dy percentileve të skajshme, por edhe midis medianës dhe percentiles më të ulët. Familjet në percentilet më të larta kanë një pasuri neto mesatarisht 300% deri në 400% më të lartë se familjet në percentilet më të ulta dhe 200% më të lartë me familjet që kanë pasuri neto në vlerat e medianës. Pabarazia e lartë vërehet edhe midis familjeve që zotërojnë një pasuri neto sa mediana dhe familjeve që zotërojnë një pasuri neto në nivelet më


të ulëta. Gjithashtu, për ta bërë më të krahasueshme pasurinë neto midis familjeve të pandikuara nga numri i pjesëtarëve të familjes kemi llogaritur pasurinë neto për frymë. Të dhënat tregojnë për një nivel më të lartë të pabarazisë, që konfirmohet si nga koeficienti Gini (46% përkundëjt 38% për pasurinë neto), ashtu edhe nga tregues të tjerë të pabarazisë, të cilët janë mesatarisht 1.3 herë më të lartë se për treguesin e pasurisë neto.

Grafik 41. Shpërndarja e pasurisë neto sipas percentileve të pasurisë



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 42. Përqindja e pasurisë neto zotëruar nga përqindja e familjeve (Kurba e Lorenzit për pasurinë neto)



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Tabela 5. Tregues të matjes së pabarazisë së pasurisë neto

Tregues	Pasuria neto	Pasuria neto për frymë
Koeficienti Gini*	38%	46%
P90/P10	391%	683%
P80/P20	284%	380%
P90/P50	207%	270%
P50/P10	189%	253%
Përqindja e pasurisë neto të 10% më të pasurve	27.76%	36%
Përqindja e pasurisë neto të 5% më të pasurve	17.42%	22%

Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS), 2019.

* Koeficienti Gini është një nga treguesit që përdoret gjerësisht për të matur pabarazinë, që luhet midis 0 dhe 1, ku vlera 0 tregon për një shpërndarje të barabartë, ndërsa 1 tregon për një pabarazi të plotë të treguesit të pasurisë neto dhe të pasurisë neto për frymë. Në këtë rast, koeficientin Gini e kemi shumëzuar me 100 dhe e kemi shprehur në përqindje.

Ndërsa në tabelën 6 është dhënë shpërndarja e pasurisë neto bazuar në karakteristikat socio-ekonomike të familjeve. Vërehet se pasuria neto rritet proporcionalisht me rritjen e numrit të anëtarëve të familjes, si dhe është e lartë për familjet të cilat janë pronare të banesës së tyre kryesore. Nga ana tjetër, të dhënat tregojnë që pasuria neto rritet me rritjen e edukimit të personit të referencës, si dhe është e lidhur pozitivisht me statusin e punësimit të personit të referencës. Personat e referencës të punësuar dhe të vetëpunësuar regjistrojnë një nivel më të lartë të pasurisë neto përkundrejt të papunëve dhe pensionistëve.

Tabela 6. Pasuria neto sipas karakteristikave socio-ekonomike të familjeve

	Pasuria neto e familjeve Mesatarja (mijë lekë)	Pasuria neto e familjeve Mediana (mijë lekë)
Madhësia familjes sipas numrit të anëtarëve të saj		
1	5,473	4,741
2	5,930	5,027
3	5,897	4,967
4	6,148	5,288
5 e më shumë	6,544	5,516
Statusi i pronësisë të banesës kryesore		
Pronar	6,198	5,310
Me qira	5,268	4,527
Tjetër	4,834	3,973
Niveli i edukimit personit të referencës		
Niveli i parë i edukimit	5,940	5,040
Niveli i dytë i edukimit	6,303	5,477
Niveli i tretë i edukimit	6,330	5,555
Moshë e personit të referencës		

16-34 vjeç	6,180	5,300
35-44 vjeç	6,101	5,037
45-54 vjeç	5,966	5,154
55-64 vjeç	6,255	5,350
65-74 vjeç	6,175	5,365
75+ vjeç	6,013	5,300
Statusi i punësimil të personit të referencës		
I Papunë	6,195	5,700
Tjetër	5,676	4,723
Pensionist	6,189	5,300
I Punësuar	6,008	5,060
I Vetëpunësuar	6,225	5,190

Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS), 2019.

Pavarësisht zhvillimeve dhe ndryshimeve të pasurisë neto midis grupeve të ndryshme të familjeve bazuar në karakteristikat demografike të familjeve, duhet të mbajmë parasysh se të dhënat e raportuara janë vetëvlerësimet e familjeve mbi aktivet dhe detyrimet, si rrjedhojë dhe pasuria neto që llogaritet si diferencë midis tyre është subjekt i këtyre vetëvlerësimeve. Vërehet se më së shumti familjet janë më të sakta në raportimin mbi aktivet reale, që janë kontribuuesit kryesorë të aktiveve totale krahasuar me aktivet financiare, ku kemi edhe një numër më të lartë të pa-përgjigjeve. Nga ana tjetër duhet të mbajmë parasysh se në vrojtim me pasurinë e familjeve shqiptare, i referohemi vetëm pasurisë neto së familjeve, që pa dyshim është një komponent i rëndësishëm, por nuk është një regues gjithëpërfshirës i pasurisë ekonomike të vendit.

V. TË ARDHURAT

Të ardhurat janë një faktor i rëndësishëm që ndikon në shumë aspekte të sjelljes së konsumatorëve. Bazuar në teorinë e ciklit të jetës, shpenzimet e konsumit varen nga shuma e të ardhurave të pritshme. Nga ana tjetër, akumulimi i pasurisë përcaktohet nga sjellja e kursimit të familjes, që ndikohet nga të ardhurat. Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare, merr informacion të detajuar për të gjitha burimet e të ardhurave të familjes dhe të pasurisë së saj, duke e bërë këtë vrojtim unik dhe gjithëpërfshirës. Të dhënat në lidhje me të ardhurat e familjes merren për vitin 2018, që i korrespondon një viti kalendarik para periudhës së bërjes së vroitimit, viti 2019.

V.I Shpërndarja e të dhënave


Një vështrim i përgjithshëm i të ardhurave të familjes jep një informacion të plotë mbi situatën ekonomike-financiare të familjeve shqiptare, si dhe krijimin e pritshmërive për të ardhmen. Të dhënat mbi të ardhurat totale neto vjetore të familjeve në Shqipëri, bazuar në të gjitha burimet e të ardhurave, si të ardhurat nga puna ashtu edhe të ardhurat jo nga puna, tregojnë se mediana¹⁷ e të ardhurave vjetore¹⁸ neto të familjeve është 723,108 lekë (ose 60,259 lekë në muaj), ndërsa mesatarja e të ardhurave vjetore neto e familjeve shqiptare është 961,379 lekë (ose 80,115 lekë në muaj) dhe është 33% më e lartë se vlera e medianës.

Në mënyrë më të detajuar, grafiku 43 paraqet shpërndarjen e plotë të të ardhurave vjetore neto të familjeve, nga niveli më i ulët i të ardhurave (percentilja e 5-të) që është 0.18 milion lekë në vit (ose 15,000 lekë në muaj) në nivelin më të lartë të të ardhurave vjetore neto (percentilja e 95-të) që është 2.4 milion lekë në vit (ose 202,060 në muaj). Bazuar në percentilen e të ardhurave, të dhënat tregojnë që familjet më të pasura (percentilja e 95-të) i kanë të ardhurat 3.4 herë më të larta se familjet me të ardhura mesatare (percentilja e 50-të). Ndërsa familjet me të ardhura mesatare (percentilja e 50-të) i kanë të ardhurat 4 herë më të larta se familjet me të ardhurat më të ulëta (percentilen e 5-të). Vlerësimet e mësipërme tregojnë se niveli i pabarazisë së të ardhurave në rastin e Shqipërisë është i lartë (grafiku) dhe lëvizja e familjeve nga një kategori në tjetrën shoqërohet me efekte të forta financiare në të ardhura.

¹⁷ Mediana është një tregues më i mirë për të treguan situatën në lidhje me të dhënat mbi të ardhurat, pasurinë apo borxhin, pasi duke qenë se tregon vlerën e mesit të secilit treguesi i ndan rezultatet në dy pjesë të barabarta, ku 50% rezultate janë poshtë medianës dhe 50% e rezultateve janë mbi të.


¹⁸ Të ardhurat totale vjetore të familjeve përbëhen nga të ardhurat nga puna (që janë të ardhurat nga punësimi, vetëpunësimi, pensioni, të ardhurat nga papunësia), si dhe të ardhurat jo nga puna (që janë të ardhurat nga emigrantët, ndihma sociale, të ardhurat nga aktivet financiare dhe reale).

Grafik 43. Shpërndarja e të ardhurave totale neto vjetore të familjeve (mijë lekë)



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 44. Përqindja e të ardhurave zotëruar nga përqindja e familjeve (Kurba e Lorenzit)




Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Shënim: Vija e ndërprerë 45° paraqet vijën e barazisë midis përqindjes së të ardhurave dhe përqindjes së zotëruar nga familjet.

Bazuar në statusin e punësimit të secilit individ mbi 16 vjeç, të dhënat tregojnë që 42% e popullsisë janë të punësuar dhe të vetëpunësuar, 23% janë të papunë, 20% janë pensionistë dhe pjesa tjetër (15%) përbëhet nga studentë, si dhe persona me pa aftësi të përhershme në punë (grafiku 45). Kryesisht të punësuarit janë të


punësuar në: industrinë përpunuese, shërbime administrative dhe mbështetëse, ndërtim, arsim, si dhe tregti me shumicë dhe pakicë (grafiku 46). Ndërsa të vetë-punësuarit janë të përqendruar kryesisht në bujqësi, tregti me pakicë dhe shumicë, akomodim dhe shërbim ushqimor dhe industri përpunuese (grafiku 47).

Grafik 45. Statusi i punësimit të popullsisë mbi 16 vjeç (në %)




Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 46. Shpërndarja e të punësuarve sipas sektorëve (në %)



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 47. Shpërndarja e të vetëpunësuarve sipas sektorëve




Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Klasifikimi sipas burimit të të ardhurave (grafiku 48) tregon se të ardhurat nga puna janë burimi kryesor i tyre dhe përbëjnë mesatarisht 49% deri në 64% të totalit të të ardhurave. Burimi i dytë më i rëndësishëm janë të ardhurat nga emigrantët që përbëjnë nga 14-23% të totalit të ardhurave, ndërsa burimi i tretë janë ndihmat sociale¹⁹ që luhaten nga 6% deri në 15% të totalit të të ardhurave. Vërehet se burimet e tjera e të ardhura si të ardhurat nga qiraja apo të ardhurat nga interesat, zënë një përqindje fare të vogël, në totalin e të ardhurave. Këto statistika tregojnë se goditjet negative në të ardhurat nga puna dhe ato nga emigrantët, së bashku, përbëjnë afërsisht 60-80% të totalit të të ardhurave të familjes, dhe kanë një ndikim përcaktues në konsumin-kursimin e familjeve, si dhe në sjelljen financiare të tyre.

¹⁹ Ndhimat (përfitimet) sociale janë pagesa të rregullta publike që individi ose familja merr nga sigurimet shoqërore ose nga agjencitë e tjera qeveritare si për shembull subvencion për sëmundje, pushimin e lejes së lindjes, përfitim për fëmijë, bursë studentore për fëmijët ose çdo mbështetje tjetër financiare për shkollimin e tyre.

Grafik 48. Burimi i të ardhurave si përqindje ndaj totalit të të ardhurave



Në mënyrë më të detajuar për të parë heterogjenitetin që ekziston midis familjeve, tabela 7 paraqet edhe se si karakteristikat e familjeve si: madhësia, moshë e personit të referencës²⁰, edukimi, statusi i punësimit, statusi i pronësisë etj.; ndikojnë në diferencat midis tyre për sa i përket nivelit të të ardhurave.

²⁰ Personi i referencës në familje është ai person i familjes që ka më shumë njohuri mbi financat dhe konsumin e familjes, që mund të jetë edhe kryefamiljari i familjes ose personi më i moshuar i saj.

Tabela 7. Të ardhurat totale neto të familjes sipas karakteristikave të saj (në mijë lekë)


Karakteristikat e familjeve	Mediana (mijë lekë)	Mesatarja (mijë lekë)	Përqindja e të ardhurave sipas karakteristikës së familjes ndaj të ardhurave totale (%)	Përqindja e familjeve sipas karakteristikës së saj ndaj totalit të familjeve (%)
Totali i familjeve	723.1	961.4	100.0	100.0
Numri i anëtarëve të familjes				
1	504.0	724.9	5.9	7.8
2	716.0	993.4	22.4	21.7
3	700.0	906.4	16.1	17.1
4	768.0	968.1	24.5	24.4
5 e më shumë	780.0	1028.2	30.9	29.0
Statusi i pronësisë				
Pronar i të gjithës	732.0	966.9	93.11	92.69
Me qira	720.0	1022.0	5.19	4.92
Tjetër (leton pa pagesë)	542.4	625.3	1.56	2.40
Percentilja e të ardhurave				
Poshtë 20	256.6	235.8	4.9	20.0
20-39.9	480.0	475.9	9.3	18.9
40-59.9	720.0	724.5	15.6	20.9
60-79.9	1,054.8	1,072.9	22.4	20.1
80-89.9	1,506.2	1,519.9	16.0	10.1
90-100	2,424.2	3,019.0	31.6	10.1
Percentilja e pasurisë neto				
Poshtë 20	594.2	766.3	11.62	14.6
20-39.9	785.8	1055.2	27.80	25.3
40-59.9	660.0	875.1	18.25	20.0
60-79.9	732.0	964.5	20.12	20.1
80-100	837.6	1068.1	22.22	20.0
Moshë e personit të referencës				
16-34	720.0	910.8	7.9	8.3
35-44	672.0	833.7	12.2	14.1
45-54	732.0	1023.2	23.3	21.9
55-64	724.6	950.1	25.6	25.9
65-74	794.8	1059.2	18.8	17.1
75+	707.2	920.0	12.1	12.6
Statusi i punësimit të personit të referencës				
I punësuar	960.0	1147.0	30.8	25.9
I vetëpunësuar	670.0	953.5	20.7	20.9
Pensionist	723.0	963.9	32.1	32.1
Papunë	540.0	696.5	10.8	15.0
Tjetër	552.0	819.5	5.2	6.1
Edukimi i personit të referencës				
Niveli i parë	600.0	1007.0	12.7	13.0
Niveli i dytë	564.0	980.1	73.2	75.5
Niveli i tretë	683.6	1143.4	14.1	11.5

Shënim: Dy kolonat e para të tabelës paraqesin të dhënat për medianën dhe mesataren e të ardhurave totale neto vjetore të familjeve shqiptare. Ndërsa kolona e tretë dhe e katërt paraqesin përkatësisht përqindjen e të ardhurave të familjeve sipas karakteristikave të tyre ndaj të ardhurave totale dhe përqindja e familjeve ndaj totalit të familjeve. Të ardhurat janë llogaritur vetëm për familjet që kanë dhënë vlera për të ardhurat, si dhe janë paraqitur për grupe të ndryshme të familjeve, duke përdorur këto kritere: (1) për totalin e familjeve, (2) numrin e anëtarëve të familjes, (3) moshën e personit të referencës, (4) nivelin e edukimit të personit të referencës, (5) statusin e pronësisë të shtëpisë, (6) statusin e punësimit të personit të referencës, (7) percentilet e të ardhurave totale të familjeve, (8) percentilet e pasurisë neto të familjeve.

VI. SHPENZIMET E FAMILJEVE DHE KURSIMI


Pavarësisht se fokusi kryesor i Vrojimit të Pasurisë së Familjeve Shqiptare (AHWS) është struktura e bilancit të familjeve shqiptare, në sajë të tij merret informacion edhe mbi konsumin dhe kursimin e familjeve, të cilët janë të rëndësishëm për të kuptuar sjelljen e tyre. Këto tregues shikohen gjithashtu në raport edhe me të ardhurat dhe me pasurinë e familjeve. Në mënyrë të detajuar merret informacion për shpenzimet e familjeve për ushqime dhe pije joalkoolike (brenda dhe jashtë shtëpisë), si dhe për komponentë të tjerë të shpenzimeve të tyre si shpenzimet për energji elektrike dhe ato për shërbime të tjera.

Të dhënat tregojnë se në rang vendi, shpenzimet mesatare mujore të familjeve për ushqime dhe shërbime janë 35,388 lekë, ndërsa mediana është 30,200 lekë (grafiku 49). Shpenzimet mesatare mujore të familjeve për ushqime janë 28,293 lekë, ndërsa mediana e tyre është 24,900 lekë. Pjesa tjetër e shpenzimeve ka të bëjë me shpenzimet për energji elektrike, ujë, gaz, telefon e internet. Mesatarisht, shpenzimet mujore të familjeve për këtë kategori janë 7,391 lekë, ndërsa mediana është 6,000 lekë. Shpenzimet për ushqime brenda shtëpisë dhe shpenzimet për energji elektrike përbëjnë përkatësisht 69% dhe 11% të totalit të shpenzimeve.



Në grafikun më poshtë është dhënë shpërndarja e shpenzimeve për ushqim dhe shpenzimeve totale të familjes bazuar në

percentilet e tyre. Vërehet se të dy këta tregues kanë pothuaj të njëjtën shpërndarje, ku familjet në percentilet më të larta kanë edhe shpenzimet më të larta. Vërehet se shpërndarja e treguesit shpenzime për ushqime është më i zhvendosur fort në të djathtë që tregon për një nivel më të lartë të pabarazisë përkundrejt shpenzimeve totale, konfirmuar edhe nga koeficienti Gini.



Në tabelën 8 janë paraqitur të dhënat e konsumit për ushqim brenda dhe jashtë shtëpisë sipas karakteristikave të ndryshme të familjeve. Të dhënat tregojnë që shpenzimet rriten me rritjen e numrit të anëtarëve të familjeve. Kështu, mediana e shpenzimeve mujore për ushqim luhetet nga 11 mijë lekë për familjet me një person, në 28 mijë lekë për familjet me katër persona. Nga ana tjetër, të dhënat tregojnë që shpenzimet totale për ushqim janë të lidhura pozitivisht me të ardhurat dhe pasurinë neto të familjeve. Kështu, familjet me nivel më të lartë të të ardhurave (ndodhur në percentilen e 90-të) shpenzojnë pothuajse dy herë më shumë se familjet më të ardhura më të ulëta. Nga ana tjetër, të dhënat kanë treguar që pasuria dhe të ardhurat janë të lidhura pozitivisht me edukimin (prezantuar në modulet më sipër).

Në lidhje me moshën e personit të referencës, të dhënat tregojnë që konsumi ka formën e gungës, që rritet me rritjen e moshës së personit të referencës dhe arrin maksimumin për grup-moshën 35-44 vjeç dhe më pas bie, duke reflektuar edhe strukturën e ndryshme të konsumit midis grup-moshave të ndryshme.

Të dhënat e prezantuara në tabelën 8 tregojnë që tek familjet ku personi i referencës ka një diplomë të shkollës së lartë apo më lart, shpenzimet janë pothuajse dy herë më të larta se tek familjet ku personi i referencës ka një nivel të ulët edukimi. Gjithashtu, statusi i punësimit të personit të referencës ndikon në konsumin e familjeve, ku familjet që e kanë personin e referencës së punësuar apo të vetëpunësuar kanë një medianë shpenzimesh më të lartë se familjet ku personi i referencës është pensionist apo i papunë.

Tabela 8. Shpenzimet për ushqim (brenda dhe jashtë shtëpisë) bazuar në karakteristikat e familjeve


Karakteristikat e familjeve	Mediana (lekë)	Mesatarja (lekë)	Përqindja e shpenzimeve totale për ushqim sipas karakteristikës së familjes ndaj totalit të shpenzimeve për ushqim të popullsisë (%)	Përqindja e familjeve sipas karakteristikës së saj ndaj totalit të familjeve (%)
Totali i familjeve	24,900	28,293	100	100
Madhësia e familjes				
1	11,000	13,865	7.8	3.8
2	20,000	21,455	21.7	16.5
3	25,000	28,958	17.1	17.5
4	28,000	32,720	24.4	28.2
5 e më shumë	30,000	33,198	29.0	34.0
Percentilja e të ardhurave totale të familjes				
Poshtë 20	15,000	16,390	20.0	11.6
20-39.9	21,000	22,455	18.9	15.0
40-59.9	28,000	30,788	20.9	22.8
60-79.9	31,000	33,420	20.1	23.7
80-100	35,000	37,842	20.2	27.0
Percentilja e pasurisë neto				
Poshtë 20	20,000	24,514	14.6	12.6
20-39.9	25,000	29,213	25.3	26.1
40-59.9	23,000	26,072	20.0	18.5
60-79.9	25,000	28,261	20.1	20.0
80-100	27,000	32,137	20.0	22.7
Mosha e personit të referencës				
16-34	28,000	31,450	8.3	9.3
35-44	26,000	31,487	14.1	15.7
45-54	27,000	30,359	21.9	23.5
55-64	25,000	28,526	25.9	26.1
65-74	21,000	25,723	17.1	15.6
75+	20,000	22,056	12.6	9.8
Statusi i punësimit të personit të referencës				
I punësuar	35,000	37,129	25.9	34.0
I vetëpunësuar	22,000	27,815	20.9	20.6
Pensionist	20,000	23,763	32.1	27.0
Papunë	22,000	24,862	15.0	13.2
Tjetër	22,000	24,718	6.1	5.3
Edukimi i personit të referencës				
Niveli i parë	20,000	23,630	51.5	43.0
Niveli i dytë	26,500	30,598	35.9	38.9
Niveli i tretë	40,000	40,852	12.5	18.1

Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Prirja mesatare për konsum, përcaktuar si shpenzimet për të mira ndaj të ardhurave, është një parametër i rëndësishëm sa i përket teorisë mikroekonomike mbi konsumin e familjeve. Të dhënat tregojnë se mesatarja e këtij treguesi është 67%, ndërsa mediana është 56%. Parë sipas nivelit të ndryshëm të kuantileve të të ardhurave, të dhënat tregojnë një sjellje monotonike rënëse të tij (grafiku 51). Kështu, vlerën më të lartë (94%) ky tregues e merr për nivelin më të ulët të kuantiles (e para), ndërsa nivelin më të ulët (26%) e merr për nivelin më të lartë të kuantilieve (kuantilja e 5). Ky fakt është në linjë me hipotezën që norma e kursimit rritet me rritjen e të ardhurave të familjes dhe se për familjet me më pak të ardhura, konsumi zë një pjesë të konsiderueshme të tyre.


Ndërsa shpërndarja e shpenzimeve ndaj të ardhurave sipas percentiles së pasurisë neto duket pak më uniforme; ajo luhet ndërmjet niveleve 42% deri në 44%. Vërehet se ky raport rritet me rritjen e pasurisë, si dhe vjen duke u ulur pak për nivelin më të lartë të pasurisë neto (grafiku 50). Parë në rang nivel, të dhënat tregojnë që me rritjen e pasurisë, të ardhurat totale (vjetore) të familjes rriten më shumë se sa rritet konsumi (shpenzimet) vjetor i familjes, duke bërë që ky raport të jetë më i ulët për kuantilen e pestë të pasurisë neto (grafiku 52).

Grafik 51. Mediana e raportit të shpenzimeve ndaj të ardhurave sipas percentiles së të ardhurave (në përqindje)




Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 52. Mediana e raportit të shpenzimeve ndaj të ardhurave (në përqindje) sipas percentiles së pasurisë neto



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 53. Mediana e shpenzimeve dhe të ardhurave totale (në të majtë) dhe pasuria totale (në të djathtë) në mijë lekë



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Në vërtetë, familjet pyeten nëse kanë kursyer apo jo. Të dhënat tregojnë që 62% e familjeve në Shqipëri nuk kursejnë dhe 38% e tyre kursejnë (grafiku 54). Ndërsa në tabelën 8 janë paraqitur të dhënat mbi kursimin ose jo, bazuar në karakteristikat e familjes. Parë sipas madhësisë, vërejmë se familjet me 3 anëtarë kursejnë më shumë se familjet e tjera, ku më pak kursejnë familjet me 1 anëtar. Vërejmë gjithashtu se më shumë kursejnë familjet në kuartilet

më të larta të të ardhurave (57% e tyre), përkundrajt familjeve me të ardhura më të ulëta (vetëm 17% e tyre). Ndërsa parë sipas shpërndarjes së kuartileve të pasurisë neto, vërehet më shumë një sjellje më homogjene e familjeve që kursejnë, përkundrajt atyre që nuk kursejnë.

43% e familjeve që e kanë personin e referencës në grup moshën 16-34% kursejnë dhe 57% e tyre nuk kursejnë, përkundrajt grup-moshave të tjera (tabela 9). Vërehet se më pak kursejnë familjet që e kanë personin e referencës në moshën mbi 75 vjeç, vetëm 35% e tyre kursejnë, përkundrajt 65% që nuk kursejnë.

Parë sipas statusit të punësimit të personit të referencës, afërsisht gjysma e familjeve që e kanë personin e referencës të punësuar kursejnë, ndërsa gjysma tjetër jo. Të dytët që kursejnë më shumë, janë familjet që e kanë personin e referencës të vetëpunësuar, ku 42% e tyre kursejnë. Më pak kursejnë familjet që e kanë personin e referencës të papunë, nga të cilat më pak se çereku kursejnë. Ashtu siç edhe pritej, familjet që e kanë personin e referencës me nivel më të lartë edukimi, sigurojnë më shumë të ardhura, si rrjedhojë ka një përqindje më të lartë të tyre që kursejnë (59% e familjeve), përkundrajt familjeve ku personi i referencës ka një nivel më të ulët edukimi (30% e tyre).

Familjet pyeten gjithashtu edhe për arsyet kryesore të kursimit, duke renditur nga qëllimi më i rëndësishëm tek ai më pak i rëndësishëm e që kanë të bëjnë me: blerjen e një shtëpie, makine, ngritjen e një biznesi, investimin në pasuri financiare, shlyerjen e borxheve, kursime pleqërie, udhëtime, edukimin e fëmijëve, përkujdesje ndaj prindërve të moshuar, për dhurata etj. Nga të dhënat rezulton që arsyet kryesore që familjet kursejnë lidhen kryesisht me edukimin e fëmijëve dhe për kursime pleqërie, pohuar nga 52% e familjeve që kursejnë. Ndjekur nga kursimet për pushime apo udhëtime, pohuar nga 30% e familjeve që kursejnë, si dhe përkujdesje ndaj prindërve dhe detyrime të tjera, pohuar nga 21% e familjeve (grafiku 55).





Tabela 9. Përqindja e familjeve që kursejnë dhe atyre që nuk kursejnë si përqindje nga totalit të familjeve

Karakteristikat e familjeve	Familjet që kursejnë	Familjet që nuk kursejnë	Totali i familjeve
Totali i familjeve	38%	62%	100%
Madhësia e familjes			
1	25%	75%	100%
2	40%	60%	100%
3	42%	58%	100%
4	41%	59%	100%
5 e më shumë	34%	66%	100%
Percentilja e të ardhurave			
Poshtë 20	17%	83%	100%
20-39.9	30%	70%	100%
40-59.9	34%	66%	100%
60-79.9	50%	50%	100%
80-100	57%	43%	100%
Percentilja e pasurisë neto			
Poshtë 20	35%	65%	100%
20-39.9	47%	53%	100%
40-59.9	34%	66%	100%
60-79.9	34%	66%	100%
80-100	36%	64%	100%
Mosha e personit të referencës			
16-34	43%	57%	100%
35-44	36%	64%	100%
45-54	39%	61%	100%
55-64	38%	62%	100%
65-74	37%	63%	100%
75+	35%	65%	100%
Statusi i punësimit të personit të referencës			
I punësuar	49%	51%	100%
I vetëpunësuar	42%	58%	100%
Pensionist	33%	67%	100%
Papunë	24%	76%	100%
Tjetër	31%	69%	100%
Edukimi i personit të referencës			
Niveli i parë	30%	70%	100%
Niveli i dytë	41%	59%	100%
Niveli i tretë	59%	41%	100%

Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

Grafik 55. Arsyt kryesore të kursimit



Burimi: Vrojtimi mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare (AHWS).

SHTOJCA 1.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

FAMILJA

Familja përbëhet nga anëtarët që jetojnë së bashku, të rritur dhe fëmijë, që ndajnë së bashku shpenzimet, duke përfshirë edhe personat që zakonisht nuk jetojnë në këtë adresë, por që janë plotësisht ose pjesërisht financiarisht të varur nga familja.

Njerëzit që jetojnë këtu, por që: (1) punojnë për një familje që banon diku tjetër ose (2) jetojnë në një shtëpi, por që nuk ndajnë financat e tyre, (3) apo kanë lidhje gjaku me familjen aktuale, por që jetojnë më vete dhe janë të pavarur financiarisht/ janë të lidhur financiarisht me një familje tjetër; nuk duhet të konsiderohen si pjesë të familjes, por duhet të trajtohen si familje të ndara.

PERSONI REFERENCË I FAMILJES

Personi i referencë i familjes është ai person në familje që ka më shumë njohuri në lidhje me financat dhe konsumin e familjes që përcaktohet si një person unik i familjes

PASURIA NETO

Pasuria neto përcaktohet si diferencë midis aktiveve totale dhe detyrimeve totale

Aktivitetet totale përbëhet nga aktivitetet reale dhe aktivitetet financiare

Aktivitetet reale përfshijnë:

- Vlerën e banesës kryesore (për pronarët)
- Vlerën e pasurive të tjera të patundshme
- Vlerën e automjeteve dhe mjete të tjera (makinat dhe automjete të tjera, si motoçikleta, kamion, varka etj.)
- Vlera e sendeve me vlerë
- Vlera e biznesit privat për të vetëpunësuarit

Aktivitetet financiare përfshijnë:

- Depozitat (llogaritë rrjedhëse, depozitat me afat)
- Fondet investimi, përbashkëta
- Obligacione, bono thesari
- Para borxh për t'u marrë nga të tjerët
- Skema pensioni vullnetare
- Aktive të tjera financiare
- Vlera e fondeve publike të pensionit nuk është e përfshirë.

Detyrimet (borxh) totale përbëhen nga:

- Shuma e mbetur e kredive hipotekare për blerjen e banesës kryesore dhe kredive të tjera hipotekare për blerjen e pasurive të tjera të patundshme
- Shuma e papaguar e vlerës në kartat e kreditit dhe të overdraft-it
- Shuma e papaguar e huave të tjerë të pakolateralizuara (kreditë konsumatore) dhe borxheve ndaj të tretëve

TË ARDHURAT TOTALE TË FAMILJES

Të ardhurat totale të familjes përfshijnë të ardhurat nga puna dhe ato jo nga puna. Të ardhurat nga puna mblidhen për të gjithë anëtarët e familjes nga mosha 16 vjeç e lart. Ndërsa burimet e tjera të të ardhurave mblidhen në nivel familjeje. Në vërtetë është mblodhur informacion mbi të ardhurat neto, që janë të ardhurat totale mbasi hiqen ndalesat që kanë të bëjnë me tatimin dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësor. Të ardhurat totale të familjes përfshijnë: të ardhurat nga punësimi, të ardhurat nga vetëpunësimi, të ardhurat nga pensionet, transferimet e rregullta sociale, transferimet e rregullta private, të ardhurat nga pasuria e paluajtshme (të ardhurat e marra nga marrja me qira e një prone ose toka pas zbrithjes së kostove të tilla si ripagime të interesit të hipotekës, riparime të vogla, mirëmbajtje, sigurime dhe tarifa të tjera), të ardhura nga investimet financiare (interesi dhe dividendët marrë nga ndërmarrje të tregtuara publikisht dhe shuma e interesit nga aktivitetet siç janë llogaritë bankare, certifikatat e depozitimit, obligacionet, aksionet e tregtuara në publik, etj. të marra gjatë periudhës së referencës së të ardhurave, shpenzimet më të bëra), të ardhurat nga biznesi privat dhe partneritetet dhe burimet e tjera të të ardhurave.

PYETJET E PËRFSHIRA NË PYETËSOR

MODULI 1: DEMOGRAFIA

P01. Duke përfshirë dhe veten tuaj sa është numri i personave që jetojnë në këtë familje?

Periudha e referencës: Aktuale

Familja përbëhet nga anëtarët që jetojnë së bashku, të rritur dhe fëmijë, që ndajnë së bashku shpenzimet, duke përfshirë edhe personat që zakonisht nuk jetojnë në këtë adresë, por që janë plotësisht ose pjesërisht financiarisht të varur nga familja.

Njerëzit që jetojnë këtu, por që (1) punojnë për një familje që banon diku tjetër ose (2) jetojnë në një shtëpi, por që nuk ndajnë financat e tyre (3) kanë lidhje gjaku me familjen aktuale, por që jetojnë më vete dhe janë të pavarur financiarisht/ janë të lidhur financiarisht me një familje tjetër; nuk duhet të konsiderohen si pjesë të familjes, por duhet të trajtohen si familje të ndara.

P02. Emrat e anëtarëve të familjes?

Ju lutem, duke marrë në konsideratë se çfarë quhet familje, listoni në mënyrë të plotë të gjithë emrat e anëtarëve të familjes. Lexoni edhe njëherë emrat për të qenë të sigurt para se të filloni me pyetjet e tjera.

P03. Cila është gjinia e anëtarëve të familjes?

Për secilin anëtar të familjes, përkrah emrit të tij vendosni gjininë përkatëse, Mashkull apo Femër.

P04. Cila është dita e lindjes së secilit anëtar të familjes?

Për secilin anëtar të familjes, të lutem përcakto vendin e lindjes së tij. Vendi i lindjes korrespondon me vendin ku ka ndodhur lindja e personit.

P05. Cili është personi i referencës së familjes? Lidhja e gjakut e secilit anëtar të familjes me personin e referencës (RP)?

Personi i Referencës (RP) është një anëtar i familjes (ose jo), i cili ka më shumë njohuri mbi nivelin e të ardhurave të familjes, të depozitave, kredisë bankare, banesës kryesore, pronave dhe shpenzimet që bën familja.

Lidhja e gjakut (ose jo) e secilit anëtar të familjes me personin e referencës (RP)

Bashkëshorti i RP (personit të referencës), i referohet një personi që është i lidhur në martesë (ligjore) me këtë person.

Partner i RP (personit të referencës) është një person, jo bashkëshorti, që jeton së bashku me personin e RP, pa qenë i martuar ose pa pasur një marrëdhënie ligjore midis tyre.

Anëtarë të tjerë me lidhje gjaku përfshihen personat që nuk janë të përfshira në kategoritë e mësipërme, i cili lidhet me personin e referencës RP, nga rrethanat e lidhjes ose marrëdhëniet familjare, si për shembull hallat, xhaxhallarët, tezet, kushërinjtë, kunata etj.

Personat e tjerë pa lidhje gjaku, janë ato persona që nuk kanë një marrëdhënie familjare me personin e referencës (RP).

P06. Në cilin rreth, shtet, keni lindur ju (RP) dhe secili anëtar i familjes?

Në këtë pyetje synohet të merret informacion mbi vendlindjen e secilit anëtar të familjes, për rrethin, në rast se kanë lindur në Shqipëri. Për personat që kanë lindur jashtë Shqipërisë, përgjigja do të merret vetëm për shtetin e lindjes së tyre.

Vendi i lindjes është vendi ku ka lindur një person, i përcaktuar si vendi i vendbanimit të zakonshëm të nënës në kohën e lindjes, ose, në mungesë, vendi në të cilin ndodhi lindja. Informacioni mbi vendin e lindjes duhet të merret në përputhje me kufijtë kombëtarë që ekzistojnë në kohën e mbledhjes së të dhënave.

Vendi i lindjes së një personi që ka lindur gjatë vizitës afatshkurtër të nënës në një vend tjetër nga vendi i zakonshëm i banimit, duhet të jetë vendi ku nëna kishte vendbanimin e saj të zakonshëm.

P07. Sa vite keni ju dhe secili anëtar i familjes [EMRI] që jeton në këtë rreth/shtet?

Nëse personi jeton në këtë vend më pak se gjysmën e vitit, atëherë numri i viteve që ky person ka jetuar në këtë vend është 0.

Nëse personi ka ikur dhe ka ardhur, pra kemi qëndrime të përsëritura në vendin e intervistës, përgjigja duhet të reflektojë numrin e të gjitha qëndrimeve më të gjata se 6 muaj.

P08. Cili është statusi civil aktual i secilit anëtar të familjes [EMRI] (mbi 16 vjeç)? Periudha e referencës: Aktuale

Statusi aktual civil i secilit anëtar të familjes zakonisht kuptohet si statusi ligjor martesor, i cili përkufizohet si statusi (ligjor) bashkëshortor i çdo individi në lidhje me ligjet e një vendi. Katër statutet kryesore ligjore janë: beqar (i pamartuar), i martuar, i ve dhe i divorcuar/ligjërish i ndarë. Bashkëjetesa është të qëndruarit bashkë të një personi me një tjetër, ku secili individ merr përsipër angazhimet aktuale të jetesës brenda familjes, por që nuk janë të lidhur bashkë mbi bazë ligjore.

Tipat kryesorë të familjes që merren në konsideratë janë:

1. Familje me një person
2. Familje me shumë persona
 - 2.1. Prind i vetëm me fëmijë
 - 2.2. Çift pa fëmijë
 - 2.3. Çift me fëmijë
 - 2.4. Çift ose prind i vetëm me fëmijë dhe me persona të tjerë që jetojnë në shtëpi. Këtu si persona të tjerë përfshihen të gjithë ata që nuk janë fëmijë të çiftit ose të prindit të vetëm ose të partnerit të atij çifti.
 - 2.5. Familje të tjera, përfshin ato familje që nuk kanë marrëdhënie prind-fëmijë.

P09. Cila është diploma më e lartë e arsimit që zotëron secili anëtar i familjes me moshë 16 (vjeç +)? Periudha e referencës: Aktuale

Niveli më i lartë i arsimimit të një personi përcaktohet si arritja më e lartë e një programi arsimor që personi ka përfunduar me sukses. Përfundimi me sukses ka të bëjë me marrjen e një certificate ose diplomë, kur ka një të tillë. Në rastet kur mbarimi i një programi mësimor nuk shoqërohet me një certifikatë vlerësimi, atëherë përfundimi me sukses i saj ka të bëjë me ndjekjen e plotë të këtij programi mësimor.

P10. Sa është madhësia në metra katrorë e banesës suaj kryesore (vendi ku ju apo familja juaj jeton në pjesën më të madhe të vitit)? Periudha e referencës: Aktuale

Banesa kryesore e shtëpisë përcaktohet si vendbanimi ku zakonisht jetojnë pjesëtarët e familjes, që mund të jetë një shtëpi ose apartament. Një familje mund të ketë vetëm një vendbanim kryesor në çdo kohë të caktuar, edhe pse ata mund të ndajnë banesën me njerëz që nuk i përkasin familjes.

Ndërsa vendbanimi kryesor i shumicës së familjeve është i qartë, më e paqartë situata është për shembull për udhëtarët e shpeshtë ose njerëzit që jetojnë në shtëpi të shumëfishta. Në këto raste, vendbanimi kryesor duhet të përcaktohet rast pas rasti, sipas faktorëve të mundshëm që ndikojnë, si për shembull: koha e kaluar në vendbanim gjatë një viti, adresa postare, vendi ku paguhen taksat, vendi i kryerjes së votimit, si dhe vendndodhja në policat e sigurimit të objekteve.

P11. Sa vite (kohë) keni ju ose familja juaj që banoni në këtë shtëpi? Periudha e referencës: Aktuale

Këtu pyetjet për numrin e viteve që ju dhe familja juaj keni që jetoni në këtë shtëpi. Nëse është 6 muaj e më shumë llogaritet 1 vit, nëse është më pak se gjashtë muaj llogaritet 0 vite.

P12. A jeni ju (ose ndonjë anëtar tjetër i familjes) pronar i banesës ose pronar i një pjesë të saj, e keni marrë me qira, apo jetoni pa pagesë? Periudha e referencës: Aktuale

Këtu pyetet në lidhje me pronësinë e shtëpisë, banesës kryesore ku ju jetoni. Pra nëse jeni pronar i plotë/i pjesëshëm, a jetoni me qira apo jetoni pa pagesë. Të jetuarit pa pagesë do të thotë që nuk i paguani askujt asnjë detyrim për qëndrimin në atë shtëpi.

Pronar i plotë do të thotë që zotëroni plotësisht 100% të gjithë banesën/shtëpinë tuaj kryesore. Pronar i pjesëshëm është ai që zotëroni vetëm një pjesë të caktuar të saj.

P13. A paguani ju/familja juaj qira për pjesën e banesës që ju/familja juaj nuk jeni pronar? Periudha e referencës: Aktuale

Për personat që nuk e zotërojnë plotësisht, por që zotërojnë vetëm një pjesë së saj, pyetet nëse paguhet qira për pjesën e banesës që familja nuk është pronar.

P14. Sa është vlera mujore e qerasë që paguani (pa përfshirë shpenzimet për energji, ujë, ngrohje etj., nëse ato paguhen më vete)? Periudha e referencës: Aktuale

INTERVISTUES: NËSE PAGESA E QERASË BËHEN ME FREKUENCË NJËVJEÇARE, GJASHTËMUJORE OSE TREMUJORE, JU LUTEM KONVERTOJE NË SHPENZIME MUJORE, DUKE E PJESTUAR ME 12, 6 OSE 3 PËR TË MARRË VLERËN MUJORE TË QIRASË.

Këtu pyetet në lidhje me vlerën mujore të qirasë që paguani, por pa përfshirë në të shpenzimet që bën familja për energji, ujë dhe ngrohje.

P15. Çfarë përqindjeje (%) të pjesës së banesës zotëroni ju/familja juaj? Periudha e referencës: Aktuale

Këtu merret informacion mbi përqindjen e pjesës së banesës kryesore që ju apo familja juaj zotëroni, që mund të jetë 75% (treçtereku i banesës kryesore); 50% (gjysma e banesës kryesore), 25% (çereku i banesës kryesore) etj., sipas rastiit.

Shembull: Nëse i intervistuari pohon që familja zotëron për shembull 1/3 e shtëpisë, për ta kthyer në përqindje mjafton që 1 ta pjesëtoni me 3 dhe ta shumëzoni me 100 dhe do të merrni vlerën që zotëron familja juaj, pra 33%. Përqindja e banesës që një individ zotëron është nga 1% deri në 100% (kufijtë që një person mund të zotërojë në banesë).

P16. Si e përftuat ju/familja juaj banesën/pjesën e banesës që keni në pronësi? Periudha e referencës: Aktuale

Këtu pyetet mbi mënyrën e përftimit të banesës kryesore, që mund të jetë: e blerë, e ndërtuar vetë, e trashëguar apo e marrë në formën e dhuratës. Nëse është një mënyrë tjetër e papërmendur më lart të lutem specifikojë, si për shembull kur gjysma është marrë dhuratë (ose trashëguar) dhe gjysma tjetër mund të jetë blerë.

P17. Në cilin vit ju/familja juaj e keni blerë/ndërtuar/trashëguar/marrë dhuratë banesën tuaj kryesore? Periudha e referencës: Aktuale

Nëse banesa kryesore e familjes është blerë ose ndërtuar në disa vite, viti i blerjes/ ndërtimit/ trashëgimit/ marrjes dhuratë është viti i parë kur pronësia e një pjese të banesës kryesore të familjes është përfituar nga një ose disa anëtarë aktualë të familjes. Nëse toka për ndërtimin e banesës kryesore është blerë para ndërtimit të banesës, viti i blerjes së tokës duhet të jetë i koduar si viti i parë i blerjes së një pjese të pronës aktuale të banesës kryesore.

P18. Sa ka qenë vlera e banesës kur ju/familja juaj e keni përfituar/ndërtuar plotësisht? Nëse jeni pronar i një pjesë, ju lutem konsideroni vlerën e gjithë shtëpisë, jo vetëm të pjesës tuaj. Periudha e referencës: Aktuale

Përgjigja e kërkuar është vlera e pronës në kohën e blerjes së saj. Edhe nëse prona është përftuar si dhuratë/trashëgimi ose pjesërisht, duhet që i intervistuari të shprehet për vlerën e tregut të banesës kryesore në kohën kur e ka përfituar atë. Në parim, vlera "zero" nuk duhet të raportohet (nëse nuk është i mundur të bëhet vlerësimi), "Nuk e di" mund të jetë përgjigja më e përshtatshme, jo "zero".

P19. Sa mendoni se është vlera e banesës kryesore nëse do e shisnit sot? Nëse banesa kryesore është një fermë sa është vlera e tokës së fermës dhe ndërtesës? Mos përfshi vlerën e mjeteve bujqësore, bimëve ose bagëtisë. Nëse [pyetja (11)=2] [zotërim të vetëm të një pjesë të shtëpisë] ju lutem konsideroni vlerën totale të banesës, jo vetëm të pjesës që ju zotëroni. Periudha e referencës: Aktuale

Përgjigja e kërkuar ka të bëjë me vlerën aktuale të banesës kryesore, që është vlera në lekë apo në euro që do të merrni nëse do vendosnit ta shisnit atë sot apo në këtë moment banesën.

P20. A zotëroni ju/një anëtar tjetër i familjes pronësi ligjore (hipotekë) të banesës suaj? Periudha e referencës: Aktuale

Duke qenë se pronësia e banesës kryesore ka qenë një problem në rastin e Shqipërisë, pjesa më e madhe e familjeve e konsiderojnë veten pronar pa pasur një dokument ligjor mbi të. Prandaj këtu pyetet nëse familja ka pronësi ligjore, pra nëse ka hipotekë mbi banesën kryesore që zotëron.

P21. A prisni të bëheni pronarë ligjorë të banesës tuaj kryesore në 2019? Zgjidh vetëm 1 alternativë. Periudha e referencës: Aktuale

Në rast se familja nuk ka hipotekë, pyetet nëse ajo pret të bëhet pronare ligjore e banesës, për shembull kur mund të jeni në një proces legalizim ose proces gjyqësor.

P22. A keni ndonjë kredi hipotekare ose kredi tjetër ku keni vendosur banesën tuaj (kryesore) si kolateral (garanci)? Periudha e referencës: Aktuale

“Huadhënës”- janë bankat, degët e bankave të huaja dhe institucionet financiare jo-banka të licencuara nga BSH-ja.

“Huamarrës (ose bashkë-huamarrës)” - është individ që ka marrë një kredi nga një bankë ose nga një institucion financiar për qëllime personale, si për shembull blerje ose rindërtim shtëpie, për makinë

apo edhe për qëllime të tjera personale.

“Kreditë hipotekare” - janë një lloj shumë i zakonshëm i instrumentit të borxhit të përdorur nga shumë individë për të marrë hua për të blerë një pronë, nga një institucion financiar. Ky institucion financiar mban një pasuri të patundshme (banesë etj.) si garanci derisa kredia e marrë të paguhet plotësisht. Huadhënësi ka mundësi që ta shesë, ta konfiskojë, ta rimarrë pasurinë (ose banesën) e lënë peng, në rastet kur nuk zbatohen kushtet me të cilat është dhënë kjo kredi.

“Kontratë e kredisë hipotekare” - është kontrata e kredisë sipas së cilës një bankë i jep konsumatorit një kredi, e cila ka si objekt blerjen, ndërtimin ose rikonstruksionin e një pasurie të paluajtshme (shtëpi, apartament ose truall ku do të ndërtohet një godinë banimi).

Si kredi hipotekare këtu do të konsiderohen vetëm kreditë e marra nga anëtarët e familjes. Nëse hipoteka e banesës kryesore është përdorur si kolateral nga personat që nuk janë pjesëtarë të familjes (si për shembull kur banesa kryesore përdoret si kolateral për djalin, vajzën, të afërm që nuk janë anëtarë të familjes) këto detyrime nuk duhet të përfshihen në mes të borxhit hipotekar të shtëpisë. Vetëm nëse anëtarët e familjes marrin përgjegjësinë për këtë kredi, atëherë kjo kredi do të raportohet si pjesë e kredisë të kësaj familjeje.

Nëse banesa kryesore përdoret si kolateral së bashku me disa prona të tjera, atëherë në këtë rast kjo kredi to të përfshihet tek kreditë që kanë si kolateral në banesën kryesore të familjes.

“Kolaterali (Garancia)” - i referohet një aktivi (prone) ose disa aktiveve, që janë lënë si peng ose garanci për të bërë të mundur ripagimin e huasë. Shembull aktivi të lënë peng mund të jetë një shtëpi, një makinë, një pronë, një tokë, para etj. Nëse personi që ka marrë kredinë nuk është në gjendje që ta paguajë këtë hua sipas planit dhe afatit të përcaktuar, pasuritë e përdorura si kolateral do të konfiskohen dhe shiten, dhe paratë e fituara nga shitja e aktiveve do të përdoren për të shlyer kredinë.

P23. Sa kredi (hipotekare ose kredi tjetër) keni në total (numër)?
Periudha e referencës: Aktuale

Periudha e referimit është aktuale (në momentin që bëhet pyetja) sa është numri i kredive hipotekare ose i kredive të tjera, ku si kolateral (garanci) është lënë banesa kryesore.

P24. Cila është shuma mujore e paguar si qira (ju lutem përjashtoni energjinë, ujin, ngrohjen etj. nëse është e mundur)? Periudha e referencës: Aktuale

Për personat që jetojnë me qira në banesën e tyre kryesore merret informacion mbi qiranë që paguajnë për këtë banesë, duke përjashtuar shpenzimet për energji elektrike, ujë, ngrohje etj. Nëse nuk janë të përfshira në çmimin e qerasë.

MODULI 2B: KREDI ME KOLATERAL BANESËN KRYESORE
KËTU MERRRET INFORMACION MBI KREDITË KU SI KOLATERAL ËSHTË VENDOSUR BANESA KRYESORE. ZHVILLO PYETJET P25-P36 ME RRADHË, FILLIMISHT PËR KREDINË E PARË (KREDIA ME VLERËN MË TË MADHE, MË PAS PËR TË DYTËN NËSE KA). NËSE INTERVISTUESI PËRGJIGJET SE KA MË SHUMË SE 2 KREDI KU ËSHTË VENDOSUR SI KOLATERAL BANESA KRYESORE FILLIMISHT PYETET PËR 2 KREDITË ME VLERËN MË TË MADHE, PASTAJ PËR TË TJERAT.

P25. Kur ju/familja juaj përfitoi këtë kredi, cili ishte qëllimi i përdorimit të saj? Fillo me qëllimin kryesor të marrjes së kredisë/ (mos e lexo listën). Periudha e referencës: Aktuale

Për shlyerjen e borxheve të tjera - ka të bëjë zakonisht me marrjen e një kredie që përdoret për shlyerjen e një kredie tjetër. Zakonisht, marrja e kredisë së re merret me një normë më të ulët interesi, ose nga një kredi me normë të luhatshme, në kredi me normë fikse, me qëllim lehtësimin e shlyerjes së kredisë, për anëtarët e së njëjtës familjeje. Pra, të marrësh më mirë një kredi hipotekare me një shumë ose vlerë më të madhe, duke lënë si kolateral banesën kryesore, përkundrajt disa kredive të vogla që kanë norma interesi të larta.

Rifinancimi i kredisë – do të thotë të paguash një kredi ekzistuese me të ardhurat e përfituara nga një kredi e re, zakonisht e të njëjtës madhësi (por gjithashtu mund të jetë më e madhe, nëse huamarrësi

ka nevojë për më shumë para ose më e vogël). Zëvendësimi i një kredie zakonisht lejon që huamarrësi të përfitojë kushte më të mira, ndoshta në terma të një norme interesi më të ulët dhe / ose një periudhe më të gjatë pagese. Rifinancimi i kredisë i referohet shndërrimit të një kredie në një kredi tjetër, ku pagesat që kanë lindur nga kredia e parë, paguhen nga marrja e kredisë së re.

P26. Që kur ju/familja juaj e zotëroni këtë shtëpi (banesë), a keni pasur ndonjë kredi tjetër hipotekare përpara kredisë aktuale që ka pasur këtë banesë (shtëpi) si kolateral (garanci)? Periudha e referencës: Aktuale

Këtu pyetet nëse ka pasur ndonjë kredi tjetër përpara kësaj kredie, ku është lënë si kolateral apo garanci banesa kryesore.

P27. A e zëvendësuar kredinë e mëparshme me kredinë aktuale për të pasur kushte më të mira të kredisë, për të marrë një shumë më të madhe, apo për arsye tjetër? Fillo me qëllimin kryesor të marrjes së kredisë (mos e lexo listën). Kodo të gjitha qëllimet, numrat 1, 2, 3 përdori për të renditur nga qëllimi i parë tek i dyti e me radhë, nëse ka më shumë se një.

Rifinancimi i kredisë— do të thotë të paguash një kredi ekzistuese me të ardhurat nga një kredi e re, zakonisht e së njëjtit madhësie (por gjithashtu mund të jetë më e madhe, nëse huamarrësi ka nevojë për më shumë para ose më e vogël). Zëvendësimi i një kredie zakonisht lejon që huamarrësi të përfitojë kushte më të mira, ndoshta në terma të një norme interesi më të ulët dhe/ose një periudhe më të gjatë pagese. Rifinancimi i kredisë i referohet shndërrimit të një kredie në një kredi tjetër, ku pagesat që kanë lindur nga kredia e parë, paguhen nga marrja e kredisë së re.

P28. Që kur ju/familja juaj keni marrë kredinë hipotekare aktuale, a keni rinegociuar ndonjëherë ndonjë nga kushtet e kredisë? Periudha e referencës: Aktuale

Ri-negocimi i kredisë- i referohet situatës kur disa nga parametrat origjinalë të kredisë janë subjekt i ri-negocimit dhe ndryshimit. Kjo mund të bëhet me kërkesë të huamarrësit (p.sh. kërkesa për

ndryshim në shumën e pagesave të rregullta të huasë, zgjatjen e huasë, huamarrje shtesë në të njëjtën kredi) ose mund të rrjedhë nga rishikimi periodik i parametrave të zgjedhur të kredisë (parametrat e huasë janë të fiksuara për një periudhë të caktuar kohore dhe kur skadon kjo periudhë, ato i nënshtrohen ndryshimeve të mundshme, për shembull, norma e interesit, e cila mund të caktohet për një periudhë të caktuar dhe pastaj t'i nënshtrohet ri-negocimit).

Ndryshimi duhet të përfshijë të paktën një hap negocimi (si pranimi i propozimit të normës së re të interesit nga institucioni kreditues), nëse ndryshimi është i përfshirë në kontratë (si p.sh. norma e luhatshme e interesit, automatikisht e lidhur me bono thesari, në lekë ose euribor në euro, ose normë interesi tjetër referimi), nuk llogaritet si ri-negocim.

Ri-negocimi ndryshon parametrat e zgjedhur të kredisë ekzistuese, por nuk zëvendëson kredinë ekzistuese me një kontratë të re të kredisë (nëse është kështu, atëherë kemi të bëjmë me ri-financim).

P29. Në cilin vit ju/familja juaj keni marrë kredinë aktuale hipotekare/ kredinë më të fundit të ri-financuar/ të ri-negociuar. Zgjidh vetëm një alternativë. Periudha e referencës: -

Këtu synohet të merret informacion në lidhje me vitin në të cilin ju keni marrë kredinë aktuale hipotekare. Nëse kredia është ri-financuar duhet plotësuar viti i kredisë më të fundit të ri-financuar. Ndërsa kur kredia është ri-negociuar duhet viti kur është marrë kredia fillestare.

P30. Sa ishte shuma totale e parave hua marrë nga kredia aktuale/kredia më e fundit, e ri-financuar apo e ri-negociuar. Periudha e referencës: -

Kjo pyetje synon të marrë informacion mbi shumën totale të parave marrë hua (që përkufizohet si principal), jo interesat apo komisionet që përfshin kjo kredi.

P31. Përveç shumës fillestare të marrë hua, a keni marrë shtesë kredie (para të tjera) nga e njëjta kredi? Zgjidh vetëm 1 alternativë. Periudha e referencës: Aktuale

Këtu pyetet nëse janë marrë para shtesë apo jo nga e njëjta kredi.

P32. Në kohën kur kredia u disbursua (u mor)/u ri-negociua/u ri-financua, për sa vite në total keni rënë dakord për ta shlyer këtë kredi? Periudha e referencës: Aktuale

Vitet në total të shlyerjes së kredisë nënkuptojnë:

1. kohëzgjatjen totale të marrjes së kredisë;
2. kohën që nga negocimi i fundit i kredisë deri kur nevojitet të bëhet një tjetër ri-negocim;
3. kohën që nga financimi/ri-financimi i fundit i kredisë, deri kur kredia është planifikuar të që paguhet/shlyhet.

P33. Sa është në para shuma e pashlyer e kredisë (pjesa e mbetur e principalit, pa interesat)? (Zgjidh monedhën, shkruaj shumën) Periudha e referencës: Aktuale

Këtu synohet të merret informacion mbi pjesën e mbetur të pashlyer të kredisë, diferenca midis shumës fillestare të marrë hua dhe pjesës së mbetur pa u paguar. Këtu nuk duhet të përfshihen interesat që janë paguar apo pjesa e mbetur e interesave që duhet të paguhet.

P34. A ka kredia një normë interesi të luhatshme, pra a parashikon kontrata një normë interesi që ndryshon deri në shlyerjen e kredisë? (Vetëm 1 alternativë) Periudha e referencës: Aktuale

Norma e interesit (që zakonisht është vjetore) është çmimi/kostoja që ju paguani për këtë hua ose kredi të marrë. Kjo normë interesi mund të jetë fikse ose e luhatshme, që ndryshon sipas kushteve të kontratës. Pra një normë interesi e luhatshme do të thotë që kjo normë mund të ndryshojë vit për vit, një herë në dy vjet, një herë në pesë vjet etj. Normë interesi fikse do të thotë që norma është e pandryshuar gjatë gjithë periudhës së shlyerjes së kredisë.

P35. Sa është norma e interesit që keni paguar për këtë kredi (nëse pyetja 34=1 (normë referencë+spread), ose normën më të fundit fikse të interesit)? Periudha e referencës: Aktuale

Norma e interesit (që zakonisht është vjetore) është çmimi, kostoja që ju paguani për këtë hua ose kredi të marrë. Kjo normë interesi mund të jetë fikse ose e luhatshme, që ndryshon nga viti në vit, çdo dy vjet, çdo pesë vjet, sipas kushteve të kontratës. Nëse kredia ka një normë të luhatshme interesi, atëherë duhet të marrim informacion për normën më të fundit të luhatshme, që është norma referencë (bono thesari ose euribor) plus një interes të caktuar fiks.

P36. Aktualisht, sa është kësti (pagesa) mujor i kredisë? Periudha e referencës: Aktuale

Kësti mujor i kredisë përfshin shumën që ju duhet të paguani çdo muaj për të shlyer kredinë e marrë hua, e cila përfshin si shlyerjen e pjesës së kredisë së marrë hua (principalit), si dhe interesin (çmimin që banka merr në këmbim të saj) që ju paguani për këtë hua të marrë. Tek kësti mujor i kredisë nuk përfshihen pagesat që kanë të bëjnë me komisionin e disbursimi, pagesat për sigurimin e pronës dhe të jetës, etj.

Nëse pagesa mujore e kredisë ka ndryshuar me kalimin e kohës gjatë kohëzgjatjes së kredisë, atëherë si referencë merret kësti mujor aktual.

MODULI 2B: KREDI ME KOLATERAL BANESËN KRYESORE (VAZHDIM)

PËR INTERVISTUESIN: NËSE P23 (NUMRI I KREDIVE ME KOLATERAL BANESËN KRYESORE) ËSHTË MË I MADH SE 2, VAZHDO ME P37-P38 , PËRNDRYSHJE SHKO TEK P39.

P37. Për kredinë (të) tjetër që ka kolateral (garanci) shtëpinë kryesore, sa është totali i shumës (principali) së kredisë/kredive së marrë hua? (Për totalin e të gjitha kredive së bashku). Periudha e referencës: Aktuale

Nëse i intervistuari përgjigjet në P23 që numri i kredive që kanë kolateral banesën kryesore është për shembull katërt, në pyetjet 25-36 është marrë informacion për dy kreditë me vlerë më të madhe. Ndërsa në këtë pjesë merret informacion për kreditë e tjera së bashku,

pra për të tretën dhe të kartën bashkë. Përgjigja do të jetë për vlerën totale të kredisë marrë nga kredia e tretë dhe e katërt së bashku.

Shembull: Nëse kredia e tretë ka qenë 200 mijë dhe kredia e katërt 1 milion e 500 mijë, do të raportohet shuma: 200 mijë + 1 milion e 500 mijë=1 milion e 700 mijë lekë.

P38. Aktualisht, sa është totali i këstit (pagesa) mujor për këtë kredi/ këto kredi, (interes plus principal, duke përjashtuar pagesat për taksa, sigurime apo komisione të tjera)? Periudha e referencës: Aktuale

Përgjigja do të jetë kësti mujor për të gjitha kreditë së bashku. Bazuar në shembullin më lart, nëse kemi katër kredi dhe për dy kreditë e para është marrë informacion për këstin mujor për secilën kredi në pyetjet e mësipërme P25-P36, këtu do të jepet kësti mujor për kredinë e tretë dhe të katërt së bashku.

Kësti mujor i kredisë, përfshin shumën që ju duhet të paguani çdo muaj për të shlyer kredinë e marrë hua, e cila përfshin si shlyerjen e pjesës së kredisë së marrë hua, ashtu edhe interesin (çmimin që banka merr në këmbim të saj) që ju paguani për këtë hua të marrë. Tek kësti mujor i kredisë nuk përfshihen pagesat që kanë të bëjnë me komisione disbursimi, pagesat për sigurimin e pronës dhe të jetës. Nëse pagesa mujore e kredisë ka ndryshuar me kalimin e kohës gjatë kohëzgjatjes së huasë, atëherë për referencë merret kësti mujor aktual.

MODULI 2C: PASURI TË TJERA TË PATUNDSHME PËRVEÇ BANESËS (SHTEPISË) KRYESORE

KY MODUL MBLIEDH INFORMACION PËR PASURITË E TJERA TË PATUNDSHME QË KA FAMILIJA PËRVEÇ BANESËS KRYESORE.

P39. Përveç banesës/shtëpisë/apartamentit tuaj kryesor, a keni ju apo ndonjë anëtar tjetër i familjes tuaj pasuri të tjera të patundshme, si shtëpi, apartamente, garazhe, zyra, hotele, ndërtesa të tjera tregtare, fermë, tokë etj.? (Zgjidh vetëm një alternativë) Periudha e referencës: Aktuale

Të përfshihet çdo pasuri e patundshme që zotëron familja si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë. Këtu duhet të përfshihen edhe pasuritë që ka biznesi, nëse ai zotërohet plotësisht ose pjesërisht nga një ose disa anëtarë të familjes. Nëse pasuria zotërohet vetëm nga biznesi, nuk duhet të përfshihet ose të llogaritet si pasuri e familjes.

P40. Sa prona të tilla në numër keni ju (apo familja juaj) si pronar/e i/e vetëm ose bashkëpronare?

Këtu i intervistuesi duhet të shprehet për numrin total të pronave që ka familja në pronësi të plotë apo si bashkëpronare.

PASI I INTERVISTUESI SHPREHET PËR NUMRIN E PRONAVE QË KA, PYETET PËR 2 PASURITË MË TË RËNDËSISHME PËR NGA VLERA E TYRE (PYETJA P41-P44), PASTAJ PËR TË TJERAT (PËR TË TRETËN, TË KATËRTËN, TË PESTËN ETJ.) NËSE KA TEK PYETJA P45. FILLO ME PRONËN QË KA VLERËN MË TË MADHE.

P41. Çfarë lloj pasurie (prone) është? Periudha e referencës: Aktuale

Shtëpi ose apartament - përfshin vilat, shtëpitë me tarraca, apartamentet.

Godinë apartamentesh do të thotë të zotërosh të gjitha apartamentet, pra të gjithë ndërtesën.

P42. Për çfarë përdoret pasuria? Periudha e referencës: Aktuale

Aktivitet biznesi nga ju (ose nga dikush tjetër në familje) - nënkupton vetëm shfrytëzimin e pronës për aktivitet të biznesit që zotërohet nga një ose disa anëtarë të familjes . Nëse prona është marrë me qira nga një biznes që nuk zotërohet nga anëtarët e familjes ose nuk është në pronësi të anëtarëve të familjes, atëherë prona do të konsiderohet se përdoret me qira.

P43. Çfarë përqindje (%) të vlerës së pronës zotëroni ju/familja juaj? Periudha e referencës: Aktuale

Këtu merret informacion mbi përqindjen e pjesës së pronës që ju apo familja juaj zotëroni, që mund të jetë 75% (treçereku i pronës); 50% (gjysma e pronës), 25% (çereku i pronës) etj., sipas rastit. Shembull: Nëse i intervistuari pohon që familja zotëron për shembull 1 të tretën e pronës, për ta kthyer në përqindje mjafton që 1 ta pjesëtoni me 3 dhe ta shumëzoni me 100 dhe do të merrni vlerën që zotëron familja juaj, pra 33%. Përqindja e pronës që një individ (apo familja) zotëron është nga 1% deri në 100% (kufijtë që një person mund të zotërojë një banesë).

P44. Sa mendoni se është vlera e kësaj prone nëse do ta shisnit sot? Nëse është fermë, mos përfshini vlerën e mjeteve, prodhimeve bujqësore dhe bagëtisë. Nëse jeni pronar i një pjese, konsideroni vlerën e të gjithë pronës. Periudha e referencës: Aktuale

Përgjigja e kërkuar ka të bëjë me vlerën aktuale të pronës, që është vlera në lekë apo në euro që do të merrni nëse do vendosnit ta shisnit atë sot apo në këtë moment pronën.

PËR INTERVISTUESIN: NËSE NUMRI I PRONAVE MË I MADH SE 2 (P40>2), PYET PËR TOTALIN E PRONAVE TË TJERA, PËRNDRYSHE KALO TE P46.

P45. Nëse ju apo familja juaj do të vendosnit të shisni këto prona (pronën e tretë, të katërt, të pestë e me radhë) sot, sa do të ishte vlera që do të merrnit nga shitja e tyre?

Përgjigja e kërkuar ka të bëjë me vlerën aktuale të pronave të tjera së bashku (të 2-të, të 3-të, e me radhë), që është vlera në lekë apo në euro në total që do të përfitonit nëse do të vendosnit që t'i shisnit të gjitha pronat e tjera sot në këtë moment.

MODULI 2D: KREDI ME KOLATERAL PASURITË E TJERA TË PATUNDSHME (TË PËRMENDUARA NË MODULIN 2C)

KY MODUL KA PËR QËLLIM MARRJEN E INFORMACIONIT PËR KREDITË, KU KOLATERAL APO GARANCI JANË VENDOSUR PASURITË (APO PRONAT) E TJERA TË PATUNDSHME TË PËRMENDUARA NË MODULIN 2C.

P46. A keni ju ndonjë kredi hipotekare apo kredi tjetër ku keni vendosur ndonjë nga këto prona (pasuri të tjera të patundshme, përveç banesës kryesore) si kolateral (garanci)? (Zgjidh vetëm 1 alternativë) Periudha e referencës: ----

Këtu merret informacion nëse familja ka kredi ku ka vendosur si kolateral (apo garanci) pasuri të tjera të patundshme, duke përjashtuar kreditë të cilat kanë vendosur banesën kryesore si kolateral.

P47: Sa kredi me kolateral prona të tjera të patundshme (përveç banesës kryesore) keni në total si numër? Periudha e referencës: aktuale

Këtu merret në informacioni mbi numrin në total të kredive që ka familja, ku si kolateral janë vendosur pronat e tjera të patundshme.

KËTU MERRET INFORMACION MBI KREDITË KU SI KOLATERAL JANE VENDOSUR PRONAT E TJERA TË PATUNDSHME. ZHVILLO PYETJET P48-P59 ME RRADHE, FILLIMISHT PER KREDINË E PARË (KREDIA ME VLERËN MË TË MADHE, MË PAS PËR TË DYTËN, NËSE KA). NËSE I INTERVISTUARI PËRGJIGJET SE KA MË SHUMË SE 2 KREDI KU JANE VENDOSUR SI KOLATERAL PRONAT E FAMILJES, FILLIMISHT PYETET PËR 2 KREDITË ME VLERËN MË TË MADHE, PASTAJ PËR TË TJERAT.

P48. Kur ju/familja juaj përfitoi këtë kredi, cili ishte qëllimi i përdorimit të saj? Fillo me qëllimin kryesor të marrjes së kredisë/ (mos e lexo listën). Kodo të gjitha qëllimet, numrat nga 1 tek 9 përdori për të renditur nga qëllimi i parë tek i dyti e me radhë. Periudha e referencës: -----

Nëse banesa kryesore e familjes dhe prona të tjera që i përkasin familjes përdoren si kolateral për të njëjtën kredi, kredia duhet të përfshihet si kredi e kolateralizuar për banesën kryesore dhe nuk raportohet përsëri këtu.

P49. Që kur ju/familja juaj e zotëroni këtë shtëpi (banesë), a keni pasur ndonjë kredi tjetër hipotekare përpara kredisë aktuale që ka pasur këtë pronë (shtëpi) si kolateral (garanci)? Zgjidh vetëm një alternativë. Periudha e referencës: -----

Këtu pyetet nëse ka pasur ndonjë kredi tjetër përpara kësaj kredie ku është lënë si kolateral apo garanci kjo banesë ose pronë.

P50. A e zëvendësuar kredinë e mëparshme me kredinë aktuale për të pasur kushte më të mira të kredisë, për të marrë një shumë më të madhe, apo për arsye tjetër? Fillo me qëllimin kryesor të marrjes së kredisë (mos e lexo listën). Kodo të gjitha qëllimet, numrat 1, 2, 3 përdori për të renditur nga qëllimi i parë tek i dyti e me radhë. Periudha e referencës: -----

Ri-financimi i kredisë-i referohet shndërrimit të një kredie në një kredi tjetër, ku pagesat që kanë lindur nga kredia e parë, paguhen nga marrja e kredisë së re.

P51. Që kur ju/familja juaj ka marrë kredinë hipotekare aktuale, a keni rinegociuar ndonjëherë ndonjë nga kushtet e kredisë? Zgjidh vetëm një alternativë. Periudha e referencës:-----.

Ri-negocimi i kredisë - i referohet situatës kur disa nga parametrat origjinale të kredisë janë subjekt i rinegocimit dhe ndryshimit. Kjo mund të bëhet me kërkesë të huamarrësit (p.sh. kërkesa për ndryshim në shumën e pagesave të rregullta të huasë, zgjatjen e huasë, huamarrje shtesë në të njëjtën kredi) ose mund të rrjedhë nga rishikimi periodik i parametrave të zgjedhur të kredisë (parametrat e huasë janë të fiksuara për një periudhë të caktuar kohore dhe kur skadon kjo periudhë, ato i nënshtrohen ndryshimeve të mundshme, për shembull, norma e interesit e cila mund të caktohet për një periudhë të caktuar dhe pastaj t'i nënshtrohet ri-negocimit).

Ndryshimi duhet të përfshijë të paktën një hap negocimi (si pranimi i propozimit të normës së re të interesit nga institucioni kreditues), nëse ndryshimi është i përfshirë në kontratë (si p.sh. norma e luhatshme e interesit automatikisht e lidhur me bono thesari, në lekë ose euribor në euro, ose normë interesi tjetër referimi), nuk llogaritet si ri-negocim.

Ri-negocimi ndryshon parametrat e zgjedhur të kredisë ekzistuese, por nuk zëvendëson kredinë ekzistuese me një kontratë të re të kredisë (nëse është kështu, atëherë kemi të bëjmë me ri-financim).

P52. Në cilin vit ju/familja juaj keni marrë kredinë aktuale hipotekare/ kredinë më të fundit të ri-financuar/ të ri-negociuar? Periudha e referencës: -----

Këtu synohet të merret informacion në lidhje me vitin në të cilin ju keni marrë kredinë aktuale hipotekare. Nëse kredia është ri-financuar, duhet viti i kredisë më të fundit të ri-financuar. Ndërsa kur kredia është ri-negociuar duhet viti kur është marrë kredia fillestare.

Këtu synohet të merret informacion në lidhje me vitin në të cilin ju keni marrë kredinë aktuale hipotekare. Nëse kredia është ri-financuar, duhet plotësuar viti i kredisë më të fundit të ri-financuar, ndërsa kur kredia është ri-negociuar, duhet viti kur është marrë kredia fillestare.

P53.Sa ishte shuma totale e parave hua marrë nga kredia aktuale/ kredia më e fundit, e ri-financuar apo e ri-negociuar? Periudha e referencës: -----

Kjo pyetje synon të marrë informacion mbi shumën totale të parave marrë hua (që përkufizohet si principal), jo interesat apo komisionet që përfshin kjo kredi.

P54. Përveç shumës fillestare të marrë hua, a keni marrë shtesë kredie (para të tjera) nga e njëjta kredi? Zgjidh vetëm një alternativë. Periudha e referencës: aktuale

Këtu pyetet nëse janë marrë para shtesë apo jo nga e njëjta kredi.

P55. Në kohën kur kredia u disbursua (u mor)/u ri-nogocia/u ri-financua, për sa vite në total keni rënë dakord për ta shlyer këtë kredi? Periudha e referencës: aktuale

Vitet në total të shlyerjes së kredisë nënkuptojnë:

1. kohëzgjatjen totale të marrjes së kredisë;
2. koha që nga negocimi i fundit i kredisë, deri kur nevojitet të bëhet një tjetër ri-negocim;
3. koha që nga financimi/ri-financimi i fundit i kredisë, deri kur kredia është planifikuar të paguhet/shlyhet.

P56. Sa është në para shuma e pashlyer e kredisë (pjesa e mbetur e principalit, pa interesat)? Periudha e referencës: aktuale

Këtu synohet të merret informacion mbi pjesën e mbetur të pashlyer të kredisë, diferenca midis shumës fillestare të marrë hua, dhe pjesës së mbetur pa u paguar. Këtu nuk duhet të përfshihen interesat që janë paguar apo pjesën e mbetur të interesave që duhet të paguhen.

P57. A ka kredia një normë interesi të luhatshme, pra a parashikon kontrata një normë interesi që ndryshon deri në shlyerjen e kredisë? Zgjidh vetëm një alternativë. Periudha e referencës: aktuale

Norma e interesit (që zakonisht është vjetore) është çmimi/kostoja që ju paguani për këtë hua ose kredi të marrë. Kjo normë interesi mund të jetë fikse ose e luhatshme, që ndryshon sipas kushteve të kontratës. Pra, një normë interesi e luhatshme do të thotë që kjo normë mund të ndryshojë vit për vit, një herë në dy vjet, një herë në pesë vjet etj. Normë interesi fikse do të thotë që norma është e pandryshuar gjatë gjithë periudhës së kredisë.

P58. Sa është norma e interesit që keni paguar për këtë kredi (nëse pyetja 57=1 (normë referencë +spread), ose normën më të fundit fikse të interesit)? Periudha e referencës: aktuale

Norma e interesit (që zakonisht është vjetore) është çmimi, kostoja që ju paguani për këtë hua ose kredi të marrë. Kjo normë interesi mund të jetë fikse ose e luhatshme, që ndryshon nga viti në vit, çdo dy vjet, çdo pesë vjet, sipas kushteve të kontratës. Nëse kredia ka një normë të luhatshme interesi, atëherë duhet të marrim informacion për normën më të fundit të luhatshme, që është norma referencë (bono thesari ose euribor) plus një interes të caktuar fiks.

P59. Aktualisht, sa është kësti (pagesa) mujor i kredisë? (Zgjidh monedhën, shkruaj shumën) Periudha e referencës: aktuale

Kësti mujor i kredisë përfshin shumën që ju duhet të paguani çdo muaj për të shlyer kredinë e marrë hua, e cila përfshin si shlyerjen e

pjesës së kredisë së marrë hua (principalit), si dhe interesin (çmimin që banka merr në këmbim të saj) që ju paguani për këtë hua të marrë. Tek kësti mujor i kredisë nuk përfshihen pagesat që kanë të bëjnë me komision disbursimi, pagesat, për sigurimin e pronës dhe të jetës.

Nëse pagesa mujore e kredisë ka ndryshuar me kalimin e kohës gjatë kohëzgjatjes së kredisë, atëherë si referencë merret kësti mujor aktual.

MODULI 2B: KREDI ME KOLATERAL PRONA TË TJERA (VAZHDIM)

PËR INTERVISTUESIN: NËSE P47 (NUMRI I KREDIVE ME KOLATERAL PASURI TË TJERA) ËSHTË MË I MADH SE 2, VAZHDO ME P60-P61, PËRNDRYSHJE SHKO TEK P62

P60. Sa është shuma e pashlyer (principali) e kredisë/kredive në para? Periudha e referencës: aktuale

Nëse i intervistuari përgjigjet në pyetjen P47 që numri i kredive që kanë kolateral pasuri të tjera është për shembull katër, në pyetjet 48-59 do të merret informacion për dy kreditë me vlerë më të madhe. Ndërsa në këtë pjesë merret informacion për të tjerat së bashku, pra për të tretën dhe të kartën bashkë. Përgjigja do të jetë për vlerën totale të kredisë marrë nga kredia e tretë dhe e katërt së bashku.

P61. Sa ka qenë pagesa mujore për (kreditë/ këto kredi), duke përjashtuar pagesat për taksa, sigurime apo komisione të tjera? Periudha e referencës: aktuale

Përgjigja do të jetë kësti mujor për të gjitha kreditë së bashku. Bazuar në shembullin më lart, nëse kemi katër kredi dhe për dy kreditë e para është marrë informacion për secilën në pyetjet P48-P59, këtu do të jepet kësti mujor për kreditë e tretë dhe të katërt së bashku.

Kësti mujor i kredisë përfshin shumën që ju duhet të paguani çdo muaj për të shlyer kreditë e marrë hua, e cila përfshin si shlyerjen e

pjesës së kredisë së marrë hua, ashtu edhe interesin (çmimin që banka merr në këmbim të saj) që ju paguani për këtë hua të marrë. Tek kësti mujor i kredisë nuk përfshihen pagesat që kanë të bëjnë me komision disbursimi, pagesat, për sigurimin e pronës dhe të jetës. Nëse pagesa mujore e kredisë ka ndryshuar me kalimin e kohës gjatë kohëzgjatjes së huasë, atëherë për referencës merret kësti mujor aktual.

MODULI 2E: AUTOMJETE DHE MJETE TË TJERA TRANSPORTI

P62. A zotëroni ju ose një anëtar tjetër i familjes ndonjë makinë (automjet)? Periudha e referencës së pyetjes: aktuale

Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. Këtu pyetet për kategorinë e autoveturave, që janë mjete të destinuara për transport njerëzish me maksimumi nëntë ndenjësë, përfshirë ndenjësën e drejtuesit të mjetit.

INTERVISTUESI DUHET TË PYESË EDHE PËR TË GJITHA AUTOMJETET QË PËRDOREN PËR BIZNES/BIZNESE. NËSE AUTOMJETET JANE NË EMËR TË NJË ANËTARI TË FAMIJES, POR PËRDOREN NË BIZNESIN E ZOTERUAR NGA FAMIJJA, ATËHERË AUTOMJETET KONSIDEROHEN QË ZOTËROHEN NGA FAMIJJA. NËSE AUTOMJETET ZOTËROHEN NGA BIZNESI, PRA NUK JANË NË EMËR TË NJË ANËTARI TË FAMIJES, ATËHERË NUK DUHET TË LLOGARITEN NË PRONËSI TË FAMIJES. NUK DUHET TË LLOGARITEN KËTU EDHE AUTOMJETET QË JANË ME KONTRATË LEASING (QERA FINANCIARE).

P63. Nëse ju apo familja juaj do të vendoste të shiste këtë makinë/këto makina sot, sa para mendoni se do të përfitonit? Periudha e referencës: aktuale

Ajo që kërkohet është vlera e tregut e automjeteve sot. Nëse vlera e sigurimit të makinës është një përafrim më i mirë me vlerën e vërtetë të automjetit, atëherë të anketuarit duhet të inkurajohen që ta citojnë këtë vlerë.

P64. A zotëroni ju ose anëtarët e tjerë të familjes mjete të tjera transporti, si motoçikletë, kamion, furgon, avion, varkë, jaht etj.? Periudha e referencës: aktuale

Këtu pyetet për numrin e të gjitha moto mjeteve që zotëron familja, pa përfshirë automjetet (e përmendura më lart). Tek mjetet e tjera përfshihen motoçikletat, kamionët, furgonat, avionët, varkat, mjetet e transportit të veçantë etj. Një përkufizim i mjeteve të tjera gjendet si më poshtë:

Moto mjetet janë mjete me motor, me dy, tri ose katër rrota dhe ndahen në:

- motorë: mjete me dy rrota, të destinuar për transport njerëzish, në numër jo më të madh se dy veta, duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit;
- motorë me kosh: mjete me tri rrota, të destinuar për transport njerëzish, të pajisura me karroceri të përshtatshme dhe të afta të mbajnë deri në katër njerëz, duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit;
- moto mjetet për transport të përzier: mjete me tri rrota, të destinuar për transport njerëzish ose mallrash me maksimumi katër ndenjëse, përfshirë edhe atë të drejtuesit të mjetit;
- moto karro: mjet me tri rrota, i destinuar për transport malli;
- moto tërheqës: moto karro me tri rrota, e destinuar për tërheqjen e gjysmë rimorkiove;
- moto karro për transporte të veçanta: mjete me tri rrota, të destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohen nga pajisja, në mënyrë të përhershme, me mekanizma speciale që i shërbejnë këtij qëllimi;
- moto karro për përdorim të veçantë: mjete me tri rrota dhe të pajisura me mekanizma të veçantë që qëndrojnë gjithmonë mbi to. Në këto mjete lejohet transporti i personelit dhe materialeve që lidhen me ciklin operativ të këtyre mekanizmave;
- autokarro: mjet me katër rrota i destinuar për transport mallrash, me maksimumi një njeri në kabinë përveç drejtuesit të mjetit. Kryen transport të veçantë dhe përdoret në raste të veçanta. Pësha e mjetit pa ngarkesë nuk i kalon 0,55 tonët, duke përfshirë peshën e baterive nëse ka tërheqje elektrike dhe është i aftë të lëvizë në rrugë horizontale me një shpejtësi maksimale deri në 80 km/h. Karakteristikat konstruktive janë përcaktuar në aktet në zbatim. Mjete të tilla,

në qoftë se kalojnë edhe vetëm njërin prej kufijve të mësipërm, konsiderohen automjete.

Automjetet janë mjete të tjera me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. Ato përfshijnë:

- autobus: mjet i destinuar për transport njerëzish me më shumë se nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;
- automjet për transport të përzier: mjet që ka një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike a me bateri. Janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;
- kamion: mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave;
- tërheqës: mjet i destinuar vetëm për tërheqjen e rimorkiove ose gjysmë rimorkiove;
- automjet për transport të veçantë: mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përhershme, me mekanizma specialë që i shërbejnë këtij qëllimi;
- automjet për përdorim të veçantë: mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave. Mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave;
- auto trenat: komplekse mjetesh të përbëra nga dy njësi të veçanta të lidhura bashkë, nga të cilat njëra është udhëzuese.
- gjysmë rimorkiatorë: mjete të përbëra nga një tërheqës dhe nga një gjysmë rimorkio;
- artikular: është autobus i përbërë nga dy pjesë të ngurta të lidhura ndërmjet tyre nëpërmjet një mekanizmi të artikulluar. Në këta tipa mjetesh pasagjerët e secilës pjese qarkullojnë

lirisht nga njëra te tjetra. Ndarja ose lidhja e të dyja pjesëve të mjetit me njëra-tjetrën bëhet vetëm në ofiçinë;

- auto kampe: mjete që kanë një karroceri speciale dhe janë të pajisura në mënyrë të përhershme për t'iu përshtatur transportit dhe strehimit të deri shtatë njerëzve, duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit;
- makina ngarkim-transporti: mjete ose komplekse mjetesh që kanë pajisje të veçanta për ngarkimin dhe transportin e materialeve që përdoren, ose janë produkt i punimeve të ndërtimit dhe të gërmimeve në miniera, si dhe të materialeve që plotësojnë gjatë ecjes ciklin e prodhimit të tyre.

P66. Sa mjete të tilla transporti zotëroni ju ose familja juaj në total? PYET: A përdoret ndonjë prej tyre për qëllime biznesi? [nëse po, bëj një shënim] Periudha e referencës: aktuale

Këtu pyetet për numrin total të mjeteve të transportit që zotëron familja. Gjithashtu, pyetet nëse ndonjë prej këtyre mjeteve është përdorur apo jo për qëllime biznesi.

P67. Nëse ju apo familja juaj do të vendoste të shiste këtë mjet/këto mjete sot, sa para mendoni se do të përfitonit? (zgjidh monedhën, shkruaj shumën) Periudha e referencës: aktuale

Këtu synohet të merret informacion për vlerën në Lek ose në Euro që do të merrnit nga shitja e këtyre mjeteve në këtë moment, nëse do të vendosnit t'i shisnit ato sot.

P68. A zotëron familja juaj objekte me vlerë si vepra arti, antike, bizhuteri etj.? (Zgjidh vetëm një alternativë) Periudha e referencës: aktuale

Këtu merret informacion në lidhje me sendet apo objektet me vlerë që zotëron familja si veprat e artit, veprat antike, bizhuteritë etj.

P69. Me përafërsi, sa mendoni se do të përfitonit nga shitja e këtyre objekteve me vlerë (si për shembull, bizhuteri, vepra arti etj.) së bashku në total? Periudha e referencës: aktuale

Nëse anketuesi nuk jep një vlerë të saktë për objektet me vlerë, atëherë të paktën të japë një vlerë të përafërt për atë që mendon se mund të jetë vlera e tregut e këtyre objekteve së bashku.

P70. Gjatë vitit 2018, a keni blerë ju/familja juaj ndonjë automjet, motoçikletë ose mjete të tjera transporti? (Vetëm 1 alternativë) Periudha e referencës: aktuale

Këtu pyetet nëse gjatë vitit 2018 familja ka blerë ndonjë nga automjetet apo motomjetet që zotëron.

P71. Sa ishte vlera totale që familja ka paguar për këtë/këto mjete transporti? (zgjidh monedhën, shkruaj shumën)

Këtu do të jepet informacion në lidhje me vlerën totale të mjeteve që ka paguar familja për blerjen e këtij apo këtyre mjeteve të transportit. Nëse familja ka shkëmbyer një mjet/disa mjete të mëparshme me mjetin aktual, atëherë shëno vlerën zero. Nëse familja ka shkëmbyer një mjet/disa mjete të mëparshme, si dhe një shumë parash me mjetin aktual, atëherë shëno vetëm shumën e parave.

MODULI 3: DETYRIME TË TJERA

NË KËTË MODUL MERRRET INFORMACION PËR DETYRIMET E TJERA QË KA FAMILJA, QË KANË TË BËJNË ME INSTRUMENTET E BORXHIT, QË NUK LËNË PENG NJË KOLATERAL (GARANCI), PRA PËR KARTAT E KREDITIT DHE LLOGARITË OVERDRAFT, SI DHE PËR KREDITË E TJERA JO TË KOLATERIZUARA, SI PËR SHEMBULL KREDITË KONSUMATORE DHE BORXHIN QË KANË FAMILJET NDAJ TË TJERËVE.

P72. A keni aktualisht ju apo anëtarët e tjerë të familjes tuaj një kontratë leasing (p.sh. për makinë etj.)? Periudha e referencës: aktuale

Në kontratën e qirasë financiare (leasing), njëra palë detyrohet të vërë në dispozicion të palës tjetër, për një kohë të caktuar, një send të luajtshëm ose të paluajtshëm, kundrejt një pagese me afate periodike, të përcaktuar në lidhje me vleftën e sendit, me kohëzgjatjen e kontratës dhe, eventualisht me elemente të tjera sipas marrëveshjes së palëve. Qiramarrësi merr në zotërim të menjëhershëm sendin,

objektin, megjithëse në ligj mbetet pronë e shitësit ose qiradhënësit, deri në momentin kur të jeni kryer me sukses të gjitha pagesat e rëna dakord. Sendi përcaktohet nga qiradhënësi sipas kërkesave të vetë qiramarrësit, ku i fundit ka të drejtë që të fitojë pronësinë mbi këtë send, në mbarim të afatit të kontratës, kundrejt pagesës së një shume të paracaktuar. Qiradhënësi përgjigjet ndaj qiramarrësit sipas rregullave të përgjithshme për mosdorëzimin e sendit ose vonesën në dorëzimin e sendit, si dhe për të metat e sendit. Me marrëveshje mund të parashikohet që qiramarrësi, para se të kërkojë nga qiradhënësi të drejtat e tij, duhet t'i drejtohet atij që i dha sendin (furnizuesit) për të drejtat e tij ose që i janë kaluar atij.

P.73. Sa është shuma totale mujore që paguani për këtë kontratë leasing? Periudha e referencës: aktuale

Ka të bëjë me shumën totale mujore që paguhet për këtë kontratë leasing. Nëse përgjigja jepet për një frekuencë tjetër, për shembull gjashtëmujore ose njëvjeçare, konvertoje atë në pagesën mujore, duke e pjesëtuar përkatësisht vlerën e dhënë me 6 ose 12.

P.74 A keni ju ose një anëtar tjetër i familjes një llogari overdraft-i ose linjë kredie me një institucion financiar? Periudha e referencës: aktuale

Linjat e kredisë dhe overdraft-i bëjnë pjesë në ato produkte që njihen me emrin kontratë e kredisë kufi. Ato bëjnë pjesë në llojin e kredisë konsumatore sipas së cilës banka i jep konsumatorit mundësinë e disponimit të fondeve në llogarinë e tij rrjedhëse, që tejkalojnë gjendjen aktuale të fondeve në këtë llogari ose premtion t'i japë kredi mbajtësit të kartës së kreditit, deri në një kufi të paracaktuar në kontratë.

Linjë kredie është një kredi ku banka merr përsipër t'i japë kredi një klienti gjatë një periudhe të caktuar. Klienti mund ta tërheqë të gjithë shumën e kredisë përnjëherësh ose të bëjë disa tërheqje gjatë një periudhe të caktuar kohe. Linjat e kredisë, zakonisht, mund të jepen në bazë të një "kontrate çadër" që lejon konsumatorin të tërheqë një shumë maksimale kredie bazuar mbi totalin e shumës të të gjitha llogarive që ka klienti.

Overdrafti është një kredi afatshkurtër me qëllim për t'i shërbyer kërkesave të konsumatorit, kur llogaria e klientin bëhet zero. Një overdraft i lejon klientit të vazhdojë të tërheqë fonde edhe kur nuk llogaria nuk ka fonde, duke bërë që banka t'i lejojë të marrë hua një sasi të caktuar fondesh.

P76. Sa është shumë në total për t'u paguar për këto llogari (detyrime)? Periudha e referencës: aktuale

Sa është balanca negative që keni në këtë/këto llogari së bashku (total).

P77. A keni ju ose një anëtar tjetër i familjes kartë krediti, përveç atyre në pronësi të punëdhënësit (karta që janë në pronësi individuale)? Periudha e referencës: aktuale

Kartat e kreditit, si për shembull (Visa, Amex, Master Card, Diners etj.), në ndryshim nga ato të debitit, na mundësojnë të bëjmë blerje nga POS-e dhe interneti apo të tërheqim cash nga ATM/POS, brenda një kufiri të paracaktuar, pa pasur fonde në llogarinë tonë, por duke përdorur fondet që banka na ka vënë në dispozicion. Interesi duhet paguar për çdo shumë të parasë që nuk është shlyer në fund të muajit, bazuar në limitet e vendosura.

Kartat e debitit na mundësojnë të përdorim fondet e depozituara në llogarinë tonë rrjedhëse apo atë të kursimit. Transaksioni regjistrohet në llogarinë e klientit në mënyrë të menjëhershme. Për këtë arsye, është e rëndësishme që llogaria të përmbajë fonde të mjaftueshme për të përballuar blerjen apo tërheqjen e cash-it. Teorikisht, nëpërmjet kartës mund të tërheqim të gjithë fondin që përmban llogaria personale. Megjithatë, për arsye sigurie, përgjithësisht, shumë që mund të tërheqim nga ATM-të apo që mund të paguajmë nëpërmjet POS-ve, ka një kufi ditor (limit) të paracaktuar nga banka.

P78. Pas pagesës së faturës/faturave së fundit mujore, a ke/keni një shumë të pashlyer në kartën e kreditit mbi të cilën aplikohet interes? (Zgjidh vetëm 1 alternativë)

Këtu synohet të merret informacion në lidhje me huanë (kreditin) që ju keni në kartat e kreditit në momentin e intervistës, pra që i referohet shumës që duhet t'ia ktheni bankës.

P79. Sa është shuma (detyrimi) për t'u paguar?

Shuma i referohet të gjithë huasë së papaguar në kartën e kreditit në momentin e intervistës, duke përfshirë transaksionet e muajit të fundit. Qëllimi është që të merret informacion mbi borxhin aktual se sa për pagesat e vonuara.

P80. A keni marrë borxh (hua) nga të afërm ose miq, të cilat prisni t'i shlyeni në të ardhmen? Periudha e referencës: aktuale

Këtu pyetet për borxhin që ju keni ndaj të afërmeve ose familjarëve, dhe jo për huanë e marrë në institucionet financiare.

P81. Sa borxhe të tilla keni në numër në total? Periudha e referencës: aktuale

Pyetja synon të marrë informacion mbi numrin aktual të borxheve që keni ndaj të afërmeve.

MODULI 3: DETYRIME TE TJERA (VAZHDIM)

QËLLIMI KËTU ËSHTË TË MERRET INFORMACION MBI BORXHIN QË FAMILIJA KA NDAJ FAMILJARËVE OSE TË AFËRMEVE, SI DHE MBI KREDINË KONSUMATORE.

Më konkretisht pyetjet 82 dhe 83 synojnë të marrin informacion mbi dy borxhet me vlerë më të madhe për familjen, duke filluar me qëllimin e përdorimit të borxhit, si dhe mbi vlerën e pashlyer të borxhit. Ndërsa pyetjet (84-91) e tjera synojnë të marrin informacion mbi kreditin konsumatore, qëllimin e përdorimit të saj etj.

NËSE NUMRI I BORXHEVE ËSHTË MBI 2, MERRET INFORMACION PËR 2 BORXHET ME VLERË MË TË MADHE PËR FAMILIJEN. ZHVILLO PYETJET P82 DHE P83 ME RRADHË, FILLIMISHT PËR BORXHIN E PARË (BORXHI ME VLERËN MË TË MADHE), MË PAS PËR BORXHIN E DYTË, NËSE KA.

P82. Cili ishte qëllimi i përdorimit të borxhit? Periudha e referencës: aktuale

Pyetja konsiston në përcaktimin e qëllimit kryesor të këtij borxhi të marrë nga të afërmit, si dhe të përcaktohet rëndësia e qëllimit të përdorimit të borxhit, nga qëllimi kryesor ose ai më i rëndësishëm deri tek ai më pak i rëndësishëm, duke vendosur numrat nga 1 deri në 7 sipas rëndësisë. Për shembull, nëse borxhi është marrë për qëllime edukimi dhe për të shlyer borxhe të tjera, qëllimi kryesor i borxhit në këtë rast për edukimin merr numrin 1, dhe për borxhe të tjera numrin 2.

P83. Sa është në para shuma e pashlyer e borxhit (pa interesat)? Periudha e referencës: aktuale

Këtu synohet të merret informacion në lidhje me pjesën e mbetur nga ky borxh, pa marrë në konsideratë interesat që paguhen për të.

PYETJET 84-91 KANË PËR QËLLIM TË MARRIN INFORMACION MBI KREDITË KONSUMATORE TË FAMILJES.

P84. A keni kredi konsumatore (p.sh. kredi makine, kredi për blerjen e pajisjeve elektro-shtëpiake, elektronike, për mobilim, për edukim, kredi për të mbuluar shpenzime të menjëhershme, të paparashikuara ose jo etj.)? Periudha e referencës: aktuale

Kredia konsumatore i referohet kredive që marrin familjet për qëllime të ndryshme, si për blerjen e makinës, për blerjen e pajisjeve elektro-shtëpiake, për mobilim, për edukim, për nevoja shëndetësore, për pushime, për shpenzimet të tjera të familjes etj. Këto kredi merren në banka, institucione të tjera financiare dhe nuk kërkohet që të vendoset ndonjë kolateral (garanci) për marrjen e këtyre kredive.

P85. Sa kredi konsumatore keni (në numër)? Periudha e referencës: aktuale

Sa është numri total i kredive konsumatore që keni, sipas përkufizimit më sipër.

PYETJET 86-91 SYNOJNË TË MARRIN INFORMACION PËR 2 KREDITË KONSUMATORE MË TË RËNDËSISHME BAZUAR NË VLERËN E TYRE. FILLIMISHT MERRET INFORMACION PËR KREDINË MË TË MADHE NË VLERË, PASTAJ VAZHDOHET ME KREDINË E DYTË (NËSE KA TË TILLË).

P86. Pse e keni marrë këtë kredi?

Kjo pyetje synon të marrë informacion mbi qëllimin kryesor të marrjes së kredisë konsumatore, bazuar në alternativat e renditura. Numrat 1 deri në 9 do të shërbejnë për të renditur të gjitha qëllimet me radhë. Pyetja është me disa zgjedhje sepse një kredi e marrë mund të përdoret për t'i shërbyer njëkohësisht dy ose më shumë qëllimeve.

P87. Sa ishte shuma fillestare totale e marrë hua?

Kjo pyetje synon të marrë informacion mbi shumën e marrë hua për kredi konsumatore, duke marrë në konsideratë vetëm principalin, jo interesat apo komisionet që përfshin kjo kredi.

P88. Për sa vite keni rënë dakord për ta shlyer këtë kredi?

Kjo kohë përfshin vitet në total të shlyerjes së kredisë, që nga momenti i marrjes së saj deri në momentin kur kjo kredi planifikohet të paguhet (s'ka detyrime të tjera ndaj saj).

P89. Sa është në total shuma e pashlyer (principal) e kredisë? Periudha e referencës: aktuale

Këtu synohet të merret informacion mbi pjesën e mbetur të pashlyer të kredisë, diferenca midis shumës fillestare e marrë hua (principalit), me pjesën e mbetur për t'u paguar. Këtu nuk duhet të përfshihen interesat që paguhen apo pjesa e mbetur e interesave që duhet të paguhet.

P90. Sa është norma aktuale (vjetore) e interesit që paguani për këtë kredi? Periudha e referencës: aktuale

Norma e interesit (që zakonisht është vjetore) është çmimi, kostoja që ju paguani për këtë hua ose kredi të marrë. Kjo normë interesi mund të jetë fikse ose e luhatshme, që ndryshon nga viti në vit. Nëse kredia ka një normë të luhatshme interesi, atëherë duhet të marrim informacion për normën më të fundit, atë aktuale.

P91: Aktualisht, sa është kësti mujor (pagesa mujore) i kredisë? Periudha e referencës: aktuale

Kësti mujor i kredisë përfshin shumën që ju duhet të paguani çdo muaj për të shlyer kredinë e marrë hua, e cila përfshin si shlyerjen e pjesës së kredisë së marrë hua, ashtu edhe interesin (çmimin që banka merr në këmbim të saj) që ju paguani për këtë hua të marrë. Tek kësti mujor i kredisë nuk përfshihen pagesat që kanë të bëjnë me komisionin e disbursimit, pagesat për sigurimin e pronës dhe të jetës, etj.

Nëse pagesa mujore e kredisë ka ndryshuar me kalimin e kohës gjatë kohëzgjatjes së huasë, atëherë për referencë merret kësti mujor aktual.

PËR INTERVISTUESIN: NËSE KËSTI QË FAMILJA PAGUAN NUK ËSHTË MUJOR, PYETENI SA ËSHTË FREKUENCA E PAGESES SË KËSTIT DHE KONVERTOJENI ATË NË MUJOR DUKE E PJESËTUAR ME 3, ME 6, ME 12 NËSE KËSTI I RAPORTUAR BËHET RESPEKTIVISHT NË PAGESA TREMUJORE, GJASHTËMUJORE OSE VJETORE.

PYETJET P92-P93 KANË PËR QËLLIM TË MARRIN INFORMACION PËR KREDINË E TRETË KONSUMATORE, TË KATËRT E ME RADHË, NËSE FAMILJA DEKLARON QË NUMRI I KËTYRE KREDIVE ËSHTË MË I MADH SE 2.

P92. Për kreditë e tjera konsumatore (për të tretën, të kartën e me radhë), sa është shuma e pashlyer e principalit në total? Periudha e referencës: aktuale

Nëse familja shprehet se ka marrë për shembull 4 kredi konsumatore, tek pyetjet më lart (saktësisht pyetjet 84-91) merret informacion për 2 kreditë konsumatore. Këtu do të merret informacion

për të gjitha kreditë konsumatore të tjera nëse ka, për shembull për të tretën, për të katërt e me radhë në total.

P93. Aktualisht, sa është kësti (pagesa) mujor i këtyre kredive së bashku? Periudha e referencës: aktuale

Këtu do të mblidhet informacion për këstin mujor të të gjitha kredive, për shembull për të tretën, të katërtën, të pestën etj. së bashku nëse ka.

MODULI 3: DETYRIME TE TJERA (VAZHDIM)

KËTU SYNOHET TË MERRRET INFORMACION NË LIDHJE ME APLIKIMET PËR KREDI QË KA BËRË FAMILJA GJATË TRE VITEVE TË FUNDIT

P94. Në tre vitet e fundit, a keni aplikuar ju ose ndonjë anëtar tjetër i familjes për një kredi ose forma të tjera financimi në një bankë ose institucion tjetër financiar? Periudha e referencës: 3 vitet e fundit

Pyetja ka të bëjë me marrjen e informacionit mbi aplikimet që ka bërë familja në 3 vitet e fundit për të marrë para hua (kredi) qoftë nga një bankë apo nga një institucion tjetër financiar.

P95: Në tre vitet e fundit, a ka pasur ndonjë huadhënës apo kreditor (institucion) që ka refuzuar kërkesën për kredi ose nuk ju ka dhënë shumën e plotë që keni kërkuar? Periudha e referencës: 3 vitet e fundit

Nëse personat që kanë bërë kërkesë për marrjen e një kredie nga një institucion financiar, pyetet nëse kërkesa për këtë kredi është refuzuar apo jo, apo nuk është dhënë shuma e kërkuar.

P96. A mundët ju apo ndonjë anëtar tjetër i familjes suaj të përfitoni më vonë shumën e kërkuar, duke ri-aplikuar tek i njëjti institucion ose në një institucion tjetër? Periudha e referencës: 3 vitet e fundit

Këtu pyetet nëse është përfituar shuma e kërkuar në një moment të dytë pasi është ri-aplikuar në të njëjtin institucion ose në një

institucion tjetër, pavarësisht se mund të jetë refuzuar në momentin e parë, apo nuk është dhënë shuma e kërkuara.

P97. Në tre vitet e fundit, a keni konsideruar ju (ose ndonjë anëtar tjetër i familjes) për të aplikuar për një kredi (ose formë tjetër financimi), por keni vendosur të mos e bëni këtë, duke menduar që aplikimi do ju refuzohej? Periudha e referencës: 3 vitet e fundit

Këtu pyetet anëtari i familjes nëse fillimisht ka konsideruar të marrë kredi (ose formë tjetër financimi), por ka vendosur që të mos aplikojë pasi ka menduar që kërkesa do të refuzohej.

MODULI 4A: BIZNESI PRIVAT

KY MODUL KA PËR QËLLIM MARRJEN E INFORMACIONIT NË LIDHJE ME BIZNESET PRIVATE QË FAMILJET ZOTËROJNË PLOTËSISHT APO PJESËRISHT.

P98. A jeni ju (ose ndonjë person tjetër në familje) pronar (i të gjithë ose një pjesë) i ndonjë biznesi të regjistruar? Periudha e referencës: aktuale

Këtu pyetet nëse ndonjë anëtar i familjes është pronar/ bashkëpronar/pronar i një pjese në një biznes, ose është i vetëpunësuar në këtë biznes (si për shembull profesionet e lira) ose në një biznes ku ka një rol aktiv në drejtimin e biznesit apo të kompanive me përgjegjësi të kufizuar.

P99. Në këtë/këto biznes/e, a jeni ju apo ndonjë anëtar tjetër i familjes i vetëpunësuar ose keni një rol aktiv në mbarëvajtjen e biznesit? Periudha e referencës: aktuale

Në sajë të kësaj pyetjeje, synohet të bëhet dallimi midis personave që janë vetëm të vetëpunësuar (ose bashkëpronarë) dhe atyre që kanë një rol aktiv në mbarëvajtjen e biznesit.

P100. Sa biznese në numër zotëroni ju dhe/ose anëtarët e tjerë të familjes, qoftë dhe pjesërisht? Periudha e referencës: aktuale

Këtu pyetet mbi numrin e bizneseve që zotërojnë pjesërisht apo plotësisht në total anëtarët e familjes.

MË POSHTË PYETET PËR 2 BIZNESET MË TË MËDHA NGA VLERA QË FAMILJA ZOTËRON PLOTËSISHT APO PJESËRISHT.

FILLIMISHT MERRET INFORMACION I DETAJUAR PËR BIZNESIN E PARË MË TË MADH, PASTAJ PËR TË DYTIN (PYETJET 101-106).

P101. Kush është aktiviteti kryesor i biznesit? (KODIM NË ZYRË KLASIFIKIMI NACE 2) Periudha e referencës: aktuale

Qëllim i kësaj pyetjeje ka të bëjë me marrjen e informacionin mbi aktivitetin kryesor të biznesit. Duhet të shkruhet me fjalë çfarë aktiviteti ka biznesi dhe klasifikimi i tij do të bëhet me kodim në zyrë sipas klasifikimit të NACE2 me një kod.

NACE është klasifikimi standard që përdoret në nivel kombëtar dhe në BE për të dy statistikat ekonomike dhe sociale. Aktivitetet ekonomike karakterizohen nga kontributi i mallrave ose shërbimeve, procesi i prodhimit dhe prodhimi i produkteve.

P102. Cila është forma ligjore e biznesit? (Zgjidh vetëm një alternativë) Periudha e referencës: aktuale

Pyetja ka për qëllim marrjen e informacionit mbi formën ligjore të biznesit. Sipas ligjit shqiptar, format ligjore të biznesit klasifikohen si më poshtë:

Tregtari-Person Fizik

- Tregtari është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm.
- Personi fizik, i cili ushtron një profesion të pavarur (si avokat, noter, kontabilist, mjek, inxhinier, arkitekt artist etj.), vlerësohet tregtar, nëse një ligj i posaçëm i ngarkon këtë status.
- Personi fizik, i cili ushtron veprimtari bujqësore, blegtorale, pyjore e të ngjashme, vlerësohet tregtar, nëse veprimtaria e tij përqendrohet kryesisht në përpunimin dhe shitjen e

- produkteve bujqësore, blegtorale, pyjore (agrobiznes).
- Personi fizik, veprimtaria ekonomike e të cilit, për shkak të vëllimit të tij, nuk kërkon një organizim të zakonshëm tregtar (tregtar i vogël), nuk vlerësohet tregtar e nuk i nënshtrohet këtij ligji.

Shoqëria kolektive është një shoqëri që themelohet nga më shumë se dy persona fizikë dhe/ose juridikë, që kryen veprimtarinë tregtare nën një emër të përbashkët dhe përgjegjësia e ortakëve përpara kreditorëve është e pakufizuar.

Shoqëri komandite është shoqëria në të cilën përgjegjësia e të paktën njërit prej ortakëve është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, ndërsa përgjegjësia e ortakëve të tjerë nuk është e kufizuar.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria aksionare është një shoqëri tregtare, kapitali i së cilës është i ndarë në aksione të nënshkuara nga themeluesit. Themeluesit janë persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë që mbulojnë humbjet e saj vetëm me vlerën e pashlyer të aksioneve të nënshkuara. Shoqëritë aksionare mund të jenë shoqëri me ofertë, private apo publike, në përputhje me dispozitat e ligjit për titujt.

Shoqëria shtetërore është një shoqëri tregtare, e cila zhvillon veprimtari tregtare, me interes të përgjithshëm ekonomik, aksionet e së cilës zotërohen drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë nga pushteti qendror, pushteti vendor apo nga shoqëri, ku këto pushtete veprojnë si mëmë, sipas përkufizimit të nenit 207 të këtij ligji.

P103. Duke ju përfshirë ju dhe anëtarë të tjerë të familjes, sa persona janë të punësuar gjithsej në këtë biznes? Periudha e referencës: aktuale

Këtu pyetet për numrin e anëtarëve të familjes (duke përfshirë edhe personin që i përgjigjet pyetësori) të cilët janë të punësuar në këtë biznes. Nëse në këtë biznes numri i të punësuarve ndryshon pasi mund të ketë të punësuar sezonalë, atëherë të plotësohet numri maksimal i të punësuarve gjatë vitit.

**P104. Kush nga pjesëtarët e familjes punon në këtë biznes? (Kodi(et) e anëtarit(ve), nëse punon më shumë se 1 anëtar)
Periudha e referencës: aktuale**

Këto duhet të vendoset kodi/ ose kodet e personave të familjes që punojnë në këtë biznes.

**P105. Çfarë përqindjeje të biznesit zotëroni ju/ familja juaj?
Periudha e referencës: aktuale**

Këtu duhet të vendoset në përqindje se çfarë pjese e biznesit zotërohet nga familja. Për shembull, nëse zotërohet plotësisht duhet të vendoset 100%, nëse zotërohet gjysma vendoset 50%, nëse zotërohet një e treta, 33% etj. Vlerat e mundshme janë nga 1% deri në 100%.

P106. Sa është vlera neto e biznesit, nëse do ta shisnit atë sot (duke hequr mënjane të gjitha detyrimet të lidhura me të). Nëse është fermë, përfshi vlerën e mjeteve, prodhimeve bujqësore dhe bagëtisë. Nëse ka më shumë se dy biznese, për të tjerat (3, 4 e me radhë), pyet për totalin e tyre, pra sa është vlera neto e të gjithave nëse do të shiteshin sot. Periudha e referencës: aktuale

Këtu synohet të merret perceptimi që kanë familjarët për vlerën e biznesit të tyre, duke hequr mënjane të gjitha detyrimet që lidhen me këto biznese. Pra, nëse do të mendonin ta shisnin këtë biznes sot, sa do ishte vlera që do të merrnin nga shitja e tij. Gjithashtu, nëse biznesi që ata zotërojnë është një fermë, këtu duhet të merret në konsideratë edhe vlera e mjeteve, prodhimeve bujqësore dhe bagëtisë.

PËR INTERVISTUESIN: NËSE TEK PYETJA P104, ËSHTË PËRGJIGJUR QË NUMRI I BIZNESEVE QË ZOTËRON PLOTËSISHT APO PJESËRISHT ËSHTË MË I MADH SE 2, P.SH. NËSE KY NUMËR ËSHTË 5, DO TË PYETET PËR PJESËN E MBETUR TË BIZNESEVE (5-2=3, PËR 3 BIZNESET NË KËTË RAST) PËR VLERËN E TYRE NËSE ATO DO TË SHITEN SOT, TË GJITHA SË BASHKU.

MODULI 4B: INVESTIMET FINANCIARE

P107. A keni ju/ apo ndonjë anëtar i familjes suaj llogari rrjedhëse, depozita likuide (depozitë pa afat të përcaktuar)? Periudha e referencës: aktuale

Depozita pa afat ose llogari rrjedhëse, depozita likuide: Fonde, që mund të transferohen, në çdo kohë dhe pa kufizim nga një llogari bankare në një tjetër llogari, të tërhiqen në çdo moment nga banka ose makina e ATM-së, ose të konvertohen me para në dorë.

Llogaritë e shikimit përfshijnë të gjitha depozitat zakonisht në një bankë, bankë kursimi, institucione krediti, kompani sigurimi, kundrejt të cilave mbajtësi i llogarisë lejohet të bëjë tërheqje ditore (nga arka ose makina ATM) dhe të bëjë transferime me qëllim të bërjes pagesa për persona të tretë ose të tjerë, ose transferime në llogari të tjera.

P108. Sa është vlera totale që keni në këto llogari së bashku? Periudha e referencës: aktuale

Këtu synohet të merret vlera në Lek ose Euro për të gjitha llogaritë rrjedhëse, depozitat likuide apo pa afat që ka familja. Këtu duhet të përfshihen vetëm balancat pozitive, balancat negative nuk duhet të përfshihen, pasi ato raportohen tek llogaritë overdraft apo linjat e kredisë që mund të ketë familja.

P109. A keni ju ose ndonjë anëtar i familjes ndonjë llogari kursimi, depozita me afat, certifikata depozitash apo lloje të tjera depozitash (pa përfshirë bonot e thesarit dhe obligacionet)? (Vetëm 1 alternativë) Periudha e referencës: aktuale

Këtu pyetet nëse familja ka llogari kursimi, depozita me afat, certifikata të tjera depozitash, por pa marrë në konsideratë investimet që kanë bërë individët apo familja në bono thesari apo obligacione.

Depozita kursimi -Fonde që individët apo ndërmarrjet depozitojnë pranë një banke, më shpesh në formën e një llogarie kursimi që përfiton interesa.

Depozita me afat -Fonde që janë depozituar në një bankë për një periudhë kohe të fiksuar. Zakonisht, investuesi nuk mund të tërheqë shumën e depozituar, deri në përfundim të afatit të maturimit.

P110. Në total, sa para keni në këtë/këto llogari depozitash apo kursimi? Periudha e referencës: aktuale

Pyetet sa është shuma që ka familja në këto llogari depozitash dhe kursimi, të gjitha së bashku, pa përfshirë vlerën që familja ka investuar në bono thesari, obligacione etj.

P111. A keni ju/ose dikush në familjen tuaj investime në fonde investimi, fonde pensioni vullnetar, fonde të tjera private investimi etj.? Periudha e referencës: aktuale

Këtu synohet të merret përgjigja në lidhje me investimet që bën familja në fondet e investimeve, p.sh. letra me vlerë, në tregun e sigurimeve, apo të fondeve të pensionit.

P112. Çfarë lloj fondesh zotëroni ju apo familja juaj (Lexo me radhë, zgjidh ato që qëndrojnë)? Cila është vlera aktuale totale e investimeve tuaja (të familjes) në secilin lloj fondi? (vendos shumën dhe zgjidh monedhën)

Këtu synohet të merret informacion jo vetëm për llojin e fondeve, por edhe për shumën e investuar në secilin lloj fondi.

a- Fonde që investohen në tregun e sigurimeve

Fondet që investojnë në tregun e sigurimeve kanë të bëjnë me nënshkrimin e policave midis individit dhe familjes dhe shoqërisë së sigurimit, ku qëllimi i sigurimit është transferimi i rrezikut nga individit tek sigurosi (shoqëria e sigurimit). Me anë të kësaj kontrate sigurimi, individit apo familja kërkon të mbrohet nga fatkeqësia (rreziku), që mund t'i rrezikojë jetën ose t'i shkaktojë dëme të pronës. Çmimi i sigurimit është primi i sigurimit që grumbullohet nga një numër i madh individësh (kontraktues të sigurimeve), të cilët janë siguruar nga i njëjti rrezik ku supozimi bazë është se vetëm numri i caktuar i personave (përfituesve) me të vërtetë do të pësojnë dëme që mund të jenë materiale dhe jo-materiale. Në rast të pësimit të dëmit, shoqëria e sigurimeve do të paguajë kompensim ose shumën e siguruar të siguruarit ose shfrytëzuesit të sigurimit.

b– Fonde që investohen në tregun e titujve

Tregu i titujve ka të bëjë me tregimin e titujve ose të letrave me vlerë të kompanive, që janë letra pronësie apo aksione. Gjithashtu, mund të blihen edhe letra borxhi siç janë obligacionet, që do të thotë se në këtë mënyrë ju i jepni hua bizneseve apo qeverisë, e cila do t'ju rikthehet kundrejt interesit.

c– Fonde që investohen në tregun e pensioneve vullnetare

Tregu i fondeve të pensioneve vullnetare përbëhet nga institucione financiare që kanë për qëllim administrimin e fondeve të pensioneve. Ku fondi i pensioneve vullnetare është një bashkim aktivësh, juridikisht të ndara që janë blerë duke kontribuar në një plan pensioni, më qëllimin e vetëm të financimit të përfitimeve nga ky plan. Anëtarët e planit/fondit kanë një të drejtë ligjore ose përfitimi ose disa kërkesa të tjera kontraktuale kundrejt aktiveve të fondit të pensionit.

Skema e fondeve private vullnetare përbëhet nga “kontribute të përcaktuara” ku vetëm kontributet janë të paracaktuara, ndërkohë që përfitimet në formë pension nuk janë të paracaktuara apo të garantuara. Kontributet investohen dhe akumulojnë interesin e fituar nga aktivet që ato investohen. Anëtarët përfitojnë shumën e akumuluar nga kontributet dhe interesat kur plotësojnë kushtet

e përfitimit. Toleranca për risk është ndër elementet kryesore që dallon një fond nga një tjetër.

d- Fonde që investohen në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive

Sipas ligjit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiar (AMF), çdo person juridik ose bashkim aktivesh konsiderohet sipërmarrje investimesh kolektive, pavarësisht formës ligjore, kur pjesëmarrja nëpërmjet aksioneve, kuotave ose të drejtave të tjera ofrohet për qëllime të rritjes së pjesëmarrjes në para dhe, në mënyrë të shprehur, synon të investojë mbi 60% të kësaj pjesëmarrjeje në portofol titujsh, depozita dhe në të gjitha llojet e tjera të aktiveve, ku investitorët nuk mbikëqyrin përditë marrjen e vendimeve për investimet dhe ku objektivi parësor është nxjerrja e përfitimeve për investitorët nga investimet e tyre, si në formë fitimi ashtu edhe në ndonjë formë tjetër.

Nuk janë sipërmarrje investimesh kolektive, sipas këtij ligji:

- a) bankat e licencuara nga BSH-ja për kryerjen e veprimtarisë përkatëse në Republikën e Shqipërisë;
- b) fondet e pensionit të licencuara nga AMF-ja, për kryerjen e veprimtarisë përkatëse në Republikën e Shqipërisë;
- c) shoqëritë e sigurimit, të licencuara nga AMF-ja, për kryerjen e veprimtarisë përkatëse në Republikën e Shqipërisë;
- d) personat juridikë, që investojnë fondet e veta;
- e) pjesëtarët e familjes, që bëjnë investime të përbashkëta, jo të tilla që kanë lidhje me këtë ligj;
- f) personat e tjerë, të përjashtuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë ose marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;
- g) sipërmarrjet e investimeve kolektive që e rrisin kapitalin pa promovim të shitjes së kuotave/aksioneve të tyre ndaj publikut.

P113. A zotëroni ju apo ndonjë anëtar i familjes bono thesari, obligacione qeverie ose korporate? Periudha e referencës: aktuale

Bonot e thesarit dhe obligacionet e qeverisë janë instrumente borxhi të emetuara dhe të garantuara nga qeveritë që i emetojnë ato, në rastin tonë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Ato mund të jenë në monedhë kombëtare dhe të huaj. Bonot e thesarit janë instrumente financiare afatshkurtra me afat maturimi 3-, 6- dhe 12-mujor. Interesi i përfituar nga ky instrument llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës nominale dhe çmimit të blerjes së kuponit.

Obligacionet e thesarit janë instrumente financiare afatmesëm dhe afatgjatë me maturitet 2-, 3-, 5-, 7- dhe 10-vjeçar. Interesi i përfituar në formën e kuponit, paguhet çdo 6 muaj gjatë kohëzgjatjes së instrumentit. Përgjithësisht, obligacionet emetohen me kupon fiks, pra një normë fikse interesi gjatë gjithë kohëzgjatjes së obligacionit, por obligacionet mund të emetohen edhe me kupon variabël. Në këtë rast, norma e interesit është e ndryshueshme dhe përcaktohet çdo vit si shumatore e normës së indeksit të ndryshueshëm dhe një marzhi fiks që përcaktohet në ankand.

P114. A janë ato të lëshuara nga qeveria shqiptare apo e huaj, nga një bankë apo institucion tjetër financiar, nga një korporatë jo-financiare apo ndonjë organizatë tjetër? Periudha e referencës: aktuale

Më poshtë do të zgjidhet se kush është institucioni që i emeton këto letra me vlerë.

P115. Në total, sa është vlera aktuale e këtyre letrave me vlerë së bashku? Periudha e referencës: aktuale

Pyetja ka për qëllim të marrë informacion për shumën totale të letrave me vlerë së bashku, në momentin që zhvillohet intervista.

P116. A ka ndonjë person (jashtë familjes), i afërm, mik, shok, koleg, i cili ju ka para borxh juve ose ndonjë pjesëtar tjetër të familjes? Periudha e referencës: aktuale

Këtu pyetet nëse të tjerë jashtë familjes, si për shembull një i afërm, një mik, një shok, një koleg, ka para borxh ndaj familjes, që pritet të shlyhet në një kohë në të ardhmen.

**P117. Në total, sa para ju detyrohen ata juve apo familjes suaj?
Periudha e referencës: aktuale**

Këtu pyetet sa është në vlerë borxhi që të tjerët kanë ndaj familjes.

**P118. A keni ju apo ndonjë anëtar i familjes suaj investime
financiare jashtë Shqipërisë dhe sa është vlera aktuale e
investimeve tuaja (të familjes) në secilin lloj fondi? (Vendos shumën
dhe zgjidh monedhën) Periudha e referencës: aktuale**

Këtu pyetet konkretisht për investimet financiare apo letra me vlerë që familja ka jashtë Shqipërisë. Kështu, zgjidhet lloji i fondit apo investimi që ka, dhe shkruhet shuma për secilin prej investimet apo letrat me vlerë. Nëse i intervistuari nuk i mban mend zërat e veçantë edhe mbas përpjekjeve të shumta të bëra nga intervistuesi, atëherë synoni që të merrni të paktën informacion për totalin e fondeve.

**P119. Cila prej deklaratave të mëposhtme mendoni se
përshkruan më mirë masën e rrezikut financiar që ju (dhe
bashkëshorti/partneri juaj) jeni të gatshëm të merrni përsipër kur
kurseni ose investoni? Periudha e referencës: aktuale**

Lexoni me kujdes dhe saktë fjalitë (deklaratat) e mëposhtme dhe pyesni intervistuesin se cila prej tyre e përshkruanin më mirë situatën e tij kur investon apo kursen. Duhet të zgjidhet vetëm një alternativë, ajo që përshkruan më së mirë pozicionin e familjes ndaj rrezikut. Çdo investim financiar shoqërohet nga një rrezik i caktuar që ka të bëjë me moskthimin nga investimi i kryer, prandaj në sajë të deklaratave të mëposhtme synohet të kuptohet sjellja e familjes (anëtarëve të familjes) ndaj rrezikut.

MODULI 5: PUNËSIMI PËR ÇDO ANËTAR TË FAMILJES MBI 16 VJEÇ

PËR INTERVISTUESIN: KËTO PYETJE U DREJTOHEN PERSONAVE QË JANË MBI 16 VJEÇ NË LIDHJE ME STATUSIN E PUNËSIMIT. KUJDESU QË KODI I ANËTARIT TË JETË I NJËJTË SI NË FAQEN E PARË TË MODULIT "DEMOGRAFIA". PYETJEVE U JEP PËRGJIGJE VETË ANËTARI [NËSE ËSHTË PREZENT], NË TË KUNDËRT PËRGJIGJET PERSONI QË KA MË SHUMË INFORMACION PËR PUNËSIMIN E ANËTARIT.

P120. Cili është statusi aktual i punësimit i secilit anëtar të familjes tuaj që është 16 vjeç+/ X-it. Periudha e referencës: aktuale

Këtu secili anëtar i familjes që është mbi 16 vjeç përgjigjet në lidhje me statusin e punësimit të tij, bazuar në atë çfarë pohon secili personi.

FILLIMISHT LEXONI SECILËN NGA KATEGORITË DHE PYETENI SE CILA SITUATË PËRSHKRUAN MË MIRË KËTË STATUS. DUHET ZGJEDHUR VETËM NJË ALTERNATIVË.

Nëse anëtari punon në më shumë se dy punë, të përgjigjet për punën kryesore të tij.

- I punësuar me pagesë/vetëpunësuar/punon në biznesin e familjes, i referohet të punuarit në një kompani përkundrejt një page të caktuar, të qenët i vetëpunësuar, pra që ka një aktivitet të vetëm personal që gjeneron të ardhura, ose punon dhe merr pagë nga biznesi që ka familja në zotërim. Të punësuar quhen edhe personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, që nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetë-konsum.
- Me leje lindje/ raport shëndetësor etj., planifikon të rikthehet në punë i referohet situatës kur i intervistuari ka një kontratë ekzistuese punësimi apo vetëpunësimi, por përkohësisht mungon në vendin e punë për arsye se është i sëmurë, me leje lindjeje ose për disa arsye të tjera, që bën që të mos jetë i pranishëm në vendin e punës në këtë moment.
- I papunë konsiderohet një person që: 1. gjatë 4 javë të fundit as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë kundrejt një page ose përfitimi; 2. aktualisht i disponueshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës); 3. duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishte ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të tij) ose kishte gjetur një punë që do ta fillonte së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muajsh).
- Student/nxënës/ praktikë mësimore

- Pensionist është personi që ka arritur moshën e pensionit, sipas ligjit në fuqi.
- Me paaftësi të përhershme në punë është personi që ka marrë një dëshmi ligjore që nuk është në gjendje që të punojë më gjatë gjithë jetës së tij.
- Duke punuar pa pagesë - që punojnë, por nuk marrin një pagesë për punën e kryer.

P121. Në punën tuaj aktuale, a jeni ju duke punuar për dikë tjetër, i vetëpunësuar apo punonjës i papaguar në biznesin e familjes? Zgjidh vetëm një nga alternativat që i përket punës kryesore. Periudha e referencës: aktuale

Këtu pyetet kryesisht për punën tuaj kryesore, që i referohet punës ku ju shpenzoni pjesën më e madhe të orëve të punës.

I punësuar:

- I punësuar quhet ai person që punon për një punëdhënës publik ose privat dhe që marrin kompensim për punën e kryer në formën e pagave, shpërblimeve, pagesave në natyrë etj.
- I punësuar quhet gjithashtu edhe nëse djali apo vajza punojnë në firmën e prindërve dhe marrin një pagë të rregullt monetare nga kjo punë.
- E punësuar quhet edhe nëna që kujdeset për fëmijën e saj nëse paguhet nga autoritetet lokale për ta bërë këtë gjë dhe quhet si e vetëpunësuar nëse e bën atë gjë privatisht.
- Përfaqësuesit e të gjitha feve si prift, hoxhë, imam, murgeshë quhen të punësuar.
- Personat të cilët punojnë në profesionin e tyre privatisht dhe për llogari të një punëdhënësi, qoftë privat apo publik, duhet të klasifikohen sipas statusit që kanë në punën ku harxhojnë më shumë orë pune.

Të vetëpunësuar me punonjës janë ata persona që punojnë në biznesin e tyre, praktikojnë profesionin e tyre dhe kanë një fermë, ndërmarrje bujqësore për qëllime fitimi ku është i punësuar të paktën një punonjës. Nëse personat që punojnë në këtë biznes, apo janë në këtë ndërmarrje dhe nuk paguhen atëherë ato do të quhen si persona të vetëpunësuar pa pagesë.

Të vetëpunësuar pa punonjës janë ata persona që punojnë në biznesin e tyre, ushtrojnë profesionin e tyre ose kanë fermën e tyre, me qëllim sigurimin e fitimeve dhe nuk punësojnë asnjë person. Megjithatë, mund të qëllojë që të angazhojnë anëtarë të tjerë të familjes pa pagesë.

P122. Cili është profesioni juaj në punën kryesore? (Për personat me më shumë se një punë në 4 javët e fundit, puna kryesore është ajo në të cilën personi punoi më shumë orë në javë) Periudha e referencës: aktuale

Këtu do të merret informacion për punën kryesore, nëse personi është i punësuar në disa punë njëkohësisht; do t'i referohet vetëm punës ku shpenzon më shumë orë pune në javë. Më pas kodimi do të bëhet në zyrë sipas klasifikimit që ka INSTAT me profesione duke përdorur klasifikimin deri në 2 kode.

P123. Cili është aktiviteti kryesor i kompanisë/institucionit për të cilën ju punoni? Periudha e referencës: aktuale

Këtu synohet të merret informacion për aktivitetin kryesor të kompanisë ku punoni, duke iu referuar punës kryesore. Kodimi i aktivitetit kryesor të kompanisë/institucionit do të bëhet sipas NACE2, me një nivel.

P124. A është ky një pozicion me kontratë të përhershme apo të përkohshme? Zgjidh vetëm një nga alternativat për punën kryesore. Periudha e referencës: aktuale

Kjo pyetje i drejtohet vetëm të punësuarve dhe ka për qëllim ndarjen e të punësuarve me kontratë të përhershme dhe të përkohshme. Kështu, pozicion me kontratë të përhershme është një kontratë pune pa një afat të caktuar kohor vendosur dhe e shkuar në kontratën e punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Ndërsa një pozicion me kontratë të përkohshme është një kontratë pune me një afat të caktuar kohor, ku secila palë, si punëdhënësi ashtu edhe punëmarrësi, janë në dijeni për afatin kohor të saj.

P125. Mesatarisht gjatë vitit 2018, sa orë në javë keni punuar (kushuar aktivitetit tuaj të biznesit) në punën tuaj kryesore? Periudha e referencës: viti 2018

Numri i orëve i korrespondon orëve të punës që një person punon zakonisht në punën e tij. Kjo përfshin edhe orët shtesë nga orari zyrtar i punës të paguara ose jo, por duke mos përfshirë kohën për të shkuar dhe vajtuar në punë, si dhe orarin e pushimit sidomos gjatë orarit të drekës. Personat të cilët zakonisht punojnë në shtëpi duhet të përfshijnë vetëm orët kur ata punojnë.

P126. Sa vite keni ju (ai/ajo) që punoni për këtë kompani (institucionin aktual apo si i vetëpunësuar/ në biznesin tuaj)? (Nëse ka më pak se 1 vit, shëno numrin e muajve) Periudha e referencës: aktuale

Këtu synohet të merret informacion për numrin e viteve të njëpasnjëshme të punës në institucionin apo kompaninë ku i intervistuari pohon se është i punësuar. Nëse numri i viteve të punës është më pak se një vit, duhet të shënohet numri i muajve, ndërsa viti do të vendoset 0.

Kohëzgjatja e punësimit aktual ose vitet e punës në atë kompani nuk ndikohet nga:

- a) një ndryshim në pozitën e punonjësit brenda kompanisë;
- b) nga mungesa e përkohshme në punë, ku marrëdhënia e punësimit nuk është ndërprerë dhe ka qenë më pak se një vit;
- c) si rezultat i lejeve të lindjes;
- d) ndryshime të emrit të kompanisë/institucionit, si rezultat i ndryshimeve të pronësisë apo i blerjes apo shitjes së kompanisë.

P127. Përveç punës (tuaj/tij/saj) kryesore, a punoni ju në një punë tjetër? (Zgjidh vetëm një alternativë) Periudha e referencës: aktuale

Këtu synohet të merret përgjigja mbi punën e tjera që mund të kryejë secili individ i familjes mbi 16 vjeç.

P128. Cili nga pohimet më poshtë paraqet më shumë statusin tuaj të punësimit? (Zgjidh vetëm një alternativë) Periudha e referencës: aktuale

Intervistuesi lexon me kujdes pohimet më poshtë dhe i kërkon individit të zgjedhë vetëm një nga alternativat që pasqyrojnë më së mirë statusin e tij të punësimit: pra është i punësuar në dy ose më shumë vende pune, është i vetëpunësuar, apo është i punësuar diku dhe ka një biznes të vetin personal/ ushtron profesionin e tij në mënyrë individuale.

P129. A keni ju (ai/ajo) punuar me kohë të plotë ose të pjesshme gjatë gjithë vitit ose në pjesën më të madhe të vitit 2018? Periudha e referencës: viti 2018

Këtu pyetet nëse gjatë vitit 2018, individët kanë punuar me kohë të plotë apo të pjesshme pjesën më të madhe të vitit, pra më shumë se gjashtë muaj.

P130. Duke filluar që nga mosha 16 vjeç, sa vite keni ju (ai/ajo) që keni punuar në total, duke konsideruar vitet që keni punuar plotësisht ose pjesën më të madhe të vitit? Periudha e referencës: aktuale

Këtu pyetet se sa është numri në total i viteve të punës së një individi, që nga puna e parë e tij e deri tani. Nëse personi pohon që është pensionit apo me paftësi të përhershme pune, kjo pyetje nuk duhet bërë.

P131. Deri në çfarë moshe mendoni (planifikoni) të punoni (përkundrejt pagesës)? Periudha e referencës: aktuale

Këtu pyetet deri në çfarë moshe mendon të punojë punonjësi, pavarësisht se kur mund të dalë ligjërisht në pension, pra sa mendojnë ata që mund të jenë të aftë që të punojnë.

P132. Pyetjet e këtij sesioni për anëtarin u përgjigjen nga: KODI I ANETARIT

PËR INTERVISTUESIN: PYETJEVE U JEP PËRGJIGJE VETË ANËTARI [NËSE ËSHTË PREZENT], NË TË KUNDËRT PËRGJIGJET PERSONI QË KA MË SHUMË INFORMACION PËR PUNËSIMIN E ANËTARIT. KËTU DO TË VENDOSËT KODI I ANËTARIT TË PERSONIT QË PËRGJIGJET PËR TË ARDHURAT INDIVIDUALE TË PERSONIT.

MODULI 6A: TË ARDHURAT E INDIVIDIT

PËR INTERVISTUESIN: PYETJEVE U JEP PËRGJIGJE VETË ANËTARI [NËSE ËSHTË PREZENT], NË TË KUNDËRT PËRGJIGJET PERSONI QË KA MË SHUMË INFORMACION PËR TË ARDHURAT E ANËTARIT TË FAMILIJES.

P133. A keni marrë ndonjë të ardhur nga puna gjatë vitit 2018? (Zgjidh vetëm një alternativë) Periudha e referencës: viti 2018

Të ardhurat nga puna janë shuma në para kesh (cash) që merr i punësuar nga punëdhënësi i tij. Të ardhurat nga puna përfshijnë çdo të ardhur nga paga dhe rroga në mënyrë të rregullt, shpërblimet, nga puna jashtë orarit, nga paga e trembëdhjetë, pagesat për kujdesin ndaj fëmijëve, si dhe shpërblimet apo përfitimet nga ndarja e fitimeve apo aksioneve. Gjithashtu, këtu përfshihen edhe kompensimet për të mbuluar shpenzimet e banimit në një vend apo qytet të caktuar. Çdo rimbursim për shpenzime pune (si për shembull shpenzimet e udhëtimit apo të akomodimit për qëllim pune) duhet të zbritet nga të ardhurat nga puna.

P134. Sa ishte shuma totale neto e të ardhurave vjetore (ose mujore) nga puna gjatë vitit 2018? Këtu përfshihen të ardhurat që merren në mënyrë të rregullt nga paga, si dhe çdo e ardhur e siguruar nga orët shtesë, shpërblimet, përfitimet nga ndarja e fitimeve (përveç shumave që janë pjesë e marrëveshjeve për pensionet suplementare). (Zgjidh monedhën dhe shkruaj shumën) Periudha e referencës: viti 2018

KËTU MERRET INFORMACION NË LIDHJE ME TË ARDHURAT TOTALE VJETORE NETO (PARA NË DORË, CASH) QË MERR INDIVIDU NGA PUNA. NËSE PERSONI E KA MË TË LEHTË TË THOTË TË ARDHURAT MUJORE, ATËHERË I INTERVISTUARI TË MARRË INFORMACION SA PAGA (NUMRIN E PAGAVE GJATË VITIT, PLUS PAGËN E 13 OSE

SHPËRBLIME TË TJERA) MERR DHE TË ARDHURAT MUJORE NGA PAGA T'I SHUMËZOJË ME NUMRIN E PAGAVE TË MARRA GJATË VITIT 2018 PËR TË NXJERRË TOTALIN E TË ARDHURAVE. SHENO NËSE SHUMA ËSHTË E DHËNË MUJORE APO VJETORE.

NËSE TË ARDHURAT NGA PAGA MERREN NË EURO, ATËHERË TË LLOGARITEN TË ARDHURAT VJETORE NGA PAGA NË EURO, DHE TË SHËNOHET OSE TË ZGJIDHET SAKTË MONEDHA NË TË CILËN MERRET PAGA.

Të ardhurat nga puna përfshijnë:

- rroga ose paga paguar në para për punën e kryer në punën kryesore dhe në punën e dytë ose në punën sezonale;
- pagesa që merren edhe gjatë kohës që nuk jeni në punë (për shembull paga që merr gjatë pushimeve);
- pagesë për lindjen e fëmijëve;
- pagesa nga pjesëmarrja në komisione, këshillimet dhe shpërblime;
- pagesa shtesë si për shembull për rrogën e trembëdhjetë;
- pagesa të marra nga ndarja e fitimeve të kompanisë në formë cash ose në formë aksionesh;
- pagesa që merren për të punuar në vende të largëta (që konsiderohen si pjesë të kushteve të punës);
- pagesa që merren për transportin në punë;
- pagesa për strehim të paguara nga punëdhënësi;
- pagesat shtesë që bëhen nga punëdhënësi për të përballuar sëmundjet, lejen e lindjes, paaftësinë në punë.

Nga të ardhurat nga puna përjashtohen:

- rimbursimet e bëra për shpenzimet e udhëtimeve për qëllime pune;
- pagesat për ndërprerje apo shkëputje të marrëdhënies së punës, për punonjësit që e kanë arritur moshën e pensionit;
- pagesat që bëhen për shpenzime fikse të punës, si për shembull shpenzime për udhëtime pune, për veshje pune etj.;
- pagesat që merren për daljen në datën normale të pensionit;
- kontributet e sigurimeve shoqërore të punëdhënësve.

**P135. A keni marrë ndonjë të ardhur nga puna juaj si i vetëpunësuar gjatë vitit 2018? (Zgjidh vetëm një alternativë)
Periudha e referencës: viti 2018**

Të ardhurat nga vetëpunësimi (përfshirë edhe sektorin e bujqësisë) janë të ardhurat që një person i vetëpunësuar përfiton nga puna e realizuar nga ndërmarrja e tij, apo nga ushtrimi i profesionit individual etj. Këto të ardhura të përfuara janë si shpërblim për punën e kryer, por njëkohësisht shërbejnë edhe për të mbuluar shpenzimet e bëra për kapital fizik (ndërtesa, mjete pune), si dhe shpenzimet për kapitalin human (paga/rroga ndaj të punësuarve). Biznesi i një personi të vetëpunësuar mund të rezultojë edhe me humbje, që konsiderohet si një e ardhur negative. Tek të ardhurat nga vetëpunësimi duhet të përjashtohen të ardhurat nga qiratë, dividendët e fituar nga pronarët e tjerët, si dhe fitimet nga investimet e bëra në bizneset e tjera.

Të ardhurat neto (ose humbjet neto) janë të ardhurat bruto nga vetëpunësimi, duke hequr shpenzimet operacionale, pagat dhe rogat ndaj të punësuarve, kontributin e sigurimeve shoqërore, taksat që paguhen për prodhimin dhe importin e të mirave, interesat e paguara për kreditë ndaj bizneseve, si dhe amortizimin e aktiveve fikse. Gjithashtu tek të ardhurat neto operative përfshihen edhe mallrat dhe shërbimet që merren nga ndërmarrja nga pronarët apo partnerët.

P136. Sa ishte kjo shumë totale neto vjetore (ose mujore) e të ardhurave nga vetëpunësimi gjatë vitit 2018? (Zgjidh monedhën dhe shkruaj shumën) Periudha e referencës: viti 2018

Të ardhurat nga vetëpunësimi përshtjënë:

- të ardhura neto operative nga puna e pronarëve ose partnerëve në një biznes, duke hequr shpenzimet për interesin e kredisë për biznes;
- pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale; pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit etj. që nuk janë të përfshira në fitimet/humbjet e ndërmarrjeve;

- pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, për shfaqjet e tyre;
- të ardhurat nga dhënie me qira e ndërtesave të biznesit, pajisjeve, automjeteve që nuk janë përfshirë tek të ardhurat operative të bizneseve, pasi heqjes së shpenzimeve për interesat e kredisë së biznesit, riparimet, mirëmbajtjen e tyre dhe pagesat e sigurimit të objekteve.

Përfshihen nga të ardhurat neto nga vetëpunësimi:

- pagesat e dhëna drejtorëve apo pronarëve të ndërmarrjeve (që përfshihen tek të ardhurat bruto të punonjësve);
- dividendët që u paguhen personave dhe ndërmarrjeve (të cilat përfshihen tek të ardhurat nga investimet financiare);
- fitimet nga kapitali i investuar në një kompani, në të cilën personi nuk punon (pra është një partner në heshtje), të cilat përfshihen tek të ardhurat nga bizneset private apo partneritetet;
- të ardhurat nga qiraja, toka dhe pajisjet që nuk përfshihen tek fitimet/humbjet e kompanive (të cilat përfshihen tek të ardhurat nga pasuritë e patundshme).

P137. A keni marrë ndonjë të ardhur nga pensioni (skema shtetërore) gjatë vitit 2018? (Zgjidh vetëm një alternativë) Periudha e referencës: viti 2018

Të ardhurat nga pensioni përfshijnë:

- pension pleqërie: pagesa periodike që marrin individët mbas daljes në pension, si rezultat i kontributeve të tyre gjatë punësimit;
- pension të parakohshëm: pension i parakohshëm është pagesa periodike që merr personi pa mbushur moshën e pensionit, përcaktuar sipas skemës së pensionit. Kjo mund të ndodhë me reduktim ose jo të pensionit normal të personit;
- pension i pjesshëm: pagesa periodike të një pjese të pensionit të plotë të pleqërisë, për personat që e kanë mbushur moshën e pensionit, por që vazhdojnë të punojnë duke reduktuar orarin e punës, ose të ardhurat nga profesioni që janë deri në një kufi të caktuar;
- pension nga vdekja e personit të siguruar: pagesa periodike

që marrin njerëzit që lindin nga marrëdhënia e tyre me një person të vdekur, të mbrojtur nga skema e pensionit (si për shembull personat e ve, fëmijët, jetimët etj.);

- pension për persona me aftësi të kufizuar: pagesa periodike ndaj një personi me aftësi të kufizuar, me qëllim që të ardhurat e tyre të mos bien poshtë një niveli të caktuar;
- pensionet që merren nga skemat e pensionit jashtë Shqipërisë.

Këtu përjashtohen:

- pensionet e marra nga skemat private dhe suplementare;
- të ardhurat nga papunësia.

P138. Sa ishte shuma totale neto e të ardhurave vjetore (ose mujore) nga pensioni gjatë vitit 2018? (Zgjidh monedhën dhe shkruaj shumën) Periudha e referencës: viti 2018

Këtu përfshihen të ardhurat vjetore të pensioneve sipas përkufizimit të mësipërm, edhe në rast se ato merren me vonesë, për shembull 1 ose dy muaj me vonesë, duhet të përfshihen tek totali i ardhurave vjetore nga pensioni.

P139. A keni marrë ndonjë pagesë nga pensioni juaj privat apo pensioni suplementar gjatë vitit 2018? (Zgjidh vetëm një alternativë) Periudha e referencës: viti 2018

Pensionet e rregullta nga pensioni privat apo suplementar (shpesë) i referohen pensioneve apo pagesave të marra gjatë periudhës së referencës, në formën e të ardhurave nga interesi apo të dividendit nga skemat e organizimit individuale të pensionit, ku kontributet janë të pavarura nga kontributet që bën punëdhënësi i tyre ose qeveria.

Ai përfshin:

- të ardhurat e marra nga skemat e pensioneve të ngritura në vendet e punës, për moshën e pleqërisë, për të mbijetuarit, për të sëmurët, për invalidët të marrë në formën e interesit ose të dividendit për planet individuale të skemave të pensionit.

Këtu përjashtohen pensionet, të ardhurat që merren nga skemat publike të pensioneve.

P140. Sa ishte shuma totale neto e të ardhurave vjetore (ose mujore) nga pensioni privat ose suplementar gjatë vitit 2018? (Zgjidh monedhën dhe shkruaj shumën) Periudha e referencës: viti 2018

Këtu përfshihen të ardhurat vjetore të pensioneve suplementare sipas përkufizimit të mësipërm, edhe në rast se ato merren me vonesë, për shembull 1 ose dy muaj me vonesë, duhet të përfshihen tek totali i ardhurave vjetore nga pensionet suplementare apo private.

P141. A keni marrë ndonjë të ardhur nga të qenët i papunë gjatë vitit 2018? (Zgjidh vetëm një alternativë). Periudha e referencës: viti 2018

Përfitimet e papunësisë i referohen përfitimeve që merr punonjësi për të zëvendësuar plotësisht apo pjesërisht të ardhurat nga puna për shkak të humbjes së vendit të punës. Disa të ardhura që merren për t'i pasur në momentin kur personat hyjnë edhe dalin nga tregu i punës, për të kompensuar humbjen në të ardhura për shkak të punësimit të pjesshëm; për të zëvendësuar të gjitha ose një pjesë të të ardhurave për një person që del në pension përpara kohe, si rezultat i shkurtimit të vendeve të punës për arsye ekonomike; i referohet pagesave që u bëhen personave për trajnim me qëllim që këto persona të punësohen, ose pagesa që u bëhet personave të papunë për të plotësuar kostot e udhëtimit për të gjetur një punë.

P142. Sa ishte shuma totale neto e të ardhurave vjetore (ose mujore) që morët nga të qenit i papunë gjatë vitit 2018? (Zgjidh monedhën dhe shkruaj shumën) Periudha e referencës: viti 2018

Përfitimet e papunësisë përfshijnë:

- përfitimet e plota për papunësi janë përfitimet (të ardhurat) që merr një punonjës që është i aftë dhe i gatshëm të punojë, por nuk gjen një punë të përshtatshme, duke përfshirë edhe personat që nuk kanë punuar më parë;

- përfitimet e pjeshme të papunësisë janë përfitimet që merr punonjësi nga humbja e vendit të punës pavarësisht nga shkaku (për shembull një rritje më e ngadaltë e biznesit, kushtet klimatike, aksidentet etj.) dhe kur vazhdon marrëdhënia punëdhënës/punonjës;
- pension i hershëm për arsye të tregut të punës. Këto janë pagesat periodike për personat që dalin në pension para kohe, për shkak të shkurtimit të vendit të punës, shkaktuar nga ristrukturimi i një sektori ose ndërmarrjeje. Këto pagesa përfundojnë kur përfituesi arrin moshën e pensionit;
- pagesa për aftësim profesional janë pagesa nga fondi i sigurimeve shoqërore ose nga agjenci publike që synojnë një grup punonjësish që janë pjesë e forcave të punës për të zhvilluar potencialin e tyre të punësimit;
- pagesa për lëvizshmëri dhe zhvendosje janë pagesa nga fondet e sigurimeve shoqërore ose agjencive publike për personat e papunë për t'i inkurajuar ata të lëvizin në një vend tjetër ose të ndryshojnë profesionin, me qëllim për të marrë një punë;
- përfitime të tjera financiare në para janë ndihma financiare papunësie, veçanërisht pagesa për të papunët afatgjatë.

Këtu nuk përshihen:

- pagesat për fëmijët në varësi, pavarësisht se e drejta e marrjes së këtyre pagesa nuk varet nga fakti që personi i përgjegjës është papunë ose jo;
- pagesat për ndërprerje përfundimtare të marrëdhënies midis punëdhënësit/punëmarrësit.

P143. PYETJET E KETIJ SESIONI PER ANËTARIN MORËN PËRGJIGJE NGA:

PËR INTERVISTUESIN: PYETJEVE U JEP PËRGJIGJE VETË ANËTARI [NËSE ËSHTË PREZENT], NË TË KUNDËRT PËRGJIGJET PERSONI QË KA MË SHUMË INFORMACION PËR TË ARDHURAT E ANËTARIT. KËTU DO TË VENDOSËT KODI I ANËTARIT TË PERSONIT QË PËRGJIGJET PËR TË ARDHURAT INDIVIDUALE TË PERSONIT.

MODULI 6B: TË ARDHURAT E FAMIJES

KËTU MERRET INFORMACION PËR TË ARDHURAT QË MERR E GJITHË FAMILIJA.

P144. A ka marrë familja juaj ndihma sociale gjatë vitit 2018? (Zgjidh vetëm një alternativë) Periudha e referencës: viti 2018

Ndihmat (përfitimet) sociale janë pagesa të rregullta publike që individi ose familja merr nga sigurimet shoqërore ose nga agjencitë e tjera qeveritare, si për shembull subvencion për sëmundje, pushimin e lejes së lindjes, përfitim për fëmijë, bursë studentore për fëmijët ose çdo mbështetje tjetër financiare për shkollimin e fëmijëve etj. Këto pagesa synojnë që të lehtësojnë ose të mbështesin financiarisht familjet në nevojë dhe është përcaktuar me ligj si mbulim i këtij grupi njerëzish.

Ato përfshijnë:

- shtesat për fëmijët;
- ndihmat për strehim;
- ndihmat për arsim, si p.sh bursa, grante dhe ndihma të tjera për studentët;
- një minimum të ardhurash për familjet me të ardhura të pamjaftueshme;
- lloje të tjera të përfitimeve sociale.

Këtu përjashtohen:

- të ardhurat nga të qenit i papunë (pyetje 142);
- të ardhurat nga skema e pensionit publik (pyetja 137).

P145. Sa ishte shuma totale neto (mujiore ose vjetore) që morët gjatë vitit 2018? (Zgjidh monedhën dhe shëno shumën) Periudha e referencës: viti 2018

KËTU PËRFSHIHEN TË ARDHURAT VJETORE QË MERREN NGA NDIHMAT SOCIALE TË PËRMENDURA TEK PYETJA P144. NËSE ATO MERREN MUJORE, ATËHERË PAGESAT MUJORE SHUMËZOHEN ME NUMRIN E PAGESAVE NË VIT DHE DALIN TË ARDHURA TOTALE NETO NGA NDIHMAT SOCIALE. SHËNO NËSE SHUMA ËSHTË DHËNË MUJORE APO VJETORE.

P146. A keni marrë ju/familja juaj pagesa të rregullta për ushqim, mbështetje për fëmijët, subvencione, bursa private ose para të rregullta në formë cash nga persona jashtë familjes tuaj ose nga organizata, gjatë vitit 2018? Ju lutem mos përfshini dhurata apo pagesa që janë bërë vetëm një herë. (Zgjidh vetëm një alternativë) Periudha e referencës: viti 2018

Pagesat e rregullta private janë çdo transfertë e rregullt nga organizatat private dhe ose nga persona jashtë familjes. Këtu përfshihen pagesa të rregullta për ushqim apo për mbështetjen e fëmijëve, pagesa të rregullta nga familjet jashtë vendit në formën e pagesave për studimin e fëmijëve apo për të moshuarit. Përfshihen gjithashtu edhe pagesa nga organizatat joqeveritare që përfshijnë bamirësitë, apo pagesa të tjera nga institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve për të përballuar konsumin dhe shpenzimet e tjera.

Më konkretisht përfshihen pagesa për ushqim të detyrueshëm dhe për mbështetjen e fëmijëve:

- ushqim vullnetar dhe pagesa për fëmijët në mënyrë të rregull;
- mbështetje me para në dorë nga persona të tjerë përveç pjesëtareve të familjes;
- mbështetje të rregullta në para nga familjet në vendet e tjera;
- bursa nga fondet e bamirësisë.

Përfshihen:

- trashëgimitë dhe transfertat e tjera kapitale nga familjet e tjera, të cilat nuk konsiderohen si fonde të domosdoshme për konsum brenda periudhën së referencës;
- dhurata dhe flukse të tjera monetare, të marra vetëm njëherë si për shembull për të blerë një makinë ose shtëpi, ose për t'i kursyer për t'i shpenzuar në një moment të dytë, kryesisht mbi 1 vit.

P147. Sa ishte shuma totale neto që morët gjatë vitit 2018? (Zgjidh shumën dhe monedhën) Periudha e referencës: viti 2018

KËTU PËRFSHIHEN TË ARDHURAT TOTALE VJETORE MBI PAGESAT E RREGULLTA NGA ORGANIZATAT PRIVATE DHE OSE NGA PERSONA

JASHTË FAMILJES. NËSE ATO MERREN MUJORE, ATËHERË PAGESAT MUJORE SHUMËZOHEN ME NUMRIN E PAGESAVE TË MARRA NË VIT DHE DALIN TË ARDHURA TOTALE NETO NGA KËTO PAGESA. SHENO NESE SHUMA ESHTË DHENE MUJORE APO VJETORE.

P148. A keni marrë ju/familja juaj të ardhura nga emigrantët? (Zgjidh vetëm një alternativë) Periudha e referencës: viti 2018

Të ardhurat nga emigrantët janë të ardhurat që merr familja nga persona të tjerë të familjes që jetojnë jashtë, që mund të përdoren për konsum, për kursim, për investime, për të paguar pagesat e studimeve etj.

P149. Sa ishte shuma totale neto (mujore ose vjetore) që morët gjatë vitit 2018? (Zgjidh monedhën dhe shëno shumën) Periudha e referencës: viti 2018

KËTU PËRFSHIHEN TË ARDHURAT NGA EMIGRANTËT (OSE REMITANCAT). NËSE ATO MERREN MUJORE, ATËHERË PAGESAT MUJORE SHUMËZOHEN ME NUMRIN E PAGESAVE TË MARRA NË VIT DHE DALIN TË ARDHURA TOTALE NGA DËRGESAT E EMIGRANTËVE. SHËNO NËSE SHUMA ËSHTË DHËNE MUJORE APO VJETORE.

P150. A keni marrë (ju/ familja juaj) të ardhura nga dhënia me qira e pasurive të patundshme gjatë vitit 2018? (Zgjidh vetëm një alternativë). Periudha e referencës: viti 2018

Të ardhurat nga qiraja e një pasurie të patundshme ose të një toke janë të ardhura që merren nga dhënia me qira e një pasurie të patundshme ose një toke, e cila nuk përfshihet në fitimet/humbjet e kompanive pasi janë hequr kostot për pagesat e normave të interesit për kreditë me kolateral këtë pasuri, riparimet, kostot e mirëmbajtjes dhe pagesa të tjera.

Nëse jepet me qira një pronë që është pjesë e biznesit, atëherë kjo e ardhur nuk duhet të përfshihet këtu, por tek të ardhurat nga vetëpunësimi ose nga biznesi privat.

P151. Sa ishte shuma totale neto (muajore ose vjetore) që morët gjatë vitit 2018? (Zgjidh monedhën dhe shëno shumën). Periudha e referencës: viti 2018

KËTU PËRFSHIHEN TË ARDHURAT TOTALE VJETORE NGA DHËNIA ME QERA E PASURIVE TË PATUNDSHME DHE E TOKAVE. NËSE ATO MERREN MUJORE, ATËHERË PAGESAT MUJORE SHUMËZOHEN ME NUMRIN E PAGESAVE TË MARRA NË VIT DHE DALIN TË ARDHURA TOTALE NGA DHËNIA ME QERA E PASURIVE TË PATUNDSHME. SHËNO NËSE SHUMA ËSHTË DHËNË MUJORE APO VJETORE.

P152. A keni marrë ju/familja juaj ndonjë të ardhur në formën e interesit ose të dividendëve nga llogaritë e kursimit, depozitat me afat, certifikatat e depozitave, bonot e thesarit, obligacionet gjatë vitit 2018? (Vetëm 1 alternativë). Periudha e referencës: viti 2018

Interesat dhe dividendët janë shumat e interesave të marra nga llogaritë bankare, certifikatat e depozitave, bonot e thesarit, obligacionet etj., pasi janë hequr shpenzimet përkatëse apo kostot për mbajtjen e këtyre llogarive.

P153. Sa ishte shuma totale neto (muajore ose vjetore) që morët gjatë vitit 2018? (Zgjidh monedhën dhe shëno shumën) Periudha e referencës: viti 2018

KËTU PËRFSHIHEN TË ARDHURAT TOTALE VJETORE NGA INTERESAT, DIVIDENTËT DHE TË ARDHURAT E TJERA NGA INSTRUMENTAT FINANCIARE. NËSE ATO MERREN MUJORE, ATËHERË PAGESAT MUJORE SHUMËZOHEN ME NUMRIN E PAGESAVE TË MARRA NË VIT DHE DALIN TË ARDHURA TOTALE NGA KJO KATEGORI. SHËNO NËSE SHUMA ËSHTË DHËNË MUJORE APO VJETORE.

P154. Përveç të ardhurave nga vetëpunësimi, a merrni (përfiton) ju/ familja juaj ndonjë të ardhur nga një biznes i juaji privat apo të qenët bashkëpronar apo partner biznesi gjatë vitit 2018? (Vetëm 1 alternativë). Periudha e referencës: viti 2018

Këtu do të merret informacion mbi të ardhurat nga investimet në

kapital në një biznes dhe të ardhurat nga investimet financiare, duke mos përfshirë të ardhurat nga vetëpunësimi.

P155. Sa ishte shuma totale neto (mujiore ose vjetore) që morët gjatë vitit 2018? (Zgjidh monedhën dhe shëno shumën). Periudha e referencës: viti 2018

KËTU PËRFSHIHEN TË ARDHURAT TOTALE VJETORE NGA TË ARDHURAT E TJERA NGA BIZNESI PRIVAT APO TË QENËT I VETËPUNËSUAR. NËSE TË ARDHURAT E TJERA MERREN MUJORE, ATËHERË PAGESAT MUJORE SHUMËZOHEN ME NUMRIN E PAGESAVE TË MARRA NË VIT DHE DALIN TË ARDHURA TOTALE NGA KJO KATEGORI. SHËNO NËSE SHUMA ËSHTË DHËNË MUJORE APO VJETORE.

P156. A keni marrë rregullisht ose jo ndonjë të ardhur nga burime të tjera si: fitime nga kapitali apo humbje nga shitja e aktiveve, fitime nga lotari ose çmime, kompensim nga sigurimet, kompensim për pushim nga puna, shpërblime në momentin e daljes në pension, tërheqjen e parakohshme nga skemat private të sigurimeve apo ndonjë burim tjetër gjatë vitit 2018? (Zgjidh vetëm një alternativë). Periudha e referencës: viti 2018

Këtu përfshihet të ardhurat që nuk janë përmendur tek burimet e mësipërme të të ardhurave dhe përfshijnë:

- fitimet apo humbjet nga shitja e aktiveve;
- pagesat e marra për dalje para kohe në pension, kompensim që vjen heqja nga puna pa ndonjë arsye;
- pagesa nga fitimet e çmimeve;
- tërheqjet e parakohshme nga skemat private të pensioneve;
- pagesat e marra nga një kompani sigurimi për një dëm apo detyrim të kompanisë së sigurimit ndaj personave të siguruar.

P157. Sa ishte shuma totale neto (mujiore ose vjetore) që morët gjatë vitit 2018? (Zgjidh monedhën dhe shëno shumën). Periudha e referencës: viti 2018

KËTU PËRFSHIHEN TË ARDHURAT TOTALE VJETORE NGA BURIME TË TJERA. NËSE TË ARDHURAT NGA BURIMET E TJERA MERREN MUJORE, ATËHERË PAGESAT MUJORE SHUMËZOHEN ME NUMRIN E

PAGESAVE TË MARRA NË VIT DHE DALIN TË ARDHURA TOTALE NGA KJO KATEGORI. SHËNO NËSE SHUMA ËSHTË DHËNË MUJORE APO VJETORE.

P158. Cili ishte burimi/burimet e këtyre të ardhurave? (përgjigje me tekst)

Kjo është një përgjigje me tekst dhe përmes saj synohet të merret informacion për burimin e këtyre të ardhurave të tjera, të cilat nuk janë pyetur në pyetjet e mësipërme P144-P155.

P159. Tani, duke marrë parasysh totalin e të gjitha burimeve të të ardhurave, a do të thoni se të ardhurat tuaja (familjare) gjatë vitit 2018, ishin më të larta, më të ulëta apo normale krahasuar me të ardhurat e një vitit që e konsideroni si vit normal? (Zgjidh vetëm një alternativë). Periudha e referencës: viti 2018 me një vit normal (p.sh. 2016)

Kjo pyetje ka për qëllim që të marrë informacion nëse të ardhurat totale të familjes gjatë vitit 2018 janë të krahasueshme me një vit që konsiderohet nga familja si një vit normal.

P160. Gjatë vitit 2019, a prisni që të ardhurat tuaja (familjare) të rriten më shumë, më pak ose njëloj me rritjen e përgjithshme të çmimeve (inflacioni)? (Zgjidh vetëm një alternativë). Periudha e referencës: viti 2019 me vitin 2018

Kjo pyetje ka për qëllim që të merret informacion mbi pritshmëritë që ka familja mbi të ardhurat, duke i krahasuar ato me nivelin e përgjithshëm të çmimeve (inflacionin).

MODULI 7: TRASHËGIMITË DHE DHURATAT

KËTU SYNOHET TË MERRET INFORMACION NË LIDHJE ME TRASHËGIMITË APO DHURATAT QË KA MARRË FAMILJA.

P161. A keni marrë ju/ ose ndonjë anëtar i familjes suaj ndonjë trashëgimi apo dhuratë me vlerë të konsiderueshme, që përfshin para ose ndonjë pasuri tjetër nga dikush që nuk është pjesë e

**familjes suaj aktuale (përveç banesës kryesore për ato që kanë thënë që kanë marrë dhuratë atë)? (Zgjidh vetëm një alternativë).
Periudha e referencës: -**

Trashëgimia ka të bëjë me transferimin e pasurisë, në rastin e vdekjes së trashëgimlënësit.

Dhurata ka të bëjë me transferimin e pasurisë gjatë jetës së personit, që nuk është e lidhur me vdekjen e tij.

P162. Sa të tilla në numër keni marrë? Periudha e referencës:-

Këtu pyetet për numrin total të dhuratave dhe të trashëgimive që ka marrë familja. Nëse dikush nga anëtarët e familjes ka marrë dhuratë dhe trashëgimi nga i njëjti person, duhet të konsiderohet secila më vete.

PYETJET 163-167 KANË TË BËJNË ME 2 DHURATAT/TRASHËGIMITË MË TË RËNDËSISHME PËR NGA VLERA QË KA MARRË FAMILJA. FILLO NGA AJO ME VLERËN MË TË MADHE DHE MË PAS KALO TEK DHURATA/TRASHËGIMIA E DYTË. PYET P163-P168 PËR DHURATËN/TRASHËGIMINË E PARË (AJO ME VLERËN MË TË MADHE) DHE MË PAS KALO TEK DHURATA/TRASHËGIMIA E DYTË NËSE KA.

P163. Në cilin vit ju apo familja juaj e keni marrë këtë trashëgimi apo dhuratë? (Vetëm 1 alternativë). Periudha e referencës:-

Këtu pyetet për vitin kur familja e ka përfutur këtë trashëgimi apo dhuratë.

P164. Çfarë lloj dhurate, trashëgimie (aktivi) keni marrë? (Zgjidh vetëm një alternativë) Periudha e referencës:-

Këtu do të zgjidhet vetëm një nga alternativat që ka të bëjë me llojin e dhuratës/ trashëgimisë si: para, banesë, përdorimi i banesës, tokë, biznes, letra me vlerë, bizhuteri, sigurim jete. Nëse është një aktiv tjetër atëherë i intervistuari e specifikon çfarë aktiviteti është.

Përdorimi i banesës ka të bëjë me të drejtën e përdorimit të banesës.

P165. Në kohën që ju apo familja juaj e morët këtë trashëgimi, dhuratë (aktivin) sa ishte vlera monetare e tij? (Zgjidh monedhën dhe shëno vlerën). Periudha e referencës:-

Këtu synohet të merret informacion për vlerën monetare të dhuratës/trashëgimisë në kohën e përfitimit së saj.

P166. Ishte një dhuratë apo trashëgimi? (Zgjidh vetëm 1 alternativë). Periudha e referencës:-

Këtu synohet të merret informacion nëse është dhuratë (pra personi ka qenë gjallë kur ia ka dhuruar) apo trashëgimi (aktivi është përfituar në momentin e vdekjes së personit).

P167. Nga kush e keni marrë? (Zgjidh vetëm një alternativë). Periudha e referencës:-

Këtu synohet të merret informacion për personat nga të cilët është marrë dhurata apo trashëgimia.

P168. Në të ardhmen, a prisni ju apo dikush në familjen tuaj të marrë një dhuratë apo një trashëgimi të konsiderueshme nga dikush jashtë shtëpisë? (Zgjidh vetëm një alternativë). Periudha e referencës:-

Kjo pyetje ka të bëjë me pritshmëritë në lidhje me dhuratat apo trashëgimitë që priten të merren nga dikush jashtë shtëpisë në të ardhmen (jo vetëm gjatë vitit 2019, e papërcaktuar).

MODULI 8: KONSUMI

KY MODUL KA PËR QËLLIM QË TË MBLEDHË INFORMACION MBI SHPENZIMET PËR KONSUM TË FAMILJEVE SHQIPTARE.

P169. Sa shpenzon familja juaj në një muaj tipik (normal) për ushqim dhe pije joalkoolike për t'i konsumuar në shtëpi? (Zgjidh monedhën, shkruaj vlerën). Periudha e referencës: muaj tipik

Këtu synohet të merret informacion për shumën e shpenzuar për blerjen e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, ku përmendim shpenzimet për: bukë dhe drithëra, mish, peshk, qumësht, djathë dhe vezë, fruta dhe perime, sheqer, reçel, çokollatë, mjaltë dhe ëmbëlsira, kafe, çaj dhe kakao, ujë mineral, si dhe lëngje frutash dhe perimesh.

P170. Sa shpenzon familja juaj në një muaj tipik për ushqim dhe pije joalkoolike jashtë shtëpisë? (Këtu nënkuptoj edhe shpenzimet në restorante, dreka, mensa, kafene dhe të ngjashme. Ju lutemi, përfshini vetëm shumat që paguani (ju/familja juaj), d.m.th. neto nga çdo subvencion i punëdhënësit/ zbritje/ tollona etj.) (Zgjidh monedhën, shkruaj vlerën)

Këtu synohet të merret informacion në lidhje me shpenzimet për konsumin e ushqimit jashtë shtëpisë, më konkretisht shpenzimet në restorante dhe në kafenë. Në rastet kur ushqimet ofrohen pjesërisht nga punëdhënësi, këtu do të përfshihet vetëm diferenca që paguhet nga ana e familjes.

P171. Sa shpenzon familja juaj në një muaj të zakonshëm për energji elektrike? (Zgjidh monedhën, shkruaj vlerën)

Këtu synohet të merret informacion për pagesën/faturën e energjisë elektrike në një muaj të zakonshëm, pa përfshirë taksat e detyrueshme që mbliidhen me anë të kësaj fature.

P172. Sa shpenzon familja juaj në një muaj të zakonshëm për ujë, gaz, telefon, televizor, internet së bashku?

Këtu do të merret informacion mbi shpenzimet për furnizimin me ujë, gaz, për telefon, televizor, shpenzimet e internetit etj. duke përjashtuar shpenzimet për energji elektrike.

P173. Pra, në total sa shpenzon familja juaj në një muaj tipik për mallrat dhe shërbimet e konsumit? (Merrni parasysh të gjitha shpenzimet për shtëpinë përfshirë ushqimin, faturat etj. por duke përjashtuar mallrat e konsumit afatgjatë, p.sh. makina, pajisje shtëpiake, qira, pagesa kredie, polica sigurimi, rinovim etj.) (Zgjidh monedhën, shkruaj vlerën)

Këtu do të merret informacioni për totalin e shpenzimeve të familjes në një muaj të zakonshëm për të gjitha shpenzimet e domosdoshme, duke përfshirë shpenzimet për ushqim, shpenzimet për energji elektrike, për gaz etj., përjashtuar shpenzimet për mallra të konsumit afatgjatë, shpenzimet për kredi, polica sigurimi etj.

P174. A keni bërë ju apo familja juaj rregullisht pagesa për njerëzit jashtë shtëpisë tuaj, gjatë vitit 2018? (Mos i konsideroni këtu pagesat e bëra vetëm një herë në jetë) (Zgjidh vetëm një alternativë).

Transferta të rregullta brenda familjes i referohen pagesave në para që u bëhen rregullisht anëtarëve të familjeve të tjera. Këtu përfshihen pagesa që deri diku janë të parashikueshme, si dhe janë pagesa që bëhen nga të ardhurat aktuale të periudhës. Përcaktimi i rregullt nuk i referohet kohës apo periodicitetit të bërjes së pagesave, por ato përfshijnë pagesat e mëposhtme si:

- ushqim të detyrueshëm dhe mbështetje për fëmijët;
- ushqim vullnetar dhe ndihmë për fëmijët të bëra rregullisht;
- mbështetje në para për individët, përveç personave të familjes;
- mbështetje në para për familjet në vende të tjera;
- dhurata të rregullta për bamirësi në institucione dhe organizma fetare ose jo.

Këtu përjashtohen:

- transferimi i kapitalit dhe të ardhurat e marra nga kursimi;
- pagesat e huave/ose transferata të pranuar.

P175. Sa është shuma që ju/familja juaj keni dhënë për muaj? (Zgjidh monedhën, shkruaj vlerën)

Këtu duhet të merret informacion për shumën mujore që familja ka shpenzuar për pagesa jashtë shtëpisë, të përmendura në P174.

P176. A kursen familja juaj? (Zgjidh vetëm një alternativë)

Këtu pyetet nëse familja kursen apo jo, pra mbi mbajtjen mënjane të një sasive të caktuar parash.

P177. Cilat janë arsytet më të rëndësishme për të cilat kurseni? (Fillo me qëllimin kryesor të kursimit/(mos e lexo listën). Kodo të gjitha qëllimet, si dhe numrat nga 1 tek 11, përdori për të renditur nga qëllimi i parë tek i dyti e me radhë.)

Pyetja ka për qëllim mbledhjen e informacionit mbi arsytet kryesore të kursimit, por nuk duhet të lexohet lista. Individit duhet të shprehet vetëm për arsytet kryesore të kursimit, si dhe duhet të kodohet me 1, arsyeja kryesore e më radhë, arsytet e tjera.

P178. Përveç rastit të blerjes së një pasurie të patundshme, a do të thoni se shpenzimet totale vjetore (të familjes suaj) gjatë vitit 2018 ishin më të larta, më të ulëta apo normale, në krahasim me atë që ju konsideroni si vitin tuaj normal? (Zgjidh vetëm një alternativë)

Këtu merret informacion mbi vlerësimin që i bëjnë familjet shpenzimeve të vitit 2018, duke i krahasuar ato me një vit që quhet viti normal mbi shpenzimet e familjes.

P179. Përsëri, duke mos konsideruar blerjen e ndonjë pasurie gjatë vitit 2018, a do të thoni që shpenzimet që bëni rregullisht në familjen tuaj ishin më të larta, më të ulëta apo pothuajse sa të ardhurat tuaja vjetore? (Zgjidh vetëm një alternativë)

Ndërsa këtu synohet të merret informacion mbi shpenzimet vjetore të familjes krahasuar me nivelin e të ardhurave vjetore të saj, pra nëse kanë qenë më të larta, më të ulëta apo në të njëjtin nivel me to.

P180. Ju më thatë se shpenzimet tuaja në 12 muajt e fundit kanë qenë më të larta se të ardhurat. Çfarë keni bërë për të përballuar shpenzimet? (Shëno të gjitha që qëndrojnë. Numrat nga 1 deri në 7, përdori për të renditur nga mënyra e parë tek e dyta e me radhë.)

Kjo pyetje i drejtohet atyre familjeve që kanë shpenzuar më shumë para se të ardhurat vjetore të tyre, duke i kërkuar të intervistuarit që listojë se çfarë kanë bërë për të përballuar këto shpenzime, nga

mënyra e parë, e dytë e me radhë. Listo sipas rëndësisë.

P181. Në raste urgjente, a mund të merrni ju apo familja juaj një shumë prej 100,000 lekësh (të rinj) nga miqtë apo të afërmit që nuk jetojnë me ju? (Zgjidh vetëm një alternativë)

Kjo pyetje ka të bëjë me faktin që familja percepton se mund të marrë apo jo një sasi të caktuar parash (100,000 lekë të rinj) nga miqtë apo të afërmit, në raste urgjente.

P182. A mendoni që kemi lënë jashtë intervistës diçka që është shumë e rëndësishme në lidhje me pasurinë, financat, të ardhurat tuaja etj.? Nëse do t'ju ri-kontaktonim a do të ishit të gatshëm për ta bërë sërish këtë intervistë?

Këtu vendoset çdo shënim/koment që familja e konsideron të rëndësishëm në lidhje me financat e saj.

GJITHASHTU FAMILJA PYETET NËSE ËSHTË E GATSHME TË MARRË PJESË SËRISHT NË KËTË ANKETIM NË TË ARDHMEN.

NËSE PO, MBAHET SHËNIM EMRI I PERSONIT TË REFERENCËS, ADRESA E SAKTË DHE NUMRI I CELULARIT.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Dushku, Elona

Vrojtimi i pasurisë të familjeve shqiptare : rezultatet e raundit të parë = Albanian household wealth survey-AHWS / Elona Dushku, Ola Çami. – Tiranë : Banka e Shqipërisë, 2022

140 f. ; 21x15 cm. – (Material studimor ; 1 (82)).

ISBN 978-9928-262-51-6

I.Çami. Ola

1.Banka dhe veprimtaria bankare 2.Banka e Shqipërisë
3.Ekonomia shtëpiake 4.Të ardhura 5.Raporte 6.Shqipëri

336.71(496.5) (047)

ISBN 978-9928-262-51-6



9 789928 262516 >

www.bankofalbania.org

ISBN 978-9928-262-51-6



9 789928 262516 >